



# **PLANI STRATEGJIK I KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR**

**2020 - 2025**

**Drafti**

## Përmbajtja

<b>FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË SHQIPTARËVE</b>	<b>2</b>
<b>HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>ARSIMI NË GJUHËN SHQIPE</b>	<b>5</b>
1. Hyrje	5
2. Realizimi i të drejtës për arsimim në gjuhën shqipe – pasqyrimi i gjendjes	5
3. Kornizat normative dhe institucionale për arsim në gjuhën shqipe	7
3.1 Korniza normative	7
3.2 Korniza institucionale	11
4. Roli dhe autorizimet publike të KKSH-së në sferën e arsimit	13
5. Qëllimet strategjike në sferën e arsimit	15
6. Rekomandimet për Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi në sferën e arsimit	30
<b>RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I KULTURËS SË PAKICËS NACIONALE SHQIPTARE</b>	<b>33</b>
1. Hyrje	33
2. Realizimi i të drejtës për mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare – pasqyrimi i gjendjes	34
3. Korniza normative dhe institucionale për kulturën e pakicës nacionale shqiptare	36
3.1 Korniza normative	36
3.2 Korniza institucionale	38
4. Roli dhe autorizimet publike të KKSH-së në kulturë	39
5. Qëllimet strategjike në sferën e kulturës	41
6. Rekomandimet për Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi në sferën e kulturës	53
<b>INFORMIMI NË GJUHËN SHQIPE</b>	<b>54</b>
1. Hyrje	54
2. Realizimi i të drejtës për informim në gjuhën shqipe – pasqyrimi i gjendjes	54
3. Korniza normative dhe ligjore për informim në gjuhën shqipe	56
3.1 Korniza normative	56
3.2 Korniza institucionale	58
4. Roli dhe autorizimet publike të KKSH-së në sferën e informimit	59
5. Qëllimet strategjike në sferën e informimit	61
6. Rekomandime për Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi në sferën e informimit	79
<b>PËRDORIMI ZYRTAR I GJUHËS DHE SHKRIMIT</b>	<b>81</b>
1. Hyrje	81
2. Përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit shqip – pasqyrimi i gjendjes	82
3. Korniza normative për realizimin e të drejtës mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip	84
3.1. Korniza ligjore	84
3.2. Korniza institucionale	89
4. Roli dhe autorizimet e KKSH në sferën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip	90
5. Qëllimet strategjike në sferën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip	92
6. Rekomandime për Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi në sferën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit	103
<b>REKOMANDIME PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE</b>	<b>105</b>
<b>LISTA E LIGJEVE</b>	<b>110</b>

# FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË SHQIPTARËVE

---

Plani Strategjik 2020-2025 i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi është parakusht për zhvillimin e mëtejshëm në sistemimin e masave dhe përcaktimin e veprimeve konkrete e të koordinuara për komunitetin shqiptar si parakushte për zgjidhjen e substanciale të problemeve në fushën e jetës shoqërore e sociale. Mbase një ndër dokumentet më të rëndësishme.

Vetë administrimi në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip është një rrugë me shumë sfida si për ka legjislacionit ashtu edhe për ka realizimi. Andaj kërkon zbatimin e strategjisë gjithëpërfshirëse dhe sektoriale.

Plani Strategjik 2020-2025 nuk është një këndvështrim i kufizuar mbi komunitetin shqiptar e mbi problemet e tij, por një vizion i aktualizuar përmes angazhimit për të realizuar të drejtat kombëtare, për të siguruar dhe avancuar identitetin kombëtar.

Ky dokument nuk premtan atë që nuk bën dhe bën realitet atë që përshkruan.

Duke i dhënë një trajtë të larmishme jo vetëm organizimit të brendshëm të Këshillit Kombëtar Shqiptar, por edhe gatishmërisë për konsumimin të drejtave ligjore; duke e hapur institucionalisht, jo vetëm ndaj atyre që janë anëtarë të tij, por edhe ndaj atyre me të cilët duhet të komunikojmë e prej të cilëve dëshirojmë të gjykohejmë.

Me bindjen se ky dokument reflekton nevojat dhe sfidat e pjesës më të gjerë e komunitetit shqiptar në përgatitjen e tij falemnderoj të gjithë të inkuadruarit nga kultura, arsimit, informimit dhe përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit shqip. Shprehi mirënjohjen e thellë për zhvillimin e suksesshëm të këtij Plani Strategjik Misioni i OSBE-së në Serbi.

Megjithatë, ky është një tekst i pambaruar. Një tekst i hapur. Është konceptuar si i tillë. Për t'u lënë të tjerëve radhën të shtojnë atë çka mungon, me vërejtjet, kritikën, sugjerimet konkrete. Të cilat shpresoj do të lindin nga leximi i këtyre rreshtave që skicojnë Planin strategjik gjithëpërfshirës e sektoriale sikur edhe nxitë pjesëmarrjen Tuaj.

Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar

**Ragmi Mustafa**

## HYRJE

Në sistemin normativ dhe institucional të mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare në Republikën e Serbisë, këshillat kombëtarë të pakicave kombëtare (KKSH) njihen si organe për ushtrimin e autonomisë kulturore. **Që nga themelimi i tij në vitin 2010, Këshilli kombëtarë i pakicës kombëtare shqiptare (KKSH) përpiqet të t'i përgjigjet sfidave në fushën e arsimit, kulturës, informimit dhe përdorimit zyrtarë të gjuhës në përputhje me kompetencat publike të përcaktuara në Ligjin mbi këshillat kombëtare të pakicave kombëtare.**

Duke filluar nga kompetencat e ndryshme publike, është paraqitur nevoja për krijimin e një dokumenti i cili do të ndihmojë KKSH-në që në mënyrë sistemime dhe të bazuar të organizojë punën e tij. **Qëllimi** i këtij dokumenti strategjik është përcaktimi i qëllimeve të punës së KKSH-së me aktivitete të planifikuara dhe rezultate të pritshme, të cilat KKSH do të duhet t'i realizojë në pesë vitet e ardhshme. Përveç qëllimeve, rezultateve dhe aktiviteteve, dokumenti me saktësi përcakton edhe partnerët për secilën fushë, afatet kohore dhe treguesit për matjen e suksesit të rezultateve të parashikuara. Kjo i mundëson KKSH-së që **vazhdimisht të monitorojë realizimin e planit strategjik** dhe të vlerësojë nivelin e realizimit të qëllimeve strategjike, shkallën e shfrytëzimit të resurseve ekzistuese dhe matjen e performancës në të gjitha fushat në të cilat ka kompetencë publike.

Bazuar në këtë plan strategjik, KKSH mundet t'i plotësojë nevojat specifike të komunitetit shqiptar në rrethana të ndryshueshme politike, ekonomike, ligjore dhe shoqërore. Përveç kësaj, ky dokument vazhdimisht thekson se me rastin e planifikimit të aktiviteteve gjithmonë duhet pasur parasysh **gjithë diversitetin edhe të vetë komunitetit shqiptarë**, (gjenerata, mosha, arsimimi dhe dallimi në nevojat e popullatës që jeton në zonën rurale dhe popullatës që jeton në zonat urbane të vendit). Aktivitetet e KKSH-së duhet në masë sa më madhe të bazohen në **nevojat reale të cilat përcaktohen përmes mbajtjes së kontakteve të vazhdueshme me pjesëtarët e të gjitha këtyre grupeve brenda komunitetit shqiptar.**

Strategjia e punës së KKSH-së është dokument të cilin e kanë hartuar **anëtarët e KKSH-së me mbështetje mentoruese dhe profesionale të organizatës CeSID, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Serbi.**

### **Karakteristikat demografike të pakicës kombëtare shqiptare**

Duke pasur parasysh vendimin për mospjesëmarrje në regjistrimin e fundit të popullsisë<sup>1</sup> nga ana e popullsisë në shqiptare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, është vështirë të shprehen karakteristikat demografike të komunitetit shqiptarë përmes numrave absolut. Sidoqoftë, disa fakte janë të pakontestueshme dhe kanë ndikim të madh në pozitën e komunitetit shqiptarë në Republikën e Serbisë. Pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare janë **territorialisht të koncentruar në tri komuna në jug të Serbisë**: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, por nuk duhet harruar që qytetarët të cilët deklarohen si shqiptarë jetojnë edhe në pjesët thera të Republikës së Serbisë, megjithëse në numër shumë më të vogël. Kjo i kontribuon sigurimit më të lehtë dhe gëzimit të drejtave të posaçme të pakicave në të katër fushat e rëndësishme, sepse është më lehtë që të menaxhohet vetëqeverisja pakicave në hapësirë më të vogël, të kufizuar qartë. Përveç kësaj, pjesëtarët e

<sup>1</sup> Me ftesë të partive politike shqiptare, popullsia e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me shumicën dërmuese nuk morri pjesë në regjistrimin e fundit. Numri zyrtar i qytetarëve të regjistruar të cilët janë deklaruar si pjesëtarë të komunitetit shqiptar është 5809. Burimi: Enti Republikan për statistika <http://data.stat.gov.rs/Home/Result/3102010403?languageCode=sr-Latn>

pakicës kombëtare shqiptare janë të **rinj mbi mesatare**: moshë mesatare në komunitetin shqiptar është 38 vite, në popullsinë e përgjithshme të Serbisë është 42 vite. Kjo tregon se jo vetëm që bëhet fjalë për një komunitet vital, por gjithashtu që **të rinjtë janë resurs i rëndësishëm për punën e KSSH-së gjë që duhet vërejtur në punën për mirëqenien e komunitetit në masë sa më të madhe**. Pjesa e burrave në komunitetin shqiptarë është e lartë mbi mesataren, deri në 58%, gjë që reflektohet edhe në pjesën e grave në KSSH.

### **KSSH – nga themelimi deri më sot**

KSSH i parë është themeluar në vitin 2010. Anëtarësia e KSSH-së e zgjedhur në zgjedhjet e vitit 2018 është, me këshillin kombëtarë të ashkalinjëve, këshilli më i ri kombëtarë në Republikën e Serbisë: moshë mesatare e anëtarëve KSSH-së është 37 vite. Nga gjithsej 15 anëtarë, 10 i përkasin dy kategorive të të rinjve (66,7%), saktësisht, 4 anëtarë kanë prej 18 deri 30 vite, kurse 6 anëtarë kanë prej 30 deri 35 vite.<sup>2</sup> Ky fakt tregon se KSSH ka përfshirë rininë në punën e tij. Fatkeqësisht, të rinjtë nuk janë qarta të përfaqësuar në udhëheqësinë e KSSH-së, në borde dhe në organe punuese. Gjithsej 3 anëtarë, prej të cilëve njëri është edhe kryetarë i këshillit, kurse 2 në Bordin ekzekutiv, i përkasin kategorisë së të rinjve deri në 35 vite (gjithsej 20% e të rinjve janë në organet e KSSH-së). Në pikëpamje të strukturës gjinore të këshillit, jashtëzakonisht pak gra janë të përfshira në punën e KSSH-së, gjithsej 4 gra nga gjithsej 15 anëtarë të këshillit (37,5%).<sup>3</sup>

Të gjitha këto tregojnë se **KSSH duhet t'i mundësojë të rinjve dhe grave që në masë më të madhe thellësisht ndikojnë në përcaktimin e orientimit të veprimit të vetëqeverisjes së pakicës shqiptare**. Të rinjve dhe grave duhet t'i besohet përgjegjësi më e madhe në krijimin dhe implementimin e aktiviteteve të KSSH-së. Duke pasur parash se i tërë komuniteti shqiptar në Republikën e Serbisë është i ri, **anëtarët e rinj të KSSH-së duhet jenë një lidhje e domosdoshme me pjesëtarët e tjerë të rinj të komunitetit shqiptar**.

Ky dokument strategjik duhet të shërbejë edhe sikur **pikë fillestare për përgatitjen e dokumenteve tjera të KSSH-së të cilat janë të obligueshme sipas Ligjit mbi këshillat kombëtare**: strategjinë e zhvillimit të kulturës dhe strategjinë e zhvillimit të informimit. Edhe në këtë drejtim shihet specifika e këtij dokumenti: ai, përveç vendosjes së kornizave të qarta për funksionim parimorë të KSSH-së, gjithashtu siguron edhe plane të veprimit të përpunuara hollësisht për të gjitha aktivitetet e KSSH-së në vitet e ardhme në të katër fushat të cilat janë nën kompetencë të këshillave kombëtare dhe në këtë mënyrë i ofron mbështetje konkrete Këshillit kombëtar të pakicës kombëtare shqiptare në punën e mëtejme. Dëgjimi publik i organizuar nga ana e KSSH-së në mënyrë që të konsultohet me komunitetin në lidhje me mënyrat e punës së tij, aktivitetet e planifikuara dhe prioritetet e përcaktuara siguron stabilitet me rastin e implementimit të qëllimeve të përcaktuara, vazhdimësi institucionale dhe i ofron legjitimitet shtesë këtij dokumenti strategjik.

---

<sup>2</sup> Analizë mbi përfshirjen e të rinjve në punën dhe aktivitetet e këshillave kombëtare të pakicave kombëtare, CeSID, 2019. <https://bit.ly/2ntBuNk>

<sup>3</sup> Në fushatën për zgjedhje të KSSH-së të gjitha listat kanë respektuar dispozitën e ligjit sipas të cilës çdo person i tretë në listë duhet të jetë person i gjinisë më pak të përfaqësuar, në këtë rast ato janë gratë. Pas zgjedhjeve, me rastin e vendosjes së anëtarëve të këshillit, gratë të cilat ishin në listë heqin dorë nga anëtarësia në këshill në favor të burrave.

# ARSIMI NË GJUHËN SHQIPE

---

## 1. Hyrje

Arsimimi dhe edukimi në gjuhën amtare është pjesë e të drejtave të pjesëtarëve të pakicave nacionale e që i përket një rëndësie të veçantë për ruajtjen dhe zhvillimin e identiteti kombëtar. Mu për këtë, sigurimi i arsimimit kualitativ dhe bashkëkohorë në gjuhën shqipe në të gjitha nivelet e arsimimit është parakusht i rëndësishëm për ruajtjen dhe avancimin e veçorive etnike të bashkësisë shqiptare në Republikën e Serbisë. Ndërtimi i kornizës juridike dhe institucionale e edhe i politikave ndërkulturore në Republikën e Serbisë paraqesin garancëtë të drejtave të përfaqësuesve të pakicës nacionale shqiptare.

Në të njëjtën kohë, e drejta për arsimim në gjuhën amtare nuk e përjashton mësimin e gjuhës zyrtare (në këtë rast gjuhës serbe). Përkundrazi, mësimi i gjuhës zyrtare është parakusht dhe faktorë kryesor për integrimin e shoqërive të ndryshme. Prandaj edhe e drejta për arsimim kualitativ në gjuhën shqipe përcillet me domosdoshmërinë e arritjes së njohjes së gjuhës serbe, njohuri kjo e cila paraqet aftësi të rëndësishme e cila është e domosdoshme që përfaqësuesit e pakicave nacionale të bëhen në tërësi qytetarë aktiv të cilët do të kenë në dispozicion të gjitha mundësitë që i ndodhën në dispozicion të gjithë qytetarëve.<sup>4</sup>

Sikur Këshillave tjera të pakicave nacionale, edhe Këshillit kombëtar shqiptar në Serbi (në vijim KKSH) me ligje iu kanë besuar autorizime të caktuara publike për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve ose për të vendosë në vete mbi çështjet e caktuara nga sfera e arsimit. Për t'i realizuar autorizimet publike që ju kanë besuar Këshillit, është e patjetërsueshme që ky organ të jetë i përgjegjshëm ndaj qytetarëve të cilët i përfaqëson dhe të ketë një rol efikas, sistematik dhe proaktiv në planin e sigurimit dhe ushtrimit të kësaj të drejte.

Në kushte të zhvillimit dinamik të shoqërisë dhe dallimeve specifike kulturore, sigurimi i plotë i të drejtave për arsim në gjuhën shqipe, përcakton rëndësishëm ruajtjen e identitetit, përderisa njohja e gjuhës serbe, si gjuhë zyrtare në Republikën e Serbisë, përcakton rëndësishëm pozicionin shoqëror dhe ekonomik të pakicës nacionale shqiptare dhe ndikon edhe në përshkrimin dhe pasurimin e kulturave të ndryshme.

## 2. Realizimi i të drejtës për arsimim në gjuhën shqipe – pasqyrimi i gjendjes

Në tri komunat në Jug të Serbisë puna në sistemin edukativo – arsimor zhvillohet nëpër institucione kryesisht monoetnike parashkollore e shkollore, në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe. Për pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare procesi edukativo – arsimor organizohet në gjuhën amtare në tri institucione parashkollore, 24 shkolla fillore dhe në pesë shkolla të mesme.<sup>5</sup>

---

<sup>4</sup>Njohja e gjuhës serbe i mundëson qytetarëve pakicë punësim më të lehtë, shkollim më të mirë (bursa në Republikën e Serbisë), e po ashtu e ndihmon edhe komunikimin me qytetarët që nuk e njohin gjuhën shqipe dhe kështu ndikon në integrimin brenda shoqërisë së shumëllojshme.

<sup>5</sup> Studimi mbi mundësitë e avancimit të mësimdhënies dhe mësimin të gjuhës serbe si gjuhë jo amtare në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje. Shërbimi i Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe

Në komunën e Preshevës, në një Ent parashkollor realizohen programe të ndara në gjuhën serbe dhe gjuhën shqipe, në gjithsej gjashtë nga tetë shkollat fillore mësimi organizohet vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa në një shkollë në gjuhën shqipe dhe serbe.<sup>6</sup> Në këtë komunë ekzistojnë edhe dy shkolla të mesme –Gjimnazi *Skenderbeu* dhe *Shkolla e mesme teknike*, në të cilat mësimi organizohet ndaras, ose në gjuhën serbe ose në gjuhën shqipe. Në komunën e Bujanocit ekziston një Ent parashkollor në të cilin programi përgatitor për fillimin e shkollës fillore organizohet ndarazi në gjuhën serbe dhe gjuhën shqipe, gjashtë shkolla fillore në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe një shkollë e mesme me emrin *Sezai Surroi* me mësim në gjuhën shqipe.

Komuna e Medvegjës ka një Ent parashkollor, në të cilin procesi edukativo – arsimor zhvillohet ndaras, në gjuhën serbe dhe gjuhën shqipe, një shkollë fillore në të cilën mësimi organizohet vetëm në gjuhën shqipe dhe dy shkolla në të cilat, në paralele homogjene etnike, zhvillohet mësimi në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe.<sup>7</sup>

Medvegja po ashtu ka edhe njëshkollëtë mesme me mësimet e ndara në gjuhën serbe dhe gjuhën shqipe.

Sa i përket mundësive të arritjes së arsimit të lartë në Republikën e Serbisë, të rinjëve shqiptar nga viti 2011 u qëndrojnë në dispozicion bursa të numërta, në mes tjerash edhe për studim në fakultetet e Universitetit të Novi Sadit, të cilat i siguron Shërbimi i Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Kalimi i provimit pranues, e mëpastaj edhe vazhdimi i studimeve, nënkupton njohjen e gjuhës serbe, duke e marr parasysh që programet studimore zhvillohen në gjuhën serbe.

Megjithatë, numri i madhe i të rinjëve shqiptar studimet i vazhdojnë në Tiranë, Prishtinë dhe Tetovë, për të cilat nuk ekziston numër i mjaftueshëm i bursave. Komunitat Preshevë dhe Bujanoc ndajnë një sasi të vogël të mjeteve për financimin e studimeve jashtë shtetit, që paraqet një problem të theksuar për të rinjtë të cilët dëshirojnë të shkollohen jashtë Serbisë. Gjithashtu, duhet të përmendet që studimet jashtë Republikës së Serbisë pas diplomimit dhe kthimit në vend me vete bartin edhe një proces të gjatë dhe të mundimshëm të nostrifikimit të diplomave, që edhe më shumë e vështirëson punësimin e të rinjëve.

Me qëllim të tërheqjes së të rinjëve për të qëndruar dhe për t'u shkolluar në Republikën e Serbisë, në bashkëpunim me një numër të madhe të partnerëve, në mesin e të cilëve edhe me KKSH-në, në Bujanoc në vitin 2011 është hapur Paralelja e Fakultetit Ekonomik nga Subotica, Universiteti i Novi Sadit. Sipas modelit i cili praktikohet për studentët e bashkësisë hungareze në Suboticë, mësimi në Paralelen e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc po ashtu zhvillohet në dy gjuhë. Në këtë mënyrë, në njërin anë, përkujdeset për arsim në gjuhën amtare, ndërsa në njëjtën kohë arrihet edhe përvetësimi i terminologjisë profesionale edhe në gjuhën serbe.

Kur është fjala tek mësimi i gjuhës shqipe në mënyrë profesionale, vlenë të theksohet edhe ekzistimi i Katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit, katedër kjo e cila

---

Medvegjë, 2014. Fq 18. [http://www.kt.gov.rs/images/Studija%20o%20mogucnostima%20unapredjenja%20nastave\\_E-VERZIJA%20ALBANSKI\\_FINAL%20v2.pdf](http://www.kt.gov.rs/images/Studija%20o%20mogucnostima%20unapredjenja%20nastave_E-VERZIJA%20ALBANSKI_FINAL%20v2.pdf)

<sup>6</sup> Në shkollën fillore 9 Maji në Leran (Komuna e Preshevës) nxënësit në objektin e njejtë, por ndaras, ndjekin mësimin në gjuhën shqipe rrespektivisht në gjuhën serbe. Kapacitetet për aktivitete interkulturore në këtë shkollë janë jashtëzakonisht të mëdha, por nuk shfrytëzohen.

<sup>7</sup> Në Tupallë (Komuna e Medvegjës) në SHF *Zenel Hajdini* mësimi organizohet vetëm në gjuhën shqipe; në SHF *Gornja Jabllanicë* dhe SHF *Banja e Sijarinës* mësimi organizohet në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe, në klasë të ndara.

funksionon qysh nga viti 1920. Kjo katedër i takon një rëndësie të veçantë për arsimimin e kuadrove profesionale për të cilat nevojitet njohja e gjuhës shqipe.

### **3. Kornizat normative dhe institucionale për arsim në gjuhën shqipe**

#### **3.1 Korniza normative**

E drejta për arsimim në gjuhën amtare e pakicave nacionale është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, Ligje dhe dokumente ndërkombëtare ligjërish obliguese. Në Kushtetutën e Republikës së Serbisë, përveç të drejtave të siguruara për të gjithë qytetarët, pakicave nacionale u garantohen shtesë, të drejta individuale dhe kolektive. Njëra prej këtyre të drejtave është edhe e drejta mbi ruajtjen e veçorisë, e cila në Nenin 79 specifikohet në aspektin e arsimimit si e drejtë e shkollimit në gjuhën amtare në institucionet shkollore shtetërore dhe në themelimin e institucioneve private arsimore.

Ligjet me anë të të cilëve garantohet e drejta e përfaqësuesve të pakicave nacionale që të shkollohen në gjuhën e tyre amtare dhe të cilat për së afërmi e rregullojnë këtë materie, janë: Ligji mbi bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit, Ligji mbi arsimin dhe edukimin fillor, Ligji mbi arsimin dhe edukimin e mesëm, Ligji mbi arsimin e lartë dhe Ligji mbi tekstet mësimore. Legjislacioni i miratuar shtesë i cili përforcon të drejtën e pjesëtarëve të pakicave nacionale për t'u arsimuar dhe edukuar në gjuhën e tyre amtare përbëhet edhe nga Ligji mbi ruajtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale (këtu e tutje referuar si: Ligji mbi pakicat nacionale) dhe Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale (këtu e tutje referuar si: Ligji mbi këshillat nacionale). Ligji mbi pakicat nacionale garanton të drejtën për t'u arsimuar në gjuhën amtare në entet parashkollore, në arsimin fillor dhe të mesëm, por njëkohësisht edhe obligon mësimin e gjuhës serbe. Ligji mbi pakicat nacionale rregullon kompetencat e këshillave nacionale në sferën e arsimit në gjuhën e pakicës nacionale.

#### **Programi për organizimin e mësimin në gjuhën shqipe**

Plani mësimor është dokumenti zyrtar themelor në të cilin përcaktohet numri dhe emërtimi i lëndëve mësimore të parapara për shkollën e caktuar, radhitja e mësimin nëpër klasë (vite) dhe normat e periudhës arsimore përgjatë javës së punës të realizuara në orë për çdo lëndë mësimore.

Programi mësimor tregon përmbajtjen e lëndës mësimore dhe jep rekomandimet themelore metodike për realizimin e asaj përmbajtje mësimore.

Sa i përket pjesës së programit mësimor i cili i dedikohet përmbajtjes nacionale, Ligji mbi pakicat nacionale kërkon që ai të përmbajë tema të cilat i përkasin historisë, artit dhe kulturës së pakicës nacionale dhe që këshillat nacionale të pakicave nacionale të marrin pjesë në përpilimin e programeve mësimore për lëndët të cilat tregojnë veçoritë e pakicave nacionale.

Këshilli nacional ka të drejtë të propozoj bazat e programit për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm për:

- 1) Përmbajtje** të cilat tregojnë veçoritë e pakicës nacionale, e veçanërisht në sferën e historisë, edukatës muzikore dhe artit;



- 2) Programin për gjuhën amtare;
- 3) Të jep mendim për programin mësimor për gjuhën serbe si gjuhej amtare

Këshilli nacional i pakicës nacionale jep mendim në programin shkollor dhe atë edukativ e i cili zhvillohet në entet të cilat janë vlerësuar të veçantë për nga roli për një pakicë nacionale.

### **Arsimi dhe edukimi parashkollor**

Arsimimi dhe edukimi parashkollor është i rregulluar me Ligjin mbi bazën e sistemit të arsimimit dhe edukimit (këtu e tutje referuar si: Ligji themelor). Për pjesëtarët e pakicave nacionale procesi edukativo – arsimor realizohet me aplikimin e njërit prej këtyre tre modeleve:

- 1) Në gjuhën amtare të pakicës nacionale;
- 2) Në dy gjuhë, d.m.th. në gjuhën e pakicës nacionale dhe në gjuhën serbe;
- 3) Në gjuhën serbe.

Punën e edukatorit/es në entet parashkollore mund ta kryej personi që ka arritur nivelin e përshtatshëm arsimor në gjuhën në të cilën zhvillohet procesi i edukimit ose ka përfunduar provimin nga gjuha me metodikë, në bazë të programit të përshtatshëm në institucionin e lartë arsimor.

### **Arsimi Fillor**

Arsimi fillor është i rregulluar me Ligjin mbi bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit, Ligjin mbi arsimin fillor dhe Ligjin mbi tekstet mësimore. Për pjesëtarët e pakicave nacionale procesi edukativo – arsimor në shkollat fillore realizohet në:

- 1) Gjuhë dhe shkrim të pakicës nacionale; kur mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicës nacionale, mësimi i gjuhës serbe si gjuhë jo amtare është i obligueshëm;
- 2) Dy gjuhë, respektivisht në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale dhe gjuhën serbe;
- 3) Në gjuhën serbe.

Në rast se pjesëtarët e pakicës nacionale nuk kanë mësim të organizuar në gjuhën amtare, si lëndë zgjedhore, ekskluzivisht me iniciativë dhe propozim të Këshillit nacional, futet gjuha amtare e pakicës nacionale me elemente të kulturës nacionale.

### **Arsimi i Mesëm**

Arsimi i mesëm i pjesëtarëve të pakicave nacionale është i rregulluar me Ligjin mbi bazën e sistemit të arsimimit dhe edukimit, Ligjin mbi arsimimin dhe edukimin e mesëm dhe Ligjin mbi tekstet shkollore. Modelet e organizimit të procesit të mësimimit në shkollat e mesme (në gjuhën e pakicave nacionale, në dy gjuhët, në gjuhën serbe) janë modele identike me ato të organizimit të shkollimit fillor dhe parashkollor. Kur shkollimi

bëhet në gjuhën amtare, mësimi i gjuhës serbe si gjuhë jo amtare është i obligueshëm. Në rast se pjesëtarët e pakicave nacionale nuk kanë mësim të organizuar në gjuhën amtare, si lëndë zgjedhore në shkollën e mesme po ashtu mund të futet gjuha e pakicës nacionale me elemente të kulturës nacionale.

## **Arsimi i Lartë**

Sipas Ligjit mbi arsimin e lartë, gjuha e studimit ose programit studimor mund të jetë gjuha e pakicës nacionale nëse programi arsimor është i akredituar.<sup>8</sup> Në këtë rast, në punën e Këshillit nacional për arsimim të lartë, në çështjet e rëndësishme se veçantë për realizimin e mësimdhënies në gjuhën e pakicës, merr pjesë edhe përfaqësuesi i Këshillit nacional i pakicës në fjalë.<sup>9</sup> Përfaqësuesi i Këshillit nacional në Këshillin nacional për arsim të lartë zgjidhet nëpërmjet Koordinimit të këshillave nacionale të pakicave.

Ligji mbi pakicat nacionale përkrahë zhvillimin e programeve studimorë për edukatorë dhe mësimdhënës në gjuhën e pakicave nacionale, në përputhshmëri me ligjin i cili rregullon arsimin e lartë.

## **Tekstet dhe mjetet tjera mësimore**

Sipas Ligjit mbi tekstet mësimore, tekst mësimor në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale, konsiderohet:

- 1) Teksti mësimor i cili është shkruar në gjuhën serbe dhe është aprovuar (lejuar të përdoret). Nëse Këshilli nacional vendos për shfrytëzimin e këtij teksti mësimor në procesin edukativo – arsimor, pas marrjes së mendimit pozitiv nga këshilli nacional, ky tekst mësimor përkthehet në gjuhën e pakicës nacionale, në këtë rast, në gjuhën shqipe. Para marrjes së mendimit pozitiv për përdorimin e tekstit të caktuar mësimor, është e patjetërsueshme që KKSH-ja të konsultohet me mësimdhënësit dhe të sigurojë edhe mendimin dhe pëlqimin e tyre.
- 2) Teksti mësimor nga shteti amë, respektivisht nga Republika e Shqipërisë, i cili pas konstatimit të përshtatshmërisë të programit mësimor, është i lejuar të shfrytëzohet në Republikën e Serbisë. Përshtatshmërinë në mes të programeve me qëllim të përdorimit të tekstit të caktuar mësimor e konstaton dhe vlerëson Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit. Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi, pas konsultimeve me mësimdhënësit merr vendim se cili prej teksteve mësimore do të importohet nga shteti amë. Në përputhje me Ligjin mbi tekstet mësimore, KKSH bënë grumbullimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe i dërgon Ministrisë së arsimit, ndërsa Ministria e arsimit dokumentacionin në fjalë ia përcjell Entit për avancimin e arsimimit dhe edukimit. Pas marrjes së mendimit pozitiv nga komisioni të cilin e themelon Enti për avancim të arsimimit dhe edukimit për vlerësimin e kualitetit të tekstit mësimor në fjalë, duke ia bashkangjitur pëlqimin e Këshillit nacional për arsim<sup>10</sup>, vendimin përfundimtar për përdorimin e tekstit mësimor e sjell ministri i arsimit.

---

<sup>8</sup> Ligji mbi arsimin e lartë, neni 95.

<sup>9</sup> Ligji mbi arsimin e lartë, neni 11.

<sup>10</sup> Ligji mbi këshillat nacionale siguron të drejtën që një përfaqësues it ë gjitha këshillava nacionale të pakicave të jetë anëtarë i Këshillit nacional. Ky ligj po ashtu siguron të drejtën që një anëtarë i këshillit nacional të caktuar ka të drejtë të marr pjesë në

**3) Tekst mësimor krejtësisht i ri i përgatitur në gjuhën dhe shkrimin amë të pakicës nacionale shqiptare.**

Pavarësisht se për cilin nga këto tri modelet orientohet Këshilli nacional, procedurat për marrjen e pëlqimit për përdorimin e tekstit mësimor janë të njëjta, ndërsa afatet janë të definuara me Ligjin mbi tekstet mësimore,. Vlen të theksohet që përgjatë procesit të sigurimit të teksteve mësimore KKSH mund të përcaktohet dhe kombinoj tri modelet ekzistuese.

Sipas Ligjit mbi këshillat nacionale, gjatë sigurimit të teksteve mësimore për shkollim në gjuhën shqipe, këshilli nacional jep mendim në dorëshkrimet e dorëzuara, propozon planin e tekstit mësimor dhe përmbajtjet për lëndët e lartpërmendura të cilat janë të definuara me interes të veçantë për pakicën nacionale.

Në procesin e integrimi evropiane të Serbisë, të drejtat e njeriut dhe pakicave janë pjesë e Kapitullit 23, kapitull ky që në Plani e tij akcional identifikon nevojat për avancimin e pozitës së pakicave nacionale. Në këtë aspekt, në vitin 2016, është përpiluar Plan i veçantë akcional për realizimin e të të drejtave të pakicave nacionale (këtu e tutje si: Plan akcional).<sup>11</sup>

Plani akcional paraqet dokument strategjik afatmesëm i cili përmban qëllime strategjike të vendosura në bazë të rekomandimeve të Komitetit këshillëdhënës të Konventës kornizë të Këshillit të Evropës, realizimi i të cilës është i domosdoshëm për largimin e pengesave të vërejtura përgjatë realizimit të të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale.

Në pjesën e VI i cili ka të bëjë me arsimin, si probleme kryesoret shkollimit në gjuhën e pakicave nacionale, Plani akcional në mes tjerash identifikon:

- 1) Kuadrin mësimor i cili nuk është i trajnuar dhe përgatitur mjaftueshëm**
- 2) Mungesën e njohjes së gjuhës serbe te një pjesë e kuadrit arsimor;**
- 3) Mungesën e njohjes së gjuhës serbe tek nxënësit të cilët mësimet i vijnë në gjuhën amtare;**
- 4) Mungesën e teksteve mësimore ose tekste mësimore joadekuate**

Ky Plan akcional ofron zgjidhje shtesë për sigurimin e teksteve mësimore për nxënësit e shkollave fillore, duke paraparë nënshkrimin e marrëveshjes së përhjetshme mbi bashkëpunim të Ministrisë së arsimit, entit për tekstet mësimore (si shtëpinë e vetme botuese në pronësi të shtetit që ka për obligim botimin e teksteve me tirazh të vogël, ku edhe bëjnë pjesë tekstet mësimore të shkruara në gjuhën e pakicave nacionale) dhe Këshillave nacionale të pakicave nacionale të cilët përfaqësojnë bashkësitë etnike të cilat kanë të organizuar të gjithë procesin edukativo - arsimor (në shkollë fillore) në gjuhën e tyre amë. Me qëllim të sigurimit më efikas dhe më të shpejtë të teksteve mësimore për arsimin në gjuhën e pakicave nacionale, kjo marrëveshje nënkupton përgatitjen e plotë të modelit të parë (modeli i përkthimit të teksteve mësimore nga gjuha serbe në gjuhë tjera të pakicave nacionale) i cili parashihet me Ligjin mbi tekstet mësimore. Praktikimi i plotë i kësaj marrëveshje nuk nënkupton që ajo është modeli i vetëm ekzistues për sigurimin e teksteve dhe nuk dekurajon

---

mbledhjen e Këshillit nacional për arsim, saherë që ky organ shqyrton çështje të arsimit e që i përkasin pakicës nacionale në fjalë. Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale, neni 15.

<sup>11</sup><https://ljudskaprava.gov.rs/sh/node/21793>

Këshillat nacionale që të shfrytëzojnë edhe dy modalitetet dhe mënyrat e tjera për sigurimin e teksteve mësimore e të cilat i kanë në dispozicion në bazë të Ligjit mbi tekstet mësimore.

### **Standardet ndërkombëtare për realizimin e të drejtës mbi arsimim te pjesëtarëve të pakicave nacionale**

Dokumente ndërkombëtare juridikisht të detyrueshme në pikëpamje të arsimimit të pakicave nacionale janë Konventa kornizë për ruajtjen e pakicave nacionale<sup>12</sup> dhe Karta evropiane për gjuhët regjionale ose të pakicave.<sup>13</sup>

Konventa kornizë, paralelisht me angazhimin për të drejtën e arsimimit në gjuhën e pakicave, theks të veçantë ka edhe interkulturalizmin, integrimin dhe kohezionin shoqëror. Ky dokument obligon shtetet të ndërmarrin masa në sferën e arsimimit për kultivimin e kulturës së pakicave nacionale dhe popullit shumicë; të sigurojnë mundësi të përshtatshme për aftësim profesional të mësimdhënësve dhe qasje e disponueshmëri të teksteve shkollore dhe të lehtësojnë komunikimin në mes nxënësve respektivisht mësimdhënësve të bashkësive të ndryshme; të sigurojnë mundësi të barabarta për qasje në arsim në të gjitha nivelet për pjesëtarët e pakicave nacionale. Në vendet të cilat janë tradicionalisht të populluara ose në të cilat shumicën e përbëjnë qytetarët që i përkasin një pakice nacionale, shtetet të cilat kanë ratifikuar këtë dokument duhet të përpiqen që në kuadër të mundësive të veta të sigurojnë shkollimin në gjuhën e tyre amtare, duke qenë i obliguar edhe mësimi i gjuhës zyrtare.

Edhe Karta evropiane për gjuhët regjionale ose të pakicave në preambulën e saj thekson vlerën e interkulturalizmit dhe shume gjuhësisë duke e vlerësuar që angazhimi për përdorimin e gjuhëve regjionale dhe atyre të pakicave duhet të bashkë rrugëtoj me njohjen e gjuhës zyrtare. Gjatë ratifikimit të këtij dokumenti Republika e Serbisë ka përcaktuar edhe gjuhën shqipe, si njërin prej dhjetë gjuhëve të pakicave nacionale, të cilat do të gëzojnë përkujdesje dhe ruajtje në territorin e sajë.<sup>14</sup>

### **3.2 Korniza institucionale**

Kornizën institucionale e cila është e rëndësishme për organizimin e arsimimit në gjuhën shqipe e përbëjnë këto institucione: Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit, Enti për vlerësimin e kualitetit të arsimimit dhe edukimit, Këshilli nacional i arsimit, Enti për tekstet dhe Agjensioni për kualifikime në Republikën e Serbisë.<sup>15</sup>

**1) Ministria e arsimit**, shkencës dhe zhvillimit teknologjik planifikon dhe përcjell zhvillimin e arsimimit parashkollor, fillor, të mesëm dhe arsimit të lartë; kryen mbikëqyrje në institucionet arsimore; merr pjesë në

<sup>12</sup> Dokumenti i Këshillit të Evropës i aprovuar në vitin 1994, në Republikën e Serbisë si pasuese të Republikës së Jugosllavisë në vitin 2001.

<sup>13</sup> Dokumenti i Këshillit të Evropës i aprovuar në vitin 1992. godine, Republikën e Serbisë si përfaqësuese e Serbisë dhe Malit të Zi ka hyrë në fuqi në vitin 2006.

<sup>14</sup> Ligji mbi ratifikimin e Kartës evropiane mbi gjuhët regjionale dhe të pakicave Gazeta zyrtare e Serbisë dhe Malit të Zi – Kontrata ndërkombëtare, nr. 18/2005, neni. 3

<sup>15</sup> Duhet të përmendet edhe institucionet tjera me rëndësi për avancimin e shkollimit në gjuhët e pakicave nacionale, në këtë rast shkollimit në gjuhën shqipe. Ato janë Këshilli nacional për arsim të lartë dhe ministritë e arsimit të shtetit amë.

ndërtimin, furnizimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore; kryen mbikëqyrje pedagogjike profesionale; vlerëson punën dhe mbikëqyr aftësimin profesional të të punësuarve në arsim. Pjesë e ministrisë janë edhe njësitë e administratave shkollore (Drejtorit shkollore); Administrata (Drejtoria) shkollore në Leskoc me zyrën e sajë në Vranjë është e angazhuar për Rrethin e Pçinjës dhe Jabllanicës, rrespektivisht për punën edukativo arsimore të institucioneve shkollore në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

**2) Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit punon në avancimin e programeve shkollore,** teksteve mësimore, materialeve didaktike dhe në aftësimin profesional të kuadrit arsimor në entet parashkollore, shkollat fillore dhe ato të mesme. Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit është institucioni i cili është i angazhuar për vlerësimin e kualitetit të programeve arsimore dhe teksteve të propozuara shkollore. Po ashtu ky Ent akrediton programe dhe organizon trajnime për mësimdhënësit. Prandaj edhe komunikimi konstant në mes të këtij Enti dhe KKSH-së është i rëndësishëm. Sidomos në realizimin e arsimimit kualitativ në gjuhën shqipe.

**3) Këshilli nacional për arsim përcjell arsimimin dhe edukimin parashkollor,** fillor dhe të mesëm. Këshilli nacional për arsim gjithashtu shqyrton nevojat për tekste të reja mësimore, sjell planin e teksteve mësimore dhe i propozon ministrit të arsimit dhënjën e pëlqimit për shfrytëzimin e teksteve dhe paisjeve shtesë të nevojshme për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. Në përputhshmëri me masat nga Plani akcional, në kuadër të Këshillit nacional për arsim, në vitin 2016 është formuar grupi i cili merret me arsimimin në gjuhët e pakicave nacionale. Me propozim të trupës Koordinues të këshillave nacionale të pakicave nacionale, në Këshillin nacional për arsim merr pjesë edhe një përfaqësues i cili është i angazhuar për çështjet e arsimit tek pakicat nacionale.<sup>16</sup>

**4) Enti për vlerësimin e kualitetit të arsimit dhe edukimit** merret me evoluimin e arsimimit dhe edukimit dhe jep rekomandime për vendosjen dhe sigurimin e sistemit të kualitetit të arsimimit dhe edukimit. Enti i lartpërmendur merret edhe me aftësimin profesional të punësuarve në arsim, për lëndë të caktuara shkollore sjellë standardet në arsim, është i angazhuar për përpilimin e provimeve për përfundimin e ciklit të dytë të arsimimit i cili po ashtu përkthehet edhe në gjuhët e pakicave nacionale, ndërsa në bashkëpunim me Këshillat nacionale zgjedhin bashkëpunëtore për përpilimin e provimeve për gjuhën dhe letërsinë e gjuhës amtare. Enti po ashtu përcjell edhe të arriturat e nxënësve në nivel vjetor nëpërmjet testimeve nacionale të nxënësve.

**5) Enti për tekste mësimore në kuadër të së cilit** ekziston edhe Qendra për tekste mësimore të tirazhit të ulët, në të cilat bëjnë pjesë edhe tekstet mësimore për arsimim në gjuhë të pakicave nacionale. Shpenzimet e përpilimit dhe printimit të këtyre teksteve mësimore janë më të larta se sa çmimi i këtyre teksteve në treg. Këshillat nacionale zgjedhin botues të licencuar për këtë lloj veprimtarie në Republikën e Serbisë, por, nëse asnjëri nga botuesit e përzgjedhur nuk është në gjendje të botoj tekstin mësimor të propozuar në gjuhën e pakicës nacionale, Enti për tekste është i obliguar që të bëjë një gjë të tillë.<sup>17</sup>

<sup>16</sup> Në këtë vend në vitin 2018 është emëruar Svetlana Zolnjan, nga Këshilli nacional i pakicës nacionale sllovaqe, përfaqësuese e Këshillave nacionale të të gjithë pakicave nacionale, në periudhë katërvjeçare.

<sup>17</sup> Rregullorja mbi botimin e teksteve me tirazh të ulët, neni. 9.

<http://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SlGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/ministarstva/pravilnik/2018/69/2>

**6) Agjensioni për kualifikime në Republikën e Serbisë**, në kuadër të së cilit funksionon edhe qendra ENIC/NARIC është i angazhuar për pranimin e diplomave të arritura jashtë shtetit, për nevoja të punësimit (nostrifikim profesional për nevoja të punësimit). Pranimi i diplomave të arritura në universitete jashtë vendit për qëllim të vazhimit të shkollimit të mëtutjeshëm bëhet nëpërmjet institucioneve për arsim të lartë në të cilat kandidati/kandidatja dëshiron të vazhdojë shkollimin e mëtutjeshëm, duke i paraprirë procesi i vlerësimit të programit studimor paraprak (nostrifikim akademik).<sup>18</sup>

#### **4. Roli dhe autorizimet publike të KSSH-së në sferën e arsimit**

Në avancimin e arsimit në gjuhën shqipe, si atij formal dhe atij joformal, një rol shumë të rëndësishëm e ka KSSH dhe komisioni për arsim. Prandaj është shumë e rëndësishme që ky komision të përbëhet prej kuadrove profesional të cilët janë të njoftuar jo vetëm me situatën në teren, por që i ndëgjon edhe kërkesat, që qëndron në teren, mbledh të dhëna, përpilon politika në bashkëpunim me institucionet lokale dhe qendrore dhe përcjell aplikimin dhe realizimin e këtyre politikave. Është me rëndësi të theksohet se aktivitetet e lartpërmendura janë po ashtu pjesë e Planit akcional për pakicat, prandaj është e rëndësishme që realizimi i këtij plani të përcillet nga ana e KSSH-së, njëjtë sikur e bëjnë edhe Këshillat tjera të pakicave nacionale, dhe për ecurinë e përmbushjes së këtyre qëllimeve të raportoj Zyrën për të drejtat e njeriut dhe pakicave katër herë në vit. Fatkeqësisht duhet të konstatohet se KSSH deri më sot nuk ka dorëzuar asnjë raport për realizimin e Planit akcional.<sup>19</sup>

Në mënyrë që viteve të ardhshme KSSH të mund të përballet me të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me avancimin e shkollimit dhe arsimit në gjuhën shqipe, është e nevojshme që më së pari të identifikohen problemet dhe partnerët për zgjidhjen e tyre. E po ashtu duhet të merret parasysh fakti që arsimi në gjuhën shqipe është pjesë e pandashme e procesit të përgjithshëm arsimor në sistemin e Republikës së Serbisë dhe që i njëjti po ashtu përfshihet në të gjitha ndryshimet që ndodhin në këtë sistem. Ky fakt është i rëndësishëm për shkak reformave aktuale që janë duke ndodhur e të cilat përfshijnë shkollimin fillor dhe atë të mesëm dhe të cilat sjellin ndryshimin e rregulloreve ligjore dhe akteve ligjore e nënligjore.<sup>20</sup>

Qëllimi i kësaj reforme në arsim është ngritja e nivelit të kompetencave tek nxënësit, arritja e njohurive dhe aftësive të reja nëpërmjet procesit mësimor të modernizuar dhe praktik. Në praktikë kjo reformë ka reflektuar me aplikimin e programeve të reja arsimore për shkollën fillore dhe ato të mesme. Programet e reja nënkuptojnë edhe nevojën për avancimin e mënyrës së organizimit të mësimdhënies, në radhë të parë me aftësimin profesional të kuadrove arsimore. Më pastaj, program i ri nënkupton edhe përpilimin e teksteve të

---

<sup>18</sup> Ligji mbi arsimin e lartë, neni 131 – 133.

<sup>19</sup> <https://ljudskaprava.gov.rs/sh/node/21778>

<sup>20</sup> Në vitin shkollor 2018/19 reforma në arsim ka përfshirë klasën e I dhe V të shkollës fillore dhe vitin e I të shkollës së mesme. Aplikimi i programeve të reja në vitin shkollor 2019/20 do të përfshijë klasën e II dhe VI të shkollës fillore, rrespektivisht vitin e II të shkollës së mesme. Është planifikuar që programet e reja, rrespektivisht reforma në arsimin fillor dhe të mesëm të bëhet parciaisht (pjesë pjesë) por që në tërësi të përfundoj në vitin shkollor 2021/22.

reja mësimore (por edhe paisjeve tjera shtesë të domosdoshme për organizim sa më të mirë të procesit edukativo – arsimor) dhe mënyrë të re të vlerësimit të kualitetit të mësimdhënies dhe mësimimit.<sup>21</sup>

Zgjidhja e qëndrueshme e çështjeve të cilat janë vërejtur në procesin edukativo – arsimor në gjuhën shqipe duhet të jetë në përputhshmëri me procesin reformues të sistemit të arsimit në Republikën e Serbisë. Për t’iu ofruar këtij qëllimi, KKSH duhet të filloj nga të drejtat dhe obligimet e veta të parapara dhe siguruara me Ligj:

- 1) Të marr pjesë në përpilimin e programit për përmbajtje të cilat paraqesin veçorit e pakicës nacionale shqiptare (në bashkëpunim me ekspertët e fushave të caktuara, arsimtarët dhe profesorët, institucionet);
- 2) Të jap mendim mbi programin e gjuhës serbe si gjuhej amtare (në bashkëpunim me mësimdhënësit dhe Entin për avancimin e arsimimit dhe edukimit);<sup>22</sup>
- 3) Të marr pjesë në hartimin e planit të teksteve shkollore dhe sigurimit të teksteve shkollore (nëpërmjet bashkëpunimit me mësimdhënësit, Entin për avancimin e arsimimit dhe edukimit, Entin për tekste mësimore dhe Ministrinë e arsimit);
- 4) Të angazhohet në aftësimin profesional të kuadrit arsimor (nëpërmjet bashkëpunimit me Entin për avancimin e arsimimit dhe edukimit, Entin për vlerësimin e kualitetit në arsimim dhe edukim dhe vetëqeverisjet lokale të cilat në buxhetin e tyre sigurojnë mjete për trajnimin e mësimdhënësve; këtu është shumë me rëndësi roli jo vetëm i shkollave por edhe i Drejtorive shkollore të cilat gjatë daljes në teren mund të konstatojnë kualitetin e mësimdhënies dhe kuadrove arsimore dhe të cilët, në bazë të gjendjes faktike të vërejtur në teren, të japin rekomandime për aftësimin e mëtutjeshëm të personelit arsimor dhe kualitetit të mësimdhënies);
- 5) Të angazhohet për pajisjen e shkollave dhe bibliotekave të shkollës (nëpërmjet bashkëpunimit me Ministrinë e kulturës dhe informimit e cila për çdo vit shpallë konkurs për furnizimin e bibliotekave dhe nëpërmjet bashkëpunimit me Ministrinë e arsimit).

### **Arsimimi joformal**

Duke u nisur nga nevojat e verifikuara të të rinjëve në bashkësinë shqiptare, të cilat KKSH së pari duhet t’i konstatoj dhe verifikoj, KKSH duhet që përveç arsimimit dhe edukimit formal të merret edhe me atë joformal. Në këtë aspekt, KKSH duhet të ndërtojë mekanizma në mënyrë që të:

- 1) Konstatoj nevojat e të rinjëve për edukim dhe avancim, si nëpërmjet edukimit dhe arsimimit formal edhe atij joformal;
- 2) Konstatoj mënyrën e mbledhjes të të dhënave mbi nevojat e të rinjëve;
- 3) Krijoj kontakte me bashkësinë, me qëllim të grumbullimit të të dhënave mbi nevojat e të rinjëve;

<sup>21</sup> Më shumë për këtë temë mund të gjeni në internet prezentimin e Entit për avancimin e arsimimit dhe edukimit. <https://zuov.gov.rs/nastavni-planovi-i-programi/#1557128435959-aaba5be0-1eed>

<sup>22</sup> Procesi ka përfunduar. Me rëndësi të ceket që KNSH ka dhënë mendim pozitiv mbi standardet tek lënda *Gjuha serbe si gjuhë jo amtare*, me çka edhe ka pëmbushur obligimin e vet ligjor.

- 4) Përzgjedhë mënyrën e ruajtjes të të dhënave të grumbulluara në teren mbi nevojat e të rinjëve, duke ruajtur dhe respektuar Ligjin mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe duke i përditësuar (azhurnuar) bazat e të dhënave;
- 5) Krijoj bazën e të dhënave dhe informacioneve të marra në teren që do duhej të ishin bazament të KKSH për krijimin dhe aktivitetet e rregullta dhe përpilimin e politikave të reja.

Partner për bashkëveprim në arsimin dhe edukimin joformal janë:

- 1) Pushtetet lokale – sigurojnë përkrahje për aktivitete për të rinjtë por edhe janë të obliguara që në buxhetin e tyre vjetor të ndajnë mjete për funksionimin e KKSH-së. Pushtetet lokale mund të ofrojnë përkrahje për aktivitetet e KKSH, e veçan arishte për ato aktivitetet që janë të drejtuara ka të rinjtë, nëpërmjet sigurimit të hapësirave dhe paisjeve të nevojshme për realizimin e këtyre aktiviteteve.
- 2) Ministria e rinisë dhe sportit – nëpërmjet projekteve të shoqërisë civile mund të ofroj ndihmë financiare projekteve rinore të cilat promovojnë aktivitete ndërkulturore të të rinjëve.
- 3) Shoqëria civile – mund të organizoj aktivitete arsimore, kulturore dhe hulumtuese në këto tri komuna, të promovoj kulturën shqiptare tek të rinjtë tjerë në Serbi, vet ose në bashkëpunim me KKSH mund të organizoj edhe aktivitete që promovojnë interkulturalizmin si vlerë dhe përparësi.
- 4) Këshillat e pakicave tjera nacionale – mund të ofrojnë praktika të mira në hartimin e bazave të të dhënave mbi të rinjtë në shoqëri, mund ta ndihmojnë edhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për të rinjtë.

## 5. Qëllimet strategjike në sferën e arsimit

**Qëllimi kryesor:** Ngritja e kualitetit dhe modernizimi i procesit edukativo – arsimor në gjuhën shqipe

**Qëllimet e veçantë:**

- **Avancimi i personelit arsimor i cili realizon mësimdhënien në gjuhën shqipe**

Në mënyrë që kuadri arsimor të ketë njohuri dhe kompetenca të nevojshme për të realizuar procesin e mësimdhënies nga e cila do të rezultojë edhe nxënia e dijes në mënyrë kualitative dhe mundësia që të arriturat e njëjta të aplikohen tek nxënësit, është e patjetërsueshme të përcillet procesi i cili është i bazuar në dispozitat ligjore. Në të njëjtën kohë, është me rëndësi t'i njohin të gjithë aktoret relevant të sferës së arsimit dhe edukimit.

Shkollat fillore dhe të mesme sjellin planin e aftësimin profesional të mësimdhënësve, bashkëpunëtoreve profesional, drejtorëve të shkollave dhe mbajnë evidencë mbi aftësimin profesional dhe titujt e arritur. KKSH do duhej të shfrytëzoj një pjesë të këtyre evidencave, në përputhshmëri me Ligjin mbi ruajtjen e të dhënave, dhe të jep rekomandime për aftësim profesional të mësimdhënësve në vend dhe jashtë vendit, duke pasur kujdes që trajnimet e organizuara jashtë vendit të jetë të akredituara dhe pranuar nga Ministria e arsimit të Republikës së Serbisë.



Mjetet për aftësimin profesional të të punësuarve i siguron komuna. Është e rëndësishme që KKSJ bashkë me shkollat, duke i marr për bazë evidencat të cilat i kanë mbajtur shkollat dhe këshilli mbi aftësimin profesional të mësimdhënësve, të tregojë dhe angazhohet që në buxhetet e vetëqeverisjeve lokale të parashihen sa më shumë mjete për trajnime të akredituara për mësimdhënësit. Është me rëndësi të shtohet se edhe të dhënat të cilat i posedon Drejtoria e shkollave në Leskoc e të cilat i ka marr nga tereni të merren për bazë dhe të rekomandohen si të dhëna të nevojshme për aftësimin profesional të mësimdhënësve.

Enti për avancimin e arsimit dhe edukimit organizon trajnime, seminare, organizime profesionale, përgatit dhe krijon doracak dhe broshura. Arsimimi dhe edukimi në gjuhën e pakicave është njëra prej sferave në të cilat Enti për avancimin e arsimit dhe edukimit organizon aftësime profesionale. Kjo është shumë e rëndësishme për shkak të faktit të reformës aktuale që po ndodhë në arsim. Enti ka përpiluar katalogë të programeve për aftësim profesional për të punësuarit në arsim.<sup>23</sup> Shkollat dhe KKSJ duhet të jenë të njoftuara dhe rregullisht të përcëllon faqe e internetit të Entit në mënyrë që të jenë të njoftuar me trajnimet e akredituara që u ofrohen mësimdhënësve.

Edhe Enti për vlerësimin e kualitetit të arsimit dhe edukimit organizon trajnime për aplikimin e standardeve mbi arritjet në arsimin fillor dhe të mesëm. Edhe në këtë rast, KKSJ dhe shkollat duhet të përcëllon punën e këtij Enti në sferën e aftësimin të mësimdhënësve dhe të sigurojnë mjete për aftësimin e tyre, ndërsa në koordinim me vetëqeverisjet lokale të bëjnë përpjekje për sigurimin e mjeteve për ndjekjen e trajnimeve.

KKSJ mund të kërkojë nga Ministria e arsimit edhe lejimin e aftësimin profesional jashtë konkursit për personelin arsimor të angazhuar në arsimin shqip edhe jashtë vendit. Theksojmë që i takon një rëndësie të madhe fakti që trajnimet e lartpërmendura jashtë vendit duhet të jenë të akredituara dhe që dija e arritur në këto trajnime të jetë e aplikueshme në procesin edukativo – arsimor që zhvillohet në gjuhën shqipe nëpër shkollat që ndodhen në Republikën e Serbisë.

Bashkëpunimi me Drejtoratin shkollor në Leskoc është po ashtu i rëndësishëm për arritjen e kualitetit dhe kompetencave të arsimtarëve dhe kualitetin e mësimdhënies në gjuhën shqipe. Inspektorët dhe këshilltarët arsimor të cilët dalin në teren, në bazë të metodave të caktuara, përcjellin procesin e mësimdhënies, vërejnë vështirësi të caktuara, pengesa dhe tregojnë për problemet ekzistuese. Ata japin rekomandime për zgjidhjen dhe tejkalimin e tyre. Prandaj është e rëndësishme që KKSJ të përcjell rekomandimet e drejtoratit shkollor dhe në përputhje me ato rekomandime të krijoj politika dhe aktivitetet në sferën e arsimit dhe edukimit.

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Përcaktimi i nevojave të kuadrit arsimor në gjuhën shqipe me qëllim të modernizimit dhe avancimit të teknikave të punës	KKSJ në përputhje me rekomandimet e drejtoratit shkollor, duke i përcjellore nevojat e mësimdhënësve e të cilat i kanë treguar ata vet, duke e përcjellore edhe listën e	Në fillim të vitit shkollor, në fillim të çdo semestri	Janë përcaktuar nevojat e personelit arsimor (janë përcaktuar edhe lëndët me prioritet tek të cilat është konstatuar që është i domosdoshëm intervenimi në ngritjen dhe avancimin e dijes);	Nëpërmjet komisionit për arsim KKSJ duhet të përcaktoj lëndët me prioritet për avancim dhe rritje të kualitetit në organizimin e mësimdhënies. Pas kësaj është e

<sup>23</sup> <http://www.zuov.gov.rs/starisajt/izdanja-zavoda/index.html>

	<p>trajtimeve të akredituara të Entit për avancimin e arsimit dhe edukimit dhe Entit për vlerësimin e kualitetit, e në bazë të mjeteve të siguruara nga pushtetet lokale dhe nga buxheti i KKS, KKS ndihmon në organizimin e trajtimeve.</p> <p>KKS në marrëveshje me Ministrinë e arsimit të RS ndihmon mësimdhënësit të ndjekin trajnimet e akredituara edhe në shtetet amë.</p> <p>Mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave – punojnë në vlerësimin e nevojave dhe krijojnë rekomandime për avancimin e punës.</p> <p>Pushtetet lokale – planifikojnë mjete në buxhet për trajnimin e mësimdhënësve.</p> <p>Enti për avancimin e arsimit dhe edukimit – organizon trajnime në përputhshmëri me listën e trajtimeve të akredituara.</p> <p>Enti për vlerësimin e kualitetit të arsimit dhe edukimit – organizon trajnime në bazë të listës së trajtimeve të akredituara.</p> <p>Drejtorati shkollor – në bazë të gjendjes së konstatuar në teren jep rekomandime për</p>		<p>Është përcaktuar numri i mësimdhënësve të cilët marrin pjesë në trajnime;</p> <p>Është krijuar mekanizmi për bashkëpunim me mësimdhënësit me qëllim të përcaktimit të mëtuqjeshëm të prioritetëve për hire të avancimit të procesit edukativo - arsimor</p>	<p>nevojshme që të organizohet takim me mësimdhënësit e këtyre lëndëve mësimore dhe me drejtorët e shkollave që të vërtetohen nevojat, kualifikimet dhe kompetencat (e nevojshme) të tyre.</p> <p>Duhet njëkohësisht që të konsultohet edhe drejtorati shkollor që të shihet se çfarë është vërejtur në teren dhe cilat janë rekomandimet e drejtorit për avancimin e punës së kuadrit arsimor i cili është i angazhuar për ligjërimin e lendeve në fjalë.</p> <p>Trajnimet të organizohen për ato klasë të cilat ndodhen në procesin e reformës në arsim në bashkëpunim me Entin për avancimin e arsimit dhe edukimit, Entin për vlerësimin e kualitetit të arsimit dhe edukimit ose me institucionet e shtetit amë.</p>
--	---	--	--	---

	aftësimin profesional të personelit arsimor.			
Organizimi i trajnimeve	<p>Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit – organizon trajnime</p> <p>Enti për vlerësimin e kualitetit të arsimimit dhe edukimit – organizon trajnime</p> <p>Drejtorati shkollor – ndjek trajnimet me qëllim të arritjes së dijës së nevojshme për përcjellje të mëtuqjeshme të mënyrës së realizimit të procesit edukativo – arsimor dhe për përcjelljen e efekteve të arritura nga trajnimet e organizuara</p> <p>Mësimdhënësit – grupi i synuar</p> <p>KKSH –ndjek trajnimet në mënyrë që të jenë të informuar me inovacionet në sistemin e arsimit</p>	Në bazë të përzgjedhjes së lëndëve, tre trajnime përgjatë vitit shkollor	<p>Numri i pjesëmarrësve</p> <p>Evaluumi i trajnimeve (që e përgatisin dy Entet kompetente)</p> <p>Rekomandimet e drejtoratit shkollor para trajnimeve (konstatimi i gjendjes fillestare) dhe pas trajnimeve me qëllim të konstatimit të dallimeve kualitative</p> <p>Rekomandimet e KKSH</p>	<p>Është me rëndësi që përfaqësuesit e drejtoratit shkollor të jenë të pranishëm në trajnimet e organizuara në mënyrë që të njoftohen me përmbajtjen e trajnimeve. Kjo është e rëndësishme për punën e tyre në teren dhe përcjelljen e punës së mësimdhënësve.</p> <p>Net njëjtën kohë, KKSH patjetër duhet të jetë e njoftuar me të gjitha segmentet në sferën e arsimit prandaj është e domosdoshme që personii angazhuar për arsim të jetë i pranishëm në trajnime.</p> <p>Që puna e këshillit të jetë më sistematike dhe efikase, këshilli duhet të përpiloj një raport të shkurtër që për theks te veçante ka përmbajtjen e trajnimit, reagimin e mësimdhënësve dhe evaluimin i cili sigurohet nga realizuesit e trajnimit.</p> <p>Në këtë mënyrë Këshilli mundet të krijoj aktivitetet e veta në këtë sferë dhe të avancoj kualitetin në arsim.</p>

<p>Krijimi i bazës së të dhënave të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme të bazuar në profilet profesionale</p>	<p>KKSH – në bashkëpunim me shkollat krijon bazën e të dhënave me të gjithë mësimdhënësit të cilët punojnë në realizimin e procesit edukativo – arsimor në gjuhën shqipe</p>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme – kur të krijohet baza e të dhënave është e domosdoshme që ajoazhurohet me të dhëna të reja nga tereni</p>	<p>Është krijuar baza e të dhënave me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Emrin dhe mbiemrin e mësimdhënësit</li> <li>- Aftësimin profesional</li> <li>- Vitet e përvojës së punës</li> <li>- Lëndën të cilën e ligjëron</li> <li>- Trajnimet të cilat i ka ndjekur</li> <li>- Nevojat e konstatuara për avancim të mëtutjeshëm dhe me përshkrimin e kompetencave të nevojshme.</li> </ul>	<p>Me qëllim të arritjeve sistematike në punë, por edhe rritjen e efektshmërisë, duhet që rekomandimet e Këshillit të janë të bazuara. Prandaj edhe baza e të dhënave është shtylla për funksionim të mëtutjeshëm të këshillit në shumë sfera, e në mes tjerash edhe në rritjen dhe avancimin e dijes të kuadrit profesional që punon nëpër shkollat ku mësimi organizohet në gjuhën shqipe.</p>
<p>Përcjellja e kualitetit të mësimdhënies të kuadrit arsimor i cili ka kaluar trajnimet – konstatimi i ndryshimeve gjatë mësimdhënies me qëllim të organizimit sa më kualitativ</p>	<p>KKSH – rregullisht viziton shkollat dhe konstaton gjendjen në teren  Drejtorati shkollor – në bazë të punës që bënë, rregullisht viziton shkollat, përcjell mësimin në gjuhën shqipe, shkruan raporte</p>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme</p>	<p>KKSH – përcakton masat dhe kriteriumet për vlerësim në bazë të të cilave mban procesverbale mbi gjendjen faktike në teren dhe jep rekomandime për avancimin e kualitetit në procesin edukativo – arsimor.  Rekomandimet aprovohen në Komisionin për arsim e më pastaj edhe në takimet e Këshillit ekzekutiv.  Rekomandimet e aprovuara t'i përcillen shkollave dhe drejtoratit shkollor.</p>	

- **Sigurimi i teksteve mësimore për shkollat fillore dhe të mesme në përputhshmëri me programet e reja**

Në bazë të Ligjit mbi tekstet shkollore, tekstet për shkollim në gjuhët e pakicave nacionale mund të sigurohen në tri mënyra:

- 1) Me përkthimin e teksteve mësimore të aprovuara (te lejuara për përdorim) në gjuhën serbe.

- 2) Importimin e teksteve mësimore nga shteti amë, në këtë rast nga Republika e Shqipërisë.
- 3) Shkrimin e teksteve të reja mësimore në gjuhën shqipe.

Tre modelet mund të kombinohen në përputhje me nevojat e treguara dhe kualitetin e teksteve mësimore ekzistuese.

Përgjatë përzgjedhjes së teksteve Komisioni për arsim pranë KKSH-së duhet të jetë në kontakt me mësimdhënësit, patur parasysh që ata janë njerëzit që do të shfrytëzojnë tekstet mësimore përgjatë punës së tyre me nxënësit. Në të njëjtën kohë, mësimdhënësve duhet t'i tërhiqet vëmendja që programet janë, në radhë të parë, mjetet e tyre themelore për punë, ndërsa tekste mësimore janë mjete ndihmëse që përdoren me nxënësit. Pikërisht fokusi i mësimdhënësve më shumë tek tekstet mësimore se sa tek programi na bien shpesh deri tek zvogëlimi i kualitetit në arsim, sepse programet janë shumë më të gjerë dhe gjithëpërfshirës se sa vet teksti mësimor i cili paraqet vetëm njërin prej mundësive të shumta për interpretimin e programit. Prandaj është e rëndësishme që nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të nxiten mësimdhënësit që sa më shumë të shfrytëzojnë programet, të jenë sa më kreativ në organizimin e orëve, ndërsa tekstet mësimore të jenë mjete të cilat i shfrytëzojnë nxënësit.

Ligji parasheh që KKSH në bashkëpunim me Entin për avancimin e arsimit dhe edukimit propozon planin e teksteve mësimore, Këshilli nacional për arsim jep pëlqimin mbi planin, ndërsa ministri i arsimit jep lejen. Vlerësimin profesional për tekstet e jep Entin për avancimin e arsimit dhe edukimit.

Plani i teksteve mësimore mund të përmbajë tekste të botuara në Republikën e Serbisë dhe të përkthyer në gjuhën shqipe ose tekste të botuara në shtetin tjetër e të lejuara nga Ministria e arsimit.

Në vitin shkollor 2018/2019 reforma në arsim ka përfshirë klasën e I dhe të V të shkollës fillore dhe vitin e I të shkollës së mesme. Në Katalogun e teksteve mësimore për vitin shkollor 2018/2019 ndodhen tekstet e reja shkollore për klasën e parë të shkollës fillore *Gjuha shqipe si gjuhë amtare*<sup>24</sup>, *Bota rreth nesh*<sup>25</sup>, dhe *Arti figurativ*<sup>26</sup>. Në Katalog për vitin shkollor 2019/2020 janë përfshirë edhe tekstet mësimore për klasën e I të shkollës fillore *Bota rreth nesh*<sup>27</sup> në gjuhën shqipe dhe *Matematika*<sup>28</sup> në gjuhën shqipe, të cilat janë përshtatur me reformën në arsim.

Me aplikimin e programeve të reja në vitin shkollor 2019/2020 reforma në arsim përfshin edhe klasën e II dhe IV të shkollës fillore, respektivisht vitin e II të shkollës së mesme. Në Katalogun e teksteve mësimore për vitin shkollor 2019/2020 ndodhet teksti i ri shkollor për klasën e II të shkollës fillore *Gjuha shqipe si gjuhë amtare*.<sup>29</sup>

<sup>24</sup> *Abetare*, autori: Rita Petro, Mirela Tërova, Natasha Pepivani, Flutura Çitaku, Vehbi Kadriu, botuesi: Albas, 2018.

<sup>25</sup> *Ditë natyre*, autorë: AnthonyRussell, botues: Albas, 2018.

<sup>26</sup> *Edukimi figurativ 1*, autorë: Ledia Kostandini, botues: Albas, 2018.

<sup>27</sup> *Bota rreth nesh 1* për klasën e parë të shkollës fillore (teksti mësimor dhe fletorja e punës) autorë: Simeon Marinković, Slavica Marković, Vesna Rikalo, botues: Kreativni centar, 2018.

<sup>28</sup> *Matematika 1* për klasën e parë të shkollës fillore (teksti mësimor dhe fletorja e punës) autorë: Jasmina Milinković, Nenad Matić, botues: Kreativni centar 2018.

<sup>29</sup> *Gjuha shqipe 2*, autorë: Rita Petro, Dhurata Shehri, Natasha Pepivani, botues: Albas, 2019.

Për programet e reja këshilli duhet të inicioj sigurimin e teksteve të reja shkollore në përputhje me Ligjin mbi tekstet. Që tekstet shkollore të mund të shfrytëzohen në sistemit arsimor në Republikën e Serbisë, duhet të jenë të përfshira në Katalogun e teksteve mësimore, ndërsa ka një kohë që ekziston edhe Lista digjitale e teksteve mësimore.

Mekanizëm shtesë për sigurimin e teksteve është paraparë në Planin aksional për realizimin e të drejtave të pakicave nacionale. Në lidhje me të, me qëllim të sigurimit të shpejtë dhe efikas të teksteve mësimore, Ministria e arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik, Enti për tekste mësimore dhe KKSH në vitin 2016 kanë nënshkruar memorandum me qëllim të sigurimit të teksteve mësimore.

Duhet të merret parasysh fakti që me sigurimin e teksteve mësimore sipas këtij principi nënkuptohet modeli nga Ligji për tekstet ku në fakt tekstet e lejuara shkollore në gjuhën serbe përkthehen në gjuhën shqipe. Sigurimi i teksteve nëpërmjet këtij modeli nuk nënkupton që modelet e tjera të parapara me ligj nuk janë në dispozicion. Përkundrazi, KKSH duhet të shfrytëzoj të gjitha modelet e definuara me ligj.

Në tremujorin e fundit të vitit 2018 janë aprovuar programet e reja për mësimin e lëndës së Gjuhës shqipe për klasën e II dhe klasën e VI.<sup>30</sup>

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Komisioni për arsim organizon mbledhje të rregullta me qëllim të konstatimit të numrit të teksteve që mungojnë e që janë në përputhje me reformën në arsim	Komisioni për arsim në KKSH Shtëpitë botuese- duhet të kërkohet nga shtëpitë botuese disa kopje të teksteve mësimore të cilat mëpastaj duhet t'ju jepen personave të Komisionit për arsim dhe mësimdhënësve në mënyrë që të bëjnë analizë dhe të konstatojnë përmbajtjen dhe kualitetin e teksteve Mësimdhënësit – të organizojnë takime me arsimtarët për secilën lëndëveç e veç. T'ju jepen tekstet mësimore me qëllim që të konstatohet se cili iu përshtatet mësimin në gjuhën shqipe. Drejtorët e shkollave.	Në mënyrë të vazhdueshme	Procesverbalet nga takimet e Komisionit për arsim. Është përpiluar lista e teksteve mësimore për secilën lëndë në arsimin fillor dhe atë të mesëm të cilat ndodhën në procesin e reformës në arsim. Janë lejuar në baza vjetore së paku nga tri tekste mësimore për secilin cikël arsimor (duke i kombinuar tre modelet ekzistues për sigurimin e teksteve)	Komisioni për arsim bënë planin për konstatimin e teksteve të cilat mungojnë. Në lidhje me këtë Komisioni për arsim organizon takime të ndara me mësimdhënësit e secilës lëndë mësimore të cilët mëpastaj zgjedhin cilat tekste mësimore do t'i shfrytëzojnë.  la vlenë të merret parasysh se mund të zgjidhen më shumë se një botim për lëndën e njëjte, varësisht prej dëshirave dhe

<sup>30</sup> Raporti 1/2019 mbi realizimit e PA për pakica, [https://www.ljudskaprava.gov.rs/sites/default/files/dokument\\_file/izveshtaj\\_1-2019.pdf](https://www.ljudskaprava.gov.rs/sites/default/files/dokument_file/izveshtaj_1-2019.pdf)

				nevojave të mësimdhënësve. KKSH – të krijoj bazën e të dhënave më listën e teksteve mësimore që mungojnë dhe bazën e të dhënave me tekstet e siguruar.
--	--	--	--	--

- **Përpilimi i programit arsimor për lëndët mësimore me rëndësi për kultivimin e identitetit kombëtar**

Qendra për zhvillimin e programeve dhe teksteve mësimore (në kuadër të Entit për avancimin e arsimit dhe edukimit) në vitin 2017 ka intensifikuar bashkëpunimin me këshillat nacionale me qëllim të përgatitjes së udhëzimeve për shkrimin e përmbajtjeve shtesë për lëndët mësimore të cilat theksojnë veçoritë e pakicave nacionale.

Me qëllim të përshpejtitimit dhe lehtësimit të shkrimit të përmbajtjeve shtesë, duke u bazuar në shembujt e këshillave tjera nacionale, KKSH mund të shfrytëzoj memorandumun e bashkëpunimit me Ministrinë e arsimit dhe Entit për tekste mësimore që tekstet e lejuara ekzistuese në Republikën e Serbisë, të cilat KKSH i ka zgjedhur për t'i shfrytëzuar në zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe, të plotësohen me përmbajtje specifike për kulturën shqiptare.

Në përputhje me ligjin, KKSH i propozon ministrit të arsimit bazat e programit për përmbajtjet të cilat shprehin veçoritë e pakicës nacionale shqiptare, veçanërisht nga lënda e historisë, muzikës dhe artit figurativ, për parashkolloret, filloristët dhe nxënësit e shkollave të mesme. Që këto programe t'u përgjigjen dhe përshtaten kualitetit, në mënyrë sa më të mirë të transmetojnë përmbajtjet e kulturës shqiptare tek nxënësit, dhe në të njëjtën kohë të jenë në përputhshmëri me programet e përgjithshme të lëndëve të propozuara, KKSH duhet të zgjedh ekspertë të këtyre larmive të cilët do t'i shkruajnë përmbajtjet shtesë.

Përmbajtja e cila shprehë veçoritë e pakicës nacionale shqiptare jepet si shtojcë krahas tekstit mësimor i cili shfrytëzohet për realizimin e pjesës së përshtatur të programit arsimor e i cili është i rëndësishme për pakicën shqiptare. Kjo shtojcë po ashtu quhet edhe vepër autoriale dhe ka më së shumti 16 faqe. Kjo në praktikë nënkupton që kjo shtojcë mund të ketë prej një deri në 16 faqe. Me rëndësi është që shtojca përmbajtësish t'i përshtatet promovimit dhe trashëgimit të kulturës shqiptare tek brezat e rinjë dhe të jetë në përputhshmëri me programin për lëndën mësimore në fjalë. Kjo shtojcë, kur të shkruhet, kalon nëpër procedurën e njëjtte e cila është e definuar për lejimin e teksteve mësimore. Para se të fillohet me shkrimin e përmbajtjes shtesë, duhet që KKSH të zgjedhë tekstin mësimor i cili është i lejuar për përdorim në Republikën e Serbisë në arsimimin në gjuhën serbe, e i cili do të plotësohet me shtojcën e lartpërmendur.

Ligji mbi arsimin dhe edukimin fillor thotë që nxënësit pas mbarimit të shkollës fillore duhet të kenë të zhvilluar ndjenjën e përkatësisë familjare, nacionale dhe kulturore, të njohin traditën e tyre dhe t'i kontribuojnë ruajtjes dhe zhvillimit të sajë. Në të njëjtën kohë, fëmijët e përkatësive nacionale pakicë duhet të kenë edhe ndjenjën

e përkatësisë në raport me shoqërinë e gjerë në shtetin ku janë lindur dhe të njohin, përveç të vetes, edhe kulturën e shtetit të tyre (shtetit ku jetojnë).

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
<p>Të përcaktohet mënyra e punës në programet për lëndët mësimore të rëndësishme për kultivimin e veçorive kulturore shqiptare</p>	<p>Komisioni për arsim i KKSH</p>	<p>Gjashtë muaj</p>	<p>Është përcaktuar afati kohor për krijimin e programit.</p> <p>Është formuar ekipi profesional për përpilimin e programit dhe janë caktuar afatet e punës.</p> <p>Është zgjedhur personi nga Komisioni për arsim i/e cila do të përcjell progresin në përpilimin e programit dhe do të raportoj rreth saj.</p>	<p>Gjatë përpilimit të programit, ekspertët e zgjedhur duhet të punojnë në përputhshmëri me rekomandimet dhe udhëzimet e punuara nga Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit në bashkëpunim me Këshillat nacionale të pakicave nacionale të cilat realizojnë komplet procesin edukativo arsimor në gjuhën amtare.</p> <p>Këto programe duhet të përshtaten me programet ekzistuese të definuara për atë lëndë mësimore ose atë klasë. Të punohet në programet e lëndëve mësimore të cilat janë të përfshira në reformën në arsim.</p>
<p>Të punohet në përmbajtjet të cilat mungojnë</p>	<p>Ekspert për lëndët e caktuara Komisioni për arsim</p>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme</p>	<p>Janë punuar përmbajtjet për:</p> <p>Muzika – klasët e I dhe II, V dhe VI deri në fund të vitit 2020, dhe për klasat III dhe IV, VII dhe VIII deri në fund të vitit 2021;</p> <p>Arti figurativ – për klasët I dhe II, V dhe VI deri në fund të vitit 2020, dhe për klasët</p>	<p>Janë zgjedhur ekspertët për përpunimin e përmbajtjeve për lëndët mësimore të rëndësishme për ruajtjen dhe kultivimin e veçorive kulturore shqiptare.</p>



			<p>III dhe IV, VII dhe VIII deri në fund të vitit 2021;</p> <p>Natyra dhe shoqëria – për klasat e I dhe II deri në fund të vitit 2020;</p> <p>Historia– për klasat V dhe VI deri në fund të vitit 2020, VII dhe VIII deri në fund të vitit 2022;</p>	
<p>Lejimi i përmbajtjeve shtesë për tekstet mësimore (shtojca)</p>	<p>KKSH fillon me procedurën e lejimit të këtyre programeve, në përputhshmëri me Ligjin mbi tekstet mësimore. Procedura është e njëjte me atë të lejimit të teksteve mësimore. Në mënyrë që të bëhet vlerësimi i kualitetit të përmbajtjes shtesë KKSH përkthen përmbajtjen e shkruar nga gjuha shqipe në gjuhën serbe.</p> <p>Enti për vlerësimin e arsimimit dhe edukimit – duke formuar komisionin profesional bënë vlerësimin e kualitetit të materialit të dorëzuar dhe përshtatmëri në e tij me programin ekzistues për lëndën mësimore në fjalë.</p> <p>Këshilli nacional për arsim – me marrjen e mendimit profesional Këshilli nacional për arsim jep mendimin e vet. Nëse mendimi i tyre është pozitiv, përmbajtja shtesë e tekstit mësimore iu bashkëngjitet tekstit në fjalë, i cili është i lejuar për shfrytëzim në organizmin e mësimimit dhe shkollimit në gjuhën shqipe. Këtë e bënë shtëpia e përzgjedhur botuese.</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>Programet e propozuara për lëndët në vijim sipas një dinamike si kjo:</p> <p>Përmbajtjet për:</p> <p>Muzika – për klasën e I dhe II, V dhe VI deri në fund të vitit 2020, për klasën e III dhe IV, VII dhe VIII deri në fund të vitit 2021;</p> <p>Arti figurativ – për klasën e I dhe II, V dhe VI deri në fund të vitit 2020, III dhe IV, VII dhe VIII deri në fund të vitit 2021;</p> <p>Natyra dhe shoqëria – për klasat e I dhe II deri në fund të vitit 2020;</p> <p>Historia – për klasën e V dhe VI deri në fund të vitit 2020, VII dhe VIII deri në fund të vitit 2022;</p>	<p>KKSH duhet të përcaktohet për tekstin mësimor i cili do të plotësohet me këtë shtojcë dhe të sigurojë përkthimin nga gjuha shqipe në gjuhën serbe.</p>

**- Nostrifikimi i diplomave të arritura jashtë shtetit**

KKSH duhet të përcaktojë:

- 1) Numrin e kërkesave aktuale në proces të nostrifikimit të diplomave nga universitet e huaja të dorëzuara në vitin 2015 – 2019. Kjo pjesë e grumbullimit të të dhënave duhet të realizohet në komunikim të drejtpërdrejtë me universitetet dhe fakultetet (përfshi edhe ato private) në Republikën e Serbisë dhe me qendrën ENIC/NARIC. Nga të dhënat e grumbulluara të formohet një bazë e të dhënave. Kjo data bazë do të jetë edhe themeli kryesor për punë të mëtutjeshme.
- 2) Cilat janë arsyet për aplikim për njohje të diplomave (për punësim ose për vazhdimin e shkollimit);
- 3) Me përcjellje në kontinuitet të procesit të vërtetohen arsyet e ndonjë refuzimi eventual të njohjes së diplomave. Që nostrifikimi i diplomave të bëhet më shpejtë dhe në mënyrë më efektive, KKSH duhet të jetë në kontakt të rregullt me qendrën ENIC/NARIC dhe me universitetet.

KKSH duhet të bëjë sistematizimin e të dhënave të grumbulluara që më lehtë të përcjell procesin e nostrifikimit të diplomave.

Njëri prej problemeve për shkollim të mëtutjeshëm dhe punësim në Republikën e Serbisë është edhe procesi i njohjes së diplomave të arritura në universitetet e Kosovës. Duke e marr parasysh që kemi të bëjmë me një çështje krejtësisht politike ajo shkon përtej punës së qendrës ENIC/NARIC dhe mund të zgjidhet vetëm në kuadër të dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës, sikur ka qenë rast edhe më herët.

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Përcaktimi dhe evidentimi i numrit të studentëve të cilat kanë përfunduar studimet dhe dëshirojnë të nostrifikojnë diplomat e tyre ose vetëm se ndodhen ne procesin e nostrifikimit.	Komisioni për arsim Universitetet, fakultetet Qendra ENIC/NARIC		Të dhënat e grumbulluara rreth numrit të studentëve të përfshirë në procesin e nostrifikimit të diplomave ose atyre që dëshirojnë të fillojnë procesin e nostrifikimit të diplomës	
Është formuar baza me të dhënat e studentëve që janë në proces të nostrifikimit të diplomave	Komisioni për arsim	Në mënyrë të vazhdueshme	Baza e të dhënave duhet të përmbajë në vete të dhënat e studentëve: - Rreth fakulteteve që kanë përfunduar - Statusin e nostrifikimit - Profilin e studimit	Në bazë të të dhënave të marra nga universitetet, fakultetet dhe qendrës ENIC/NARIC të bëhet një bazë me të dhëna mbi studentët dhe në atë mënyrë te përcillet

			-Vitin e përfundimit të studimeve -Informacione se kujt iu kanë drejtuar për nostrifikimin e diplomës	vazhdueshëm procesi i njohjes së diplomave.
Kampanjë me qëllim të informimit të studentëve të diplomuar mbi mënyrat e nostrifikimit të diplomave	KKSH	Në mënyrë të vazhdueshme	Të organizohet në bazë vjetore - Së paku një online kampanjë - Së paku një bashkëbisedim me të rinjët në tri komunat	

**- Modernizimi i shkollave, rregullimi i kabineteve dhe furnizimi me pajisje të nevojshme, sigurimi i mjeteve shtesë për mësimdhënësit, digjitalizimi i teksteve mësimore**

Institucionet arsimore mund të sigurojnë mjete për përmirësimin e kushteve të arsimimit dhe edukimit në aspektin e hapësirave, paisjeve dhe mjeteve shtesë nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes lokale. Në të njëjtën kohë, duhet të shfrytëzohen edhe mjetet jashtëbuxhetore nga donatorët ose sponsorët.

Në Republikën e Serbisë në realizim e sipër është edhe digjitalizimi i shkollave, rrespektivisht instalimi i teksteve digjitale në mësimdhënie dhe aftësimi e trajnimi i mësimdhënësve kompetent. Këtë aktivitet është duke e realizuar Ministria e arsimit me përkrahjen e fondeve evropiane.

Njëra prej institucioneve kyçe në këtë segment është Enti për avancimin e arsimimit dhe edukimit, në mes tjerash, në modernizimin e paisjeve dhe hapësirave të institucioneve edukativo – arsimore.

KKSH duhet në mënyrë aktive të jetë e kyçur në modernizimin e lartpërmendur nëpërmjet bashkëpunimit me Ministrinë e arsimit dhe Entit për avancimin e arsimimit dhe edukimit ashtu që të përcjell konkurset publike të ministrive në kuadër të programeve për modernizimin e shkollave. Pasi që si aplikues formal në konkurs paraqiten njësitë e vetëqeverisjeve lokale në bashkëpunim me drejtorit shkollorë, KKSH duhet që të Komunat të inicioj paraqitjen në këto konkurse dhe të jep rekomandime për modernizimin e shkollës së caktuar.

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Të vërtetohet gjendja nëpër shkollat fillore dhe të mesme: gjendja në të cilën ato gjenden dhe nevojat e tyre. Vizitë shkollave	KKSH Drejtorët e shkollave Mësimdhënësit Drejtoria shkollorë	Në çdo fillim vit shkollor	KKSH ka ndërtuar sistem për grumbullimin e të dhënave mbi gjendjen në të cilën ndodhen shkollat	Në mënyrë tabelare të paraqiten: - Gjendje në klasë, kabinete për lëndë të caktuara, salla të edukatës fizike

				<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjendje e enterierit shkollor</li> <li>- Numri i kompjuterëve me internet dhe projektorë</li> <li>- Kualiteti i paisjeve në shkollat profesionale të mesme (makineri, elektroteknike, hotelieri, drejtime të kimisë, etj.)</li> </ul>
Të përpilohet plani i furnizimit në përputhshmëri me nevojat e treguara dhe të definohet dinamika	Shkollat KKSH Pushtetet lokale	Në vazhdimësi	<p>KKSH ka shkruar së paku dy projekte përgjatë një viti</p> <p>KKSH ka shkruar, dorëzuar dhe realizuar së paku 10 projekte deri në fund të vitit 2025</p>	<p>KKSH nëse dëshiron të ndihmojë furnizimin me pajisje dhe përmirësimin e kushteve nëpër shkolla mund të shkruaj propozim projekte në mënyrë që ti ndihmoje ato të modernizojnë pajisjet shkollore dhe të avancojnë gjendjen aktuale nëpër shkolla.</p>

#### - Furnizimi i bibliotekave shkollore

Duke e pasur parasysh që Ministria e kulturës dhe informimit për çdo vit shpallë konkurs nëpërmjet të cilit nga buxheti i Republikës së Serbisë siguron publikime në gjuhët e pakicave nacionale për bibliotekat publike, KKSH këtu duhet të jetë shumë proaktiv. Pasi shkollat janë ligjrisht të obliguara të kenë bibliotekat e tyre, KKSH mund të siguroj libra nga krijimtaria moderne në gjuhën shqipe drejtpërsëdrejti nga shtëpitë botuese, me përkrahje të Ministrisë së kulturës dhe pushteteve lokale, nëpërmjet donacioneve nga shteti amë ose ambasadat.

Përveç kësaj, me qëllim të kulturës dhe informimit të përgjithshëm të të rinjëve, nuk duhet të anashkalohen edhe publikimet dhe botimet bashkëkohore në gjuhë tjera, prandaj duhet të sigurohet edhe përkthimi i librave të cilat janë interesante për fëmijët dhe të rinjët.

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Vërtetimi i gjendjes në bibliotekat e shkollave	KKSH – Komisioni për arsim	Në mënyrë të vazhdueshme	Është caktuar sistemi i grumbullimit të të	

(kjo mund të bëhet në mënyrë të standardizuar nëpërmjet pyetësorëve mbi nevojat dhe gjendjen)	Drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme Punonjësit në biblioteka		dhënave (p.sh. lista anketuese) ose baza ekzistuese e të dhënave të cilat i kanë bibliotekat e shkollave.  Është hartuar analiza e gjendjes së numrit të librave nëpër bibliotekat e shkollave.	
Është realizuar anketimi i nxënësve me qëllim të definimit të dëshirave dhe nevojave të tyre	KKSH – Komisioni për arsim Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme		Është krijuara baza me të dhënat.	Rekomandohet që Komisioni për arsim të informohet rreth shkrimtarëve bashkëkohor të cilët nuk shkruaj në ekskluzivisht në gjuhën shqipe.  Të përpilohet lista dhe t'i ofrohet fëmijëve që të zgjedhin cilat libra do të dëshironin t'i lexonin në bibliotekat e shkollave
Sigurimi i librave për biblioteka	Ministria e kulturës dhe informimit Shtëpitë botuese Ambasadat dhe donatorët	Në mënyrë të vazhdueshme	Në nivel vjetor janë siguruar pesë libra për bibliotekat e shkollave fillore dhe pesë të tjera për ato të mesme	

### - Rritja e dygjuhësisë tek të rinjtë

Korniza ligjore definojnë që, me përfundimin e shkollës, nxënësit duhet të zhvillojnë kompetencat e të shprehurit në mënyrë të shkruar dhe të folur në gjuhën amtare dhe gjuhën serbe, të njohin dhe të respektojnë identitetin dhe kulturën e bashkësive tjera etnike dhe të bashkëpunojnë me ta. Njëri prej qëllimeve të shkollimit fillor është edhe respektimi dhe kultivimi i gjuhës serbe dhe gjuhës amtare, kulturës së popullit serb dhe pakicave nacionale dhe zhvillimi i interkulturalizmit.

Nëpërmjet shkollimit duhet të zhvillohet respektimi i barazisë nacionale, kulturore, gjuhësore, fetare dhe gjinore, tolerance dhe respektimi i dallimeve; identiteti kombëtar i secilit por edhe ndjenja e përkatësisë të Republikës së Serbisë, respektimi dhe kultivimi i gjuhës serbe dhe gjuhës amtare.

Zgjidhjen e problemit rreth njohjes së pamjaftueshme të gjuhës serbe e lehtëson përpilimi i programit të ri për mësimin e gjuhës serbe si gjuhej amtare. Me qëllim të lehtësimit të zotërimit të gjuhës, për herë të parë ky program arsimor është pasuruar me standardet për këtë lëndë<sup>31</sup> në bazë të të cilët janë punuar programe krejtësisht të reja. Ajo që konsiderohet si inovacion shtesë është fakti që programi për herë të parë njihë dallimin në mes të zonave etnikisht homogjene dhe atyre etnikisht heterogjene, sepse është konstatuar që faktori shoqëri më së shumti i kontribuon mësimin të gjuhës. Patur parasysh këtë fakt, Enti për avancimin e arsimit dhe edukimit ka krijuar programin A për nxënësit që jetojnë në zonat etnikisht homogjene, rrespektivisht për nxënësit të cilët nuk kanë kontakte të përditshme me gjuhën serbe.

Programi B i dedikohet nxënësve të zonave të përziera etnike të cilët në aspektin e përditshëm kanë kontakte me gjuhën serbe. Sipas këtij program gjuhën serbe si gjuhë jo amtare e mësojnë edhe nxënësit gjuha amtare e të cilëve është e ngjashme me gjuhën serbe.

Është me rëndësi të përmendet që kjo është njëra prej lëndëve mësimore të rralla për të cilën janë punuar standardet e të arriturave, ndërsa për aplikimin më të lehtë të këtyre standardeve Enti për vlerësimin e kualitetit të arsimit dhe edukimit në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Serbi kanë punuar doracakun për mësimdhënësit.<sup>32</sup> Mësimdhënësit kanë kaluar trajnimin me qëllim të përvetësimit më të lehtë të standardeve, patur parasysh që ky dokument paraqet një risi në sistemin edukativo – arsimor. Këto trajnime janë akredituar nga Ministria e arsimit.

Si mjete ndihmëse në mësimdhënie, pas aprovimit të programeve të reja, Enti për avancimin e arsimit dhe edukimit në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Serbi për mësimdhënësit ka përpiluar doracak me qëllim të zotërimit të leksikës.<sup>33</sup> Sjellja e programeve të reja po ashtu është përcjellore me trajnime të akredituara për mësimdhënësit.

Përgjatë përpilimit të programeve dhe standardeve të reja janë kërkuar mendimet e të gjitha këshillave nacionale të pakicave nacionale që përfaqësojnë bashkësitë etnike të cilët procesin edukativo - arsimor e zhvillojnë krejtësisht në gjuhën e tyre amtare.

Zgjidhjen e problemeve, megjithatë, e vështirësojnë institucionet e ndara arsimore, shkollimi i ndarë dhe kompetencat relativisht të ulta të kuadrove arsimore.

Duke patur parasysh që integrimi është proces i dyanshëm, do të ishte krejtësisht në rregull që mësimdhënësit që nuk i përkasin bashkësisë shqiptare, e të cilët kryesisht ligjërojnë lëndën e gjuhës serbe si gjuhëjo amtarë, të mësojnë edhe bazat dhe gjërat elementare në gjuhën shqipe. Këshilloj praktikash ka patur duke iu falënderuar iniciativës së Misionit të OSBE-së në Serbi, ndërsa mësimdhënësit kanë shprehur dëshirën e tyre për të mësuar gjuhën amtare të nxënësve të tyre.

---

<sup>31</sup> Rregullorja mbi standardet e përgjithshme të të arriturave për lëndën *gjuhë serbe si gjuhë jo amtare* për përfundimin e ciklit të parë dhe të dytë të shkollimit obligativ, shkollimit të përgjithshëm dhe shkollimit fillor të të rriturve, GZ. RS numër 55/17. Përmbajtja e standardeve është në dispozicion në faqen e Ministrisë së arsimit [http://www.mpn.gov.rs/ep\\_content/uploads/2015/09/Prilog-Standardi-za-srpski-kaonematernji-jezik.pdf](http://www.mpn.gov.rs/ep_content/uploads/2015/09/Prilog-Standardi-za-srpski-kaonematernji-jezik.pdf)

<sup>32</sup> Mësimdhënësit e të gjitha shkollave në të cilat mësimi organizohet në gjuhën e pakicave janë pajisur me nga një doracak i cili njëkohësisht është i publikuar në faqen e Misionit të OSBE-së në Serbi <https://www.osce.org/sr/mission-to-serbia/332541>

<sup>33</sup> Leksika e rekomanduar për ciklin e parë të shkollimit obligativ ndodhet në faqen e internetit <https://www.osce.org/sr/mission-to-serbia/402473>. Për mësimdhënësit të cilët ligjërojnë në ciklin e dytë, rrespektivisht tretë, doracakët do të sigurohen në shtator.

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Konstatimi i numrit të mësimdhënëseve të cilët dëshirojnë të mësojnë gjuhën shqipe	KKSH Mësimdhënësit e shkollave fillore Profesorët e shkollave të mesme Drejtorët e shkollave	Dy muaj	lu është dorëzuar pyetësoni shkollave Shkollat kanë kthyer pyetësonët e plotësuar KKSH-së Është krijuar baza me të dhënat mbi mësimdhënësit të cilët dëshirojnë të mësojnë gjuhën shqipe	
Organizimi i kursit të gjuhës shqipe për mësimdhënësit	KKSH	Gjashtë muaj	Së paku dhjetë mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme kanë ndjekur kursin e gjuhës shqipe	

## 6. Rekomandimet për Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi në sferën e arsimit

- 1) Të krijohet dhe rregullisht azhurohet (përditësohet) baza e të dhënave mbi numrin e nxënësve në shkollat fillore, duke respektuar të dhënat personale, me qëllim të përcjelljes së numrit të nxënësve dhe nevojave të tyre.
- 2) Të krijohet dhe rregullisht të azhurohet (përditësohet) baza e të dhënave mbi numrin e nxënësve në shkollat e mesme sipas profileve, me qëllim të përcjelljes së numrit të nxënësve dhe nevojave të tyre.
- 3) Të krijohet dhe rregullisht të azhurohet (përditësohet) baza e të dhënave mbi studentët në Republikën e Serbisë, duke i klasifikuar sipas fakulteteve dhe profileve arsimore, me qëllim të krijimit të politikave për të rinjtë, definimit të nevojave të tyre dhe nevojave të shoqërisë për profilet e caktuara .
- 4) Të përcaktohet mënyra e përkrahjes me bursa në përputhshmëri me rezultatet e studentëve dhe nevojave të shoqërisë për profilet e caktuara (në bashkëpunim me pushtetet lokale, institucionet shtetërore në Republikën e Serbisë, donatorët, etj.)
- 5) Të përcaktohen shpërblimet vjetore për nxënësit më të mirë dhe më të talentuar të tri komunave. Të vendoset theks i veçantë në përfshirjen e barabartë të të dy gjinive.
- 6) Të krijohet dhe rregullisht të azhurohet (përditësohet) baza e të dhënave me kuadrot arsimor në shkollat fillore, e bazuar në profilet e tyre dhe përfshirjen e tyre në aftësimet profesionale.
- 7) Të krijohet dhe rregullisht të azhurohet (përditësohet) baza e të dhënave me kuadrot arsimor në shkollat e mesme e bazuar në profilet e tyre dhe përfshirjen e tyre në aftësimet profesionale.

- 8) Në secilën bazë të të dhënave të inkuadrohet edhe struktura e gjeneratave dhe gjinisë (mosha dhe gjinia).
- 9) Të shfrytëzohen bazat e të dhënave të përpiluara nga mësimdhënësit në lidhje me nevojat e tyre për aftësim profesional.
- 10) Në koordinim me shkollat, Drejtoratin shkollor, me ndihmë financiare të siguruar nga pushtetet lokale e në bashkëpunim me dy Entet (për avancimin e arsimimit dhe edukimit dhe për vlerësimin e kualitetit të arsimimit dhe edukimit), të organizohen trajnime për mësimdhënësit.
- 11) Në bashkëpunim me mësimdhënësit, për secilën lëndë mësimore veç e veç, të përpilohet tabela me tekstet mësimore të cilat mungojnë dhe e njëjta të azhurohet (përditësohet) rregullisht. Tabela duhet të përfshijë ato klasë të cilat ndodhen në procesin e reformës në arsim. Në bazë të të dhënave të siguruara, të përpilohet dhe në mënyrë të vazhdueshme të përditësohet baza e të dhënave e cila përmbana listën e teksteve mësimore të lejuara dhe atyre që mungojnë, përfshi këtu edhe shtojcat për programet me rëndësi të veçantë për kultivimin e identitetit kombëtar.
- 12) Të përdoren të gjitha modelet që ndodhen në dispozicion për sigurimin e teksteve mësimore të cilat mungojnë.
- 13) Të punohet në krijimin e bibliotekave bashkëkohore nëpër shkolla.
- 14) Të përcaktohet lista me institucione arsimore që i përkasin rëndësisë së veçantë për pakicën nacionale shqiptare.
- 15) Në kontakt me institucionet përgjegjëse të Republikës së Serbisë të iniciohet çështja e nostrifikimit të diplomave të arritura në universitetet e Kosovës.
- 16) Të rinjët të informohen rregullisht mbi procedurat e nostrifikimit të diplomave të arritura jashtë shtetit. Të sigurohet përkrahja ndaj të rinjëve duke bashkëpunuar me qendrën ENIC/NARIC, fakultetet dhe universitetet, në përputhshmëri me nevojat dhe arsyet e nostrifikimit të diplomave.
- 17) Të avancohet bashkëpunimi me të rinjët me qëllim të përcaktimit dhe identifikimit të dëshirave dhe nevojave të tyre në sferën e arsimimit joformal. Të përcaktohen mekanizmat e bashkëpunimit me të rinjët, të krijohet baza e të dhënave e cila duhet të përditësohet me të dhënat e siguruara nga tereni. Në bazë të të dhënave të siguruara nga tereni të organizohen aktivitete me qëllim të realizimit të nevojave të parashtruara nga të rinjët. Të shtohet vëmendje në përfaqësimin gjinorë dhe inkuadrimit e të rinjëve nga fshatrat.
- 18) Të vazhdohet bashkëpunimi me Këshillat nacionale të pakicave tjera nacionale dhe të organizohen aktivitete jashtëshkollorë me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit në mes të të rinjëve me prejardhje të ndryshme etnike.
- 19) Të ndërtohet bashkëpunim dhe partneritet me organizatat e shoqërisë civile me qëllim të krijimit dhe organizimit të aktiviteteve shkollorë joformale të bazuar në nevojat e të rinjëve. Në këso aktivitete, në mënyrë të barabartë, duhet të inkuadrohen të rinjët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Vëmendje



të veçantë duhet kushtuar inkuadrimit të vajzave në përgjithësi, e vajzave nga vendet rurale në veçanti.

- 20) Në bashkëpunim me organet dhe institucionet përgjegjëse të shikohet mundësia e hapjes së drejtimeve të reja të arsimit të lartë, në hapësirat që shfrytëzohen nga Paralelja e Fakultetit Ekonomik në Bujanoc.

# RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I KULTURËS SË PAKICËS NACIONALE SHQIPTARE

---

## 1. Hyrje

Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi i krijimtarisë kulturore bashkëkohore janë dy pikëpamje themelore të secilës kulturë. Në shoqëritë me shumëllojshmëri të kulturave, fakteve të lartpërmendura duhet t'i shtohet edhe shkëmbimi në këtë sferë dhe bashkëpunimi i përshtatshëm dhe i ndërsjellë në mes të kulturave të ndryshme. Në këtë aspekt, kultura e pakicës nacionale shqiptare është pjesë e pandashme e skenës dhe trashëgimisë kulturore në Republikën e Serbisë dhe si njëra prej kulturave të shumta të pakicave nacionale, përveç që ka cilësitë e veta, ajo ndanë edhe cilësitë e sistemit të përgjithshëm në përgjithësi. Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore (materiale dhe jo materiale) të pakicës nacionale shqiptare në Serbi kërkon bashkëpunimin e të gjithë akterëve, atyre individual dhe kolektiv, institucional dhe jashtë institucional. E njëjta vlen edhe për sferën e krijimtarisë bashkëkohore.<sup>34</sup> Argument i fortë dhe motivim për të vepruar në kulturë është fakti që ajo përfaqëson mjetet efikase për arritjen e kohezionit shoqëror dhe shpërndarjen e frymës së tolerancës dhe respektimit të ndërsjellë.

Sfera e kulturës në Republikën e Serbisë është institucionalisht e zhvilluar, normativisht e rumbullaksuar me ligjet të cilat përcjellin trendet e politikave kulturore në rajonin e gjerë, por megjithatë, disponon me resurse të pakta financiare për një zhvillim të plotë të të gjithë potencialeve kreativ.<sup>35</sup> Për fat të keq, Serbia në këto momente nuk ka as të aprovuar dokumentin strategjik me anë të së cilit përcaktohen prioritetet dhe drejtimit për të vepruar në sferën e politikave kulturore. Strategjia për zhvillimin e kulturës në Republikën e Serbisë 2019 – 2029 është në fazën e pritjes për aprovim në Kuvendin popullor. Drafti i strategjisë në pikëpamjen e kulturave të pakicave nacionale është mjaftë inkluziv, si në përmbajtje, po ashtu edhe në procesin e përpilimit.<sup>36</sup> Njëra prej kapitujve më të rëndësishme të strategjisë është mbrojtja e kulturave të pakicave nacionale, e përveç kësaj, strategjia parasheh edhe mundësinë që në bashkëpunim me përfaqësuesit e pakicave nacionale të shqyrtohen të gjitha mundësitë institucionale për avancimin e krijimtarisë së tyre, përfshi këtu edhe mundësinë për themelimin e enteve shtesë për kulturat e pakicave nacionale.

Duke e pasur parasysh që sikurse të drejtat tjera të pakicave nacionale edhe e drejta për të mbrojtur dhe zhvilluar kulturën e tyre, në masë të madhe realizohet në nivelin lokal, kushtet në të cilat funksionojnë institucionet kulturore të pakicave nacionale janë shpesh të papërshtatshme. Tri komunat në jug të Serbisë në të cilat jeton numri më i madhë i pakicës nacionale shqiptare, në aspektin e zhvillimit rajonal, paraqesin rajonin më të pazhvilluar në vend.

---

<sup>34</sup> Krijimtaria bashkëkohore ngërthen në vete pikëpamje të ndryshme të kulturave, nga letërsia dhe botimet, nëpërmjet teatrit dhe filmit, muzikës, paraqitje të ndryshme si baleti, vallëzime bashkëkohore, arti, etj. Gjithsesi nuk duhet të harrohet edhe i ashtuquajturit arti i rrugës i cili është më tërheqës për të rinjtë dhe më së shpeshti realizohet në formën e grafitëve dhe paraqet artin e të gjithëve, rrespektivisht ka karakter publik.

<sup>35</sup> Buxheti i ministrisë së kulturës dhe informimit në sferën e kulturës për vitin 2019 kap vlerën prej 0.74% nga buxheti i përgjithshëm i Republikës së Serbisë.

<sup>36</sup> Në fazën e përpilimit të strategjisë kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e këshillave nacionale.

Sistemi i kulturës së pakicës nacionale shqiptare mbijeton në një rreth në të cilin ekziston numër i vogël i institucioneve kulturore dhe në dispozicion ka shumë pak resurse programore, kadrovike dhe financiare. Sa për ilustrim, në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë nuk ekziston asnjë muze, galeri ose arkiv. KKSH ende nuk ka iniciuar ndonjë iniciativë për themelimin e Entit për kulturë të pakicës nacionale shqiptare, ndërsa vetëqeverisjet lokale ndajnë mjete të pakta për numrin e vogël të evenimenteve kulturore në shtëpitë ekzistuese të kulturave. Këtë gjendje të zymtë në kulturën e pakicës shqiptare duhet plotësuar edhe me faktin që, pothuajse, nuk ekziston asnjë shkëmbim përvojash e idesh me artistët e Serbisë, e aq më pak me artistët e rajonit, dhe që numri i shoqatave aktive në sferën e kulturës e sidomos në sferën e krijimtarisë bashkëkohore, është shumë i vogël.

Të gjitha të lartpërmendurat janë argumente për veprim sistematik të KKSH në sferën e kulturës me qëllim, jo vetëm për të ruajtur elementet tradicionale të kulturës, por për të nxitur para së gjithash elemente që kanë të bëjnë me krijimtarinë bashkëkohore.

## **2. Realizimi i të drejtës për mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare – pasqyrimi i gjendjes**

Jeta kulturore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë zhvillohet brenda një numri të vogël të institucioneve dhe shoqatave aktive në sferën e kulturës, në kushte jashtëzakonisht të vështira financiare. Në aspektin e llojit të evenimenteve, shumica prej tyre janë të karakterit tradicional e folklorik dhe manifestime zbavitëse. Në këto komuna në mënyrë kronike ka mungesë të mjeteve për të rinovuar objektet e për të investuar në infrastrukturë, ka mungesë të mjeteve për programeve inovative, dhe karakterizohen me numër të pamjaftueshëm të kuadrit profesional, e shpeshherë karakterizohen edhe me mbylljen (izolimimin) për të bashkëpunuar me artistë të lirë të cilët do të kishin krijuar dhe ofruar përmbajtje të reja për publikun e ri.<sup>37</sup>

Në secilën prej këtyre tri komunave ekziston shtëpia e kulturës dhe biblioteka dhe ato janë qendrat e të gjitha evenimenteve kulturore. Në Shtëpinë e kulturës *Abdulla Krashnica* në Preshevë ndodhet biblioteka *Mehmet Jusufi* dhe skena e teatrit profesional lokal. Në Shtëpinë e kulturës *Vuk Karaxhiq* në Bujanoc është e vendosur edhe biblioteka *14 Nëntori* me nëndegët e saja në katër fshatra. Në Medvegjë ekziston Shtëpia e kulturës dhe biblioteka *Petar Petrovic Njegosh*. Në aspektin e paisjeve të bibliotekave, është ilustruar shembulli i bibliotekës në Bujanoc e cila disponon me një numër të vogël të librave në gjuhën shqipe.<sup>38</sup>

Biblioteka në Preshevë relativisht shpesh organizon mbrëmje letrare dhe prezantime të librave të autorëve shqiptar bashkëkohor nga rajoni. Në këtë fushë krijon bashkëpunim edhe me shkrimtarët e mbledhur rreth

---

<sup>37</sup> Pasuria kulturore e Serbisë lindore dhe jugore, ZAPROKUL, 2012, në dispozicion në linkun: <http://zaprokul.org.rs/wp-content/uploads/2015/01/KulturnoBogatstvoRJIS.pdf>

<sup>38</sup> Fondi i bibliotekës në Bujanoc numron rreth 46.000 libra, prej të cilave 39.600 janë në gjuhën serbe: duke i llogaritur edhe nëndegët në katër fshatra fondi i përgjithshëm i teksteve kap numrin rreth 65.000, burimi: <https://bibliotekabujanovac.rs/fond-biblioteke/>

Shoqatës së shkrimtarëve *Feniksi* nga Presheva të cilët për çdo vit realizojnë projektin *Karvani i shkrimtarëve të Luginës*.<sup>39</sup>

Në programet e shtëpive të kulturave në këto tri komuna më së shpeshti organizohen manifestime vjetore. Ndër manifestimet më të vjetra dhe më të vizituara janë *Ditët e komedisë në Preshevë*, festival që organizohet nga viti 2003 dhe paraqet komeditë më të mira të realizuara nga trupat e artistëve nga rajoni dhe nga vetë komuna nikoqire, Presheva. Aktiviteti tjetër i rëndësishëm kulturor në Preshevë është festivali i këngës për fëmijë *Gëzimi ynë*, në të cilin marrin pjesë fëmijët e shkollave fillore nga komuna e Preshevës, Bujanocit, Kumanovës dhe Gjilanit, e i cili organizohet nga viti 2006. Në Preshevë veprojnë edhe tri Shoqata kulturore – artistike (SHKA). Është evidente që Shtëpia e kulturës në Preshevë është epiqendër (e një numri të vogël) të aktiviteteve kulturore<sup>40</sup>, në të cilën nga viti 2010 organizohet edhe manifestimi që ka të bëjë me konkursin ndërkombëtarë të fotografisë e që quhet *PreFoto*.

Shtëpia e kulturës në Bujanoc për çdo vit organizon manifestimin *Vera kulturore* në kuadër të së cilit bëhet prezantimi i trashëgimisë folklorike të rrethit të Bujanocit nëpërmjet paraqitjeve të 5 SHKA-ve: dy shqiptare, *Zëri i Luginës* dhe *Jehona*, dy serbe, *Kolo* dhe *Soko* dhe një rome *SHKA Zulfiqar Bajramovic*. Përmbajtjet tjera të manifestimeve janë kryesisht të karakterit zbavitës (koncerte me muzikë pop dhe muzikë popullore).

Në shtëpitë e kulturës në Preshevë dhe Bujanoc shfaqen edhe filma në gjuhën shqipe, rrespektivisht serbe (me përkthime në njërin prej këtyre gjuhëve).

Në komunën e Medvegjës në fshatin Tupallë të banuar kryesisht me shqiptar, nga viti 2003 mbahet manifestimi kulturor dhe sportiv *Takimet e vendlindjes* në të cilat marrin pjesë edhe një numër i SHKA-ve.

Shtëpitë e kulturave në Preshevë dhe Bujanoc nuk paraqesin instucione ngushtë të specializuara për vetëm një veprimtari në kulturë, por ato merren me forma të ndryshme të programeve kulturore.

Qendra më e re multimediale e kulturore është hapur, me përkrahje të Republikës së Shqipërisë, në ndërtesën ku është i vendosur Këshilli kombëtar shqiptar në Serbi në Bujanoc dhe iu është dedikuar organizimit të seminareve, ekspozitave, punëtorive dhe aktiviteteve tjera.

Përgjatë pasqyrit të gjendjes, duhet të përmendet edhe fakti që manifestimet kulturore dhe zbavitëse kanë karakter shumë të vogël integruar pasi që nuk ka, pothuajse aspak, shkëmbime të përmbajtjeve dhe aktivitete të përbashkëta me kulturat tjera që po ashtu ekzistojnë në këto komuna. Manifestimet organizohen në atë mënyrë sa që kulturat mbeten të izoluara, dhe bukvalishtë jetohet njëri pran tjetrit, duke mos pasur bashkëpunim ndërmjet akterëve që punojnë në kulturë dhe duke pasur një publik të ndarë në baza nacionale.

---

<sup>39</sup> Shoqata është themeluar në vitin 1975 ndërsa nga viti 2011 është regjistruar si shoqatë e shkrimtarëve e cila aktualisht numëron rreth 30 anëtarë nga Preshev, Bujanoc dhe Medvegja, burimi: <http://www.titulli.com>

<sup>40</sup> Këto dhe përmbajtjet tjera financohen nga bixheti i komunës së Preshevës, e cila për kulturë ka ndarë 5,7% në vitin 2018. Duhet edhe të përmendet që Shtëpia e Kulturës *Abdulla Krashnica* dhe biblioteka *Mehmet Jusufi* janë institucinet e vetme që mbulojnë kulturën shqiptare e të cilat ndodhen në portalin për kërkim të digjitalizuar të trashëgimisë kulturore në Republikën e Sërbisë, <https://kultura.rs/>, [https://a3.geosrbija.rs/ustanove\\_kulture](https://a3.geosrbija.rs/ustanove_kulture)

### 3. Korniza normative dhe institucionale për kulturën e pakicës nacionale shqiptare

#### 3.1 Korniza normative

E drejta për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën e pakicave nacionale është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, ligje dhe dokumente ndërkombëtare ligjërish të obligueshme, për pjesëtarët e pakicave nacionale. Në Kushtetutën e Republikës së Serbisë, përveç të drejtave që iu kanë garantuar të gjithë qytetarëve, të drejta shtesë individuale dhe kolektive i garantohen pjesëtarëve të pakicave nacionale. Njëra prej këtyre të drejtave është edhe e drejta për të ruajtur veçorit, të cilat në nenin 79. specifikohen si të drejta mbi ruajtjen, kultivimin, zhvillimin dhe shprehjen publike të veçorive.

Ligjet më të rëndësishëm me anë të të cilëve garantohet e drejta e pjesëtarëve të pakicave nacionale për të ruajtur dhe kultivimin e kulturës së tyre janë Ligji mbi kulturën, Ligji mbi veprimtarinë e bibliotekave dhe informacioneve dhe Ligji mbi të mirat kulturore, por edhe një numër i madhë i akteve ligjore siç janë rregullat, vendimet, rregulloret.<sup>41</sup> Në dokumentet e lartpërmendura bëjnë pjesë edhe Udhëzimet për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore në Serbi, me anë të së cilave janë përcaktuar standardet për të gjitha institucionet dhe pjesëmarrësit në procesin e digjitalizimit dhe janë definuar zgjidhjet unike softuerike (sistemi informativ) për muze, arkiva, ente për mbrojtjen e monumenteve.<sup>42</sup>

Ligji mbi veprimtarinë e bibliotekave dhe informacioneve përcakton që bibliotekat të pajisen me të gjitha materialet e nevojshme në përputhshmëri me nevojat më të gjera të shfrytëzuesëve të shërbimeve të bibliotekave, marr parasysh edhe nevojat e pakicave nacionale. Në bazë të këtij Ligji, biblioteka është e obliguar të formojë fonde të librave të cilat gjinden në dispozicion edhe në gjuhën shqipe. Për çdo vit Ministria e kulturës shpall konkurs për sigurimin e librave në gjuhët e pakicave nacionale e për të cilën KKSH duhet të dorëzojë mendimin Komisionit për sigurimin e librave dhe të iniciojë pajisjen me libra në gjuhën shqipe nga krijimtaria bashkëkohore, pasi të ketë përcaktuar nevojat e bashkësisë.

Ligji mbi të mirat kulturore në mënyrë eksplicite përmend që të mirat e palëvizshme kulturore si monumentet kulturore, hapësirat kulturore – historike, gjetjet arkeologjike dhe vendet e njohura, veprat artistike – historike, materiale të arkivës, filmat e vjetër, librat e rrallë të vjetër, janë të mira kulturore.

Legjislacioni shtesë i cili e forcon të drejtën e pjesëtarëve të pakicave nacionale për të mbrojtur dhe zhvilluar kulturën e tyre përbëhet nga Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale dhe Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale.

Plani akcional për realizimin e të drejtave të pakicave nacionale në pjesën e III merret me kulturën dhe mediat. Si qëllime të veçanta strategjike në sferën e kulturës, Plani akcional përmend ruajtjen e kulturës, të mirave kulturore dhe trashëgiminë jo materiale të cilat janë të një rëndësie të veçantë për pakicën nacionale e po ashtu potencon kulturën e avancuar të respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, thyerjen e paragjykimeve dhe segregimit, veçanërisht në zonat multietnike parashih edhe marrëdhënien midis të rinjëve nga etnitetet e ndryshme.

<sup>41</sup><http://www.kultura.gov.rs/lat/dokumenti/propisi-iz-oblasti-kulture/strana/1>

<sup>42</sup><http://www.kultura.gov.rs/lat/dokumenti/propisi-iz-oblasti-kulture/smernice-za-digitalizaciju-kulturnog-nasledja-u-republici-srbiji>

## **Standardet ndërkombëtare të rëndësishme për realizimin e të drejtës mbi ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare**

Serbia është nënshkruese e shumë dokumenteve ndërkombëtare të cilat në kuadër të drejtave të njeriut dhe pakicave sugjerojnë respektimin e shumëllojshmërisë kulturore dhe kultivimin e interkulturalizmit si të mira të shoqërisë. Gjëja e përbashkët që karakterizon të gjithë këto dokumente ndërkombëtare është kuptimi i faktit që qasja mbi të drejtat e njeriut mund të sigurohet vetëm në shoqëritë në të cilat dialogu, mirëkuptimi dhe shumëllojshmëria kulturore shihen si burim i pasurimit dhe jo ndarjes. Me nënshkrimin e Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, Serbia është obliguar që të krijoj kushtet e nevojshme në mënyrë që pjesëtarët e pakicave nacionale do të mund të ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë të gjitha elementet e nevojshme të identitetit të tyre, përfshi këtu edhe trashëgimin kulturore.

Karta evropiane mbi gjuhët e pakicave dhe rajonit ka vënë theks në obligimin e shtetit që të ruaj dhe promovojë gjuhët rajonale dhe të pakicave si pjesë të trashëgimisë kulturore, rrespektivisht të ofrojë përkrahje dhe të sigurojë lehtësime institucioneve kulturore të cilat në aktivitetet e tyre përfshijnë përmbajtje të prodhuara në gjuhën e pakicave nacionale, si dhe të ofrojë përkrahje për folësit e asaj gjuhe me qëllim të integritit.

Të rëndësishme për kulturën janë edhe dokumentet e Kombeve të Bashkuara për arsim, shkencë dhe kulturë (UNESCO): Deklarata Universale mbi shumëllojshmërinë kulturore (2001) dhe Konventa mbi ruajtjen dhe promovimin e shumëllojshmërisë së shprehjes së kulturave (2005). Dokumenti i parë është i rëndësishëm për shkak se e bënë zgjerimin e nocionit të kulturës në krahasim me *dallimet shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale të përmbajtjeve të shoqërisë ose grupimeve shoqërore, në të cilën përfshihen, përveç artit dhe literaturës, stilet e jetës, mënyrat e jetesës së përbashkët, sistemi i vlerave, traditave dhe besimit* dhe në këtë mënyrë mundëson qasje krejtësisht të re, gjithëpërfshirëse dhe efektive ndaj kulturave të pakicave nacionale. Në anën tjetër, Konventa mbi ruajtjen dhe promovimin e shumëllojshmërisë së shprehjes është instrumenti i parë ndërkombëtar i cili rregullon çështjen e ruajtjes dhe zhvillimit të shumëllojshmërisë kulturore, me çka ndikohet rëndësishëm në realizimin e të drejtave dhe lirive elementare të qytetarëve dhe të drejtave të pakicave nacionale të garantuara me legjislacionin nacional. Disa prej qëllimeve themelore të Konventës së lartpërmendur janë po ashtu kultivimi i interkulturalizmit me qëllim të zhvillimit të bashkëveprimit kulturor dhe avancimin e respektimit të shumëllojshmërisë e po ashtu edhe zgjerimin e vetëdijes mbi vlerat e shumëllojshmërisë në nivelin lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Në listën e marrëveshje të nënshkruara biletarela në sferën e kulturës, në fuqi ndodhet edhe Marrëveshja mbi bashkëpunimin shkencor, arsimor dhe kulturor në mes të Republikës federative të Jugosllavisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, e nënshkruar në vitin 1988, e që është ende në fuqi.<sup>43</sup>

---

<sup>43</sup><http://www.kultura.gov.rs/lat/medjunarodna-saradnja/medjunarodna-dokumenta>

### 3.2 Korniza institucionale

Institucionet më të rëndësishme që marrin pjesë në sigurimin e të drejtave të pakicës nacionale shqiptare që të angazhohet në ruajtjen dhe avancimin e kulturës së vet janë: Ministria e kulturës dhe informimit, Këshilli nacional për kulturë dhe Biblioteka kombëtare e Serbisë.

**1) Ministria e kulturës dhe informimit** përkujdeset për realizimin e të drejtave për veçorit kulturore të pakicës nacionale në kuadër të Sektorit për trashëgimi kulturore dhe veprimtari të bibliotekave dhe Sektorit për krijimtari bashkëkohore dhe industri kreative. Nga viti 2007 ministria shpall konkurse për bashkëfinancimin e projekteve dhe programeve në sferën e krijimtarisë bashkëkohore kulturore të pakicave nacionale. Me projekte që kanë të bëjnë me kulturën e pakicave nacionale mund të konkurrohet edhe në konkurse tjera për – botime, përkthime të pjesëve në gjuhën e pakicave nacionale, digjitalizime të trashëgimive kulturore dhe krijimtarive bashkëkohore, ruajtjen dhe përfaqësimin e trashëgimisë kulturore jo materiale, hulumtime profesionale dhe shkencore në kulturë. Ministria e kulturës dhe informimit në nivel vjetor shpall konkurse për sigurimin e librave në gjuhët e pakicave nacionale për bibliotekat publike. Përzgjedhjen e librave në gjuhët e pakicave nacionale e bënë komisioni i ministrisë duke marr mendimin e këshillit nacional të asaj pakice nacionale dhe bibliotekave publike të cilave edhe iu dedikohet kjo blerje.

**2) Këshilli nacional për kulturë** është organ rregullativ, profesionist e këshillëdhënës i cili Kuvendit popullor, Ministrisë së kulturës dhe Qeverisë i siguron dhe ofron përkrahje të vazhdueshme profesionale rreth çështjeve që kanë të bëjnë me ruajtjen, zhvillimin dhe zgjerimin e kulturës. Ky organ përgatit strategjitë nacionale në sferën e kulturës, rrespektivisht definojnë qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit kulturor të Serbisë për periudha 10 vjeçare. Këshilli numëron njëzet anëtarë prej të cilëve dy vijnë nga pakicat nacionale, e që do duhej të zgjidhen me propozim të Koordinimit të pakicave nacionale.<sup>44</sup>

**3) Biblioteka kombëtare e Serbisë (BKS)** është institucioni amë për rrjetin e bibliotekave. BKS kryen katalogimin e të gjitha materialeve dhe informacioneve për bibliotekat, ndihmon funksionimin e bibliotekave publike, punon në trajnimin profesional të personelit të angazhuar në biblioteka, organizon shkëmbimin e materialeve me bibliotekat në vend dhe jashtë vendit. BKS, përveç Ministrisë së kulturës, është po ashtu e kyçur në blerjen e librave në gjuhët e pakicave nacionale. Përveç kësaj, BKS disponon edhe me katalogun e madhë në të cilin janë të inkuadruara të gjitha librat të cilat ndodhen në dispozicion në të gjitha bibliotekat publike në Republikën e Serbisë. Prandaj ky katalog mund të jetë i shfrytëzueshëm edhe për Këshillat nacionale të pakicave nacionale kur bëhet fjalë për librat në gjuhët e pakicave.

Akterët tjerë të rëndësishëm për zhvillimin dhe ruajtjen e veçorive të kulturës shqiptare, promovimin e saj dhe nxitjen e depërtimit dhe bashkëveprimit me kulturat tjera në nivelin lokal, qendrorë e rajonal, janë:

**1) Për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare në Republikën e Serbisë, prej rëndësisë së madhe janë njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL). NJVL kryejnë punë në lidhje me mbrojtjen e të mirave kulturore të rëndësishme për qytetarët e tyre, nxisin zhvillimin e krijimtarisë kulturore dhe artistike, sigurojnë mjete për financimin dhe bashkëfinancimin e programeve dhe projekteve në sferën e kulturës dhe krijojnë kushte për**

---

<sup>44</sup> Kuvendi i Serbisë ende nuk e ka shqyrtuar dhe aprovuar listën e kandidatëve për përbërjen e re të Këshillit nacional për kulturë. Kandidatët e propozuar nga Koordinimi i këshillava nacionale janë Andrash Urban, Dragomir Zupanc, Miroslav Benka dhe Naka Nikshic.

punë dhe funksionim të muzeut, bibliotekës dhe institucioneve tjera kulturore të cilat janë të themeluara nga NJVL-të. Si themelues të shtëpive të kulturës dhe bibliotekave, NJVL sigurojnë mjete për funksionimin e tyre. Duke i dhënë përkrahje shoqatave në sferën e kulturës nëpërmjet konkurseve, NJVL ndikojnë në rritjen e përmbajtjeve kulturore në komunat e tyre (programe tradicionale folklorike, programe të krijimtarisë bashkëkohore nga sfera e letërsisë, teatrit, arteve vizuale, muzikore, etj.)

**2) Institucionet kulturore (shtëpitë e kulturës, bibliotekat)** duke realizuar aktivitetet dhe programet e tyre do duhej të përmbushnin nevojat e qytetarëve. Duke siguruar kuadro profesionit dhe duke zhvilluar programe të posatshme të institucioneve të kulturës mund të japin kontribut të madhë në ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare. Ato po ashtu mund të jenë qendra të jetës shoqërore dhe kulturore në NJVL-të e tyre dhe mund të jenë vend në të cilin mbledhen qytetarët pa dallim në baza etnike.

**3) Shoqatat qytetare aktive në sferën e kulturës shqiptare** mund të jenë plotësimi i përshtatshëm i ofertës dhe përmbajtjeve kulturore për NJVL-të. Duke zhvilluar dhe realizuar projekte dhe programe të cilat mungojnë në sferën e krijimtarisë bashkëkohore kulturore, anëtarët e shoqatës mund të jenë edhe nismëtar të përmbajtjeve kulturore për të rinjtë e bashkësisë shqiptare.

**4) Zyra për të rinjë**, patur parasysh rrjetin e zyrave për të rinjë i cili numëron 110 anëtarë të qyteteve dhe komunave në Republikën e Serbisë, është resurs i rëndësishëm potencial për inkuadrimin e të rinjëve në programet ndërkulturore nëpërmjet punëtorive dhe takimeve të ndryshme artistike dhe kreative.

#### **4. Roli dhe autorizimet publike të KSSH-së në kulturë**

Autorizimet në sferën e kulturës që iu kanë besuar këshillave nacionale nënkuptojnë ndërtimin dhe udhëheqjen e politikave kulturore, rrespektivisht përcaktimin dhe realizimin e qëllimeve dhe detyrave që duhet realizuar me ndihmën e masave të përshtatshme, instrumenteve dhe aktiviteteve të ndryshme. KSSH ka mundësinë ligjore që të bëhet themelues ose bashkëthemelues i institucioneve sikur qysh janë entet për ruajtjen e të mirave kulturore, bibliotekave, galerive, mediave dhe të tjera. Ligjet po ashtu mundësojnë që KSSH të shpallë institucionet me rëndësi të veçanta për ruajtjen e kulturës shqiptare, të përcaktoj/përzgjedh institucionet dhe manifestimet në sferën e kulturës shqiptare që janë të rëndësishme për ruajtjen, avancimin dhe zhvillimin e veçorive dhe identitetit kombëtar dhe të marr pjesë në sigurimin e fondit të librave për bibliotekat publike e po ashtu të marr pjesë edhe në aktivitetet tjera të rëndësishme për kulturën shqiptare. KSSH mundet po ashtu të propozoj listën me botimet më të rëndësishme në sferën e kulturës dhe të përcaktoj shënimin e datave që janë të rëndësishme për zhvillimin e kulturës shqiptare e të njëjtat të i festojë bashkë me pjesëtarët e pakicës që i përfaqëson. Në këtë mënyrë, nëpërmjet ruajtjes, krijimtarisë dhe prezantimit të kulturës shqiptare, KSSH përfaqëson edhe interesin e përgjithshëm të të gjithë qytetarëve të bashkësisë shqiptare.

Edhe një autorizim i rëndësishëm i KSSH në sferën e kulturës ka të bëjë me përcaktimin dhe ruajtjen e të mirave të lëvizshme dhe palëvizshme kulturore të cilat janë prej një rëndësie të madhe për pakicën nacionale.



Këshillat nacionale janë po ashtu të inkuadruara në sjelljen e vendimeve për financimin ose bashkëfinancimin e projekteve. KKSH duhet të jep mendim për ndarjen e mjeteve të cilat ndahen nëpërmjet konkurseve nga Buxheti i Republikës së Serbisë dhe nga njësitë e vetëqeverisjes lokale e të cilat i dedikohen institucioneve kulturore, manifestimeve dhe shoqatave të pakicës nacionale shqiptare në sferën e kulturës. Këtu duhet të përmendet që akterët në sferën e kulturës kanë në dispozicion edhe Fondin buxhetor për pakicat nacionale orientimi i të cilit definohet me përcaktimin e këshillave nacionale, rrespektivisht përcaktohet sfera e cila do të financohet dhe mbështetet nga Fondi buxhetor për çdo vit. Ky vendim merret në Koordinimin e këshillave nacionale të pakicave nacionale.

Karakteristikë edhe e punës së KKSH por edhe e përgjithshme, kur bëhet fjalë për akterët që veprojnë në këtë fushë, është fakti që kultura në masë të madhe konsiderohet si lloj i traditës e cila shënohet nëpërmjet manifestimeve me Shoqata kulturore – artistike. Ky lloj i veprimtarisë për qëllim ka publikun e caktuar (në masë të madhe të moshuar) dhe pretendon të mbyllet në një rreth të vogël të njerëzve – shikuesve. Me një numër të vogël të përjashtimeve, në masë të madhe po anashkalohet momenti dinamik i krijimtarisë kulturore i cili bashkë rrugëton me rrjedhat bashkëkohore dhe i cili në masë të madhe ka për qëllim publikun dhe gjeneratat e reja. Përgjatë krijimit të aktiviteteve, bashkësia shqiptare konsiderohet si unike, rrespektivisht anashkalohen ndryshimet e caktuara në moshë, gjini dhe territore në të cilët qytetarët jetojnë (dallimi në mes të nevojave në sferën e kulturës të qytetarëve që jetojnë në pjesë rurale dhe atyre në pjesën urbane, p.sh.). Në mënyrë që nevojat e këtyre grupeve të ndryshme të bashkësisë të jenë të plotësuara, KKSH duhet të jetë në kontakt të përditshëm me qytetarët dhe të përcaktoj/identifikoj nevojat e tyre.

Ekzistojnë disa probleme themelore në sferën e ruajtjes dhe zhvillimit të kulturës:

**1)** Mungesa e institucioneve për ruajtjen, kultivimin dhe promovimin e kulturës tradicionale dhe bashkëkohore shqiptare (enti, muzeu, arkiva).

Për të ndërtuar institucione kulturore, KKSH duhet të përpiloj strategji rrespektivisht plan për zhvillimin e kulturës për një periudhë afatmesme, që me njëfarë mënyrë po e bënë me këtë dokument. Për t'i përcaktuar nevojat dhe interesimet e qytetarëve, KKSH duhet të bëjë analizë mbi nevojat e bashkësisë në sferën e kulturës. Së pari Komisioni për kulturë i KKSH duhet të përcaktoj mënyrën me të cilën do të hyjë brenda bashkësisë dhe në përputhje me kriteriumet e ndryshme (mosha, gjinia, etj.) të përcaktoj cilat janë nevojat dhe interesimet e bashkësisë. Në bazë të të dhënave të grumbulluara, KKSH duhet të përcaktoj prioritetet dhe të drejtojë zhvillimin e aktiviteteve të saja në të në ardhmen në përputhje me prioritetet e caktuara, duke i marr gjithnjë parasysh nevojat e njerëzve, mundësitë financiare dhe kohore që ka në dispozicion. Në këtë mënyrë qasja mbi zhvillimin e kulturës, ruajtjen dhe zhvillimin e krijimtarisë kulturore do të ishte gjithëpërfshirëse dhe sistematike, për dallim prej qasjes së deritanishme *ad hoc* e cila është treguar si joproduktive dhe nuk ka siguruar stabilitet dhe siguri në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve.

**2)** Mungesa e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave me institucionet tjera kulturore, shoqatat dhe krijuesit kulturor në Serbi dhe rajon.

Për të rritur prezencën e kulturës shqiptare në Serbi, KKSH duhet të përcaktoj resurset e saja që ka në dispozicion në nivelin lokal dhe nacional e të cilat deri më tani nuk i ka shfrytëzuar në masë të mjaftueshme. Duke e pasur parasysh që KKSH ka mundësi ligjore të jep mendim për projektet e shoqatave të qytetarëve

që konkurrojnë në konkurset e Ministrisë së kulturës, NJVL, KKSH mundet që nëpërmjet këtij mekanizmi të ofroj përkrahje pikërisht atyre projekteve që nxisin bashkëpunimin me institucionet kulturore dhe individët që merren me krijimtari kulturore në Serbi dhe rajon. Po ashtu, KKSH, në këtë mënyrë mund t'i ofroj përkrahje projekteve inovativ të cilat në mënyrë të re dhe kreative përpunojnë ndonjërin prej temave tradicionale ose merren me krijimtari bashkëkohore.

**3) Inkuadrimi i dobët i qytetarëve në aktivitetet që kanë të bëjnë me promovimin dhe ruajtjen e identitetit kulturor të bashkësisë shqiptare**

KKSH do duhet të iniciojë inkuadrime sa më të gjerë të shoqatave lokale qytetare në aktivitetet e ndryshme kulturore. Që të mund të luaj një rol proaktiv, KKSH duhet fillimisht të: 1) përcaktoj numrin e saktë të shoqatave, sferën e veprimtarisë së tyre (kulturë racionalë/bashkëkohore), strukturën e gjeneratave brenda shoqatave, shpërndarjen territoriale nëpër komuna (fshat/qytet), sukseset e tyre të deritanishme; 2) duke u nisur prej këtyre fakteve të përcaktoj prioritetet rreth përkrahjes që do t'i ofroj punës së shoqatave; 3) për çdo vit të ofroj përkrahje për një numër të caktuar të shoqatave; 4) nëpërmjet Komisionit për kulturë të mbajë kontakte me shoqatat dhe të organizoj takime të përbashkëta. Vetëm në këtë mënyrë dhe vetëm atëherë kur shoqatat shohin interesimin e KKSH për inkuadrimin e tyre, mund të pritët që ato në masë më të madhe të inkuadrohen në aktivitetet e KKSH.

**4) Numri i pamjaftueshëm i librave në gjuhën shqipe në dispozicionin nëpër bibliotekat publike**

KKSH ka mundësi të rëndësishme ligjore që nëpërmjet dhënies së mendimit komisionit të ministrisë, të propozoj titujt e librave, të cilat, për nevojat e bibliotekave i siguron Ministria e kulturës. E njëjta procedurë dhe mundësi ligjore e KKSH-së, vlenë edhe për NJVL-të nëse blejnë libra për nevojat e bibliotekave publike komunale. KKSH po ashtu duhet të jetë më aktiv edhe në sigurimin e donacioneve për pajisjen me libra. Për zgjidhjen e shumicës së çështjeve të lartpërmendura mund të shfrytëzohen edhe mjetet nga buxheti i Republikës së Serbisë që janë në dispozicion nëpërmjet konkursit të Ministrisë së kulturës, në bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve që për këto qëllime të konkurrohet edhe për mjetet e Fondit buxhetor për pakicat nacionale dhe mjetet nga vetëqeverisjet lokale. Prandaj edhe përcjellja dhe analizimi i rezultateve të këtyre konkurseve është i rëndësishëm për punën dhe funksionimin e KKSH në përgjithësi e Komisionit për kulturë në veçanti.

Njëra prej sfidave më të rëndësishme që në të ardhmen do të jetë para KKSH është zhvillimi dhe aplikimi i teknologjive të reja në sferën e kulturës. Duke e pasur parasysh që digjitalizimi i materialeve nëpër muze, biblioteka dhe arkiva, është i komplikuar dhe shtrenjtë, KKSH duhet të shfrytëzoj të gjitha resurset që i ka në dispozicion.

## **5. Qëllimet strategjike në sferën e kulturës**

**Qëllimet e përgjithshme:** Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimi i krijimtarisë bashkëkohore kulturore në bashkësinë shqiptare

**Qëllimet e veçanta:**

**- Ndërtimi dhe formimi i institucioneve kulturore bashkëkohore të pakicës nacionale shqiptare: inicimi i muzeut digjital**

Me digjitalizimin e kulturës shqiptare do të ruhej një pjesë e trashëgimisë kulturore material dhe jo materiale dhe do të krijohet mundësia për të patur në dispozicion qasje në kulturë një rreth sa më i gjerë i popullatës. Digjitalizimi është veçanërisht i rëndësishëm kur nuk ekzistojnë muze ose galeri, e as arkiva për grumbullimin sistematik dhe ruajtjen e materialeve ekzistuese.

Ky punim i lartë profesional kërkon angazhimin e ekspertëve nga sfera e kulturës shqiptare (poezi, proza, fotografi, etj.) ku do të përfshihej edhe kultura tradicionale e edhe trendët bashkëkohore. Po ashtu, është me rëndësi që në këtë fazë në ekip të gjinden edhe ekspertë të teknologjive të reja dhe ekspert muzeologjik. Orientimi strategjik i Serbisë drejt digjitalizimit të trashëgimisë kulturore dhe nxitja e aplikimit të teknologjive të reja në kulturë do të ishte gjithsesi përkrahje shtesë për realizimin e këtyre aktiviteteve. Orientim i tillë i shtetit do t'ia lehtësoj KKSH-së sigurimin konkret të mbështetjes financiare, organizative dhe kadrovike, në digjitalizimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Muzeu digjital – sigurimi dhe grumbullimi i materialeve për digjitalizim	Ekipi i përzgjedhur i ekspertëve Profesorë të historisë, muzikës dhe artit Bibliotekat	2 vite	Është grumbulluar materiali për muzeun digjital	Përgjatë grumbullimit të materialeve do duhet të fillohet nga zgjidhjet aktuale në këtë sferë të cilat vetëm se i kanë këshillat tjera nacionale
Krijimi i ueb sajtit për muzeun digjital	KKSH – Komisioni për kulturë Ekspertë të IT	4 muaj	Është krijuar ueb saji	Muzeu digjital pasqerë gjithash i dedikohet ruajtjes së kulturës shqiptare në Republikën e Serbisë. Prandaj është e domosdoshme të jetë në gjuhën shqipe. Duke e pasur parasysh që elementet e kulturës shqiptare nuk janë mjaftueshëm të njohura për bashkësitë tjera në Republikën e Serbisë, rekomandohet që përmbajtja e muzeut digjital të jetë në

				<p>dispozicion edhe në gjuhën serbe.</p> <p>Përgjatë të krijimit të muzeut digjital, të shfrytëzohen <i>Udhëzimet për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore në Serbi.</i></p>
<p>Mirëmbajtja dhe plotësimi i vazhdueshëm i përmbajtjeve të muzeut digjital</p>	<p>Ekspertët e IT</p>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme</p>	<p>Përmbajtjet e reja në ueb sajt</p>	<p>Paraqitja e kulturës shqiptare në këtë formë mund të rrisë në masë të konsiderueshme prezencën e kulturës shqiptare dhe të bëjë promovimin e sajë.</p>
<p>Motivimi i të rinjëve që të marrin pjesë në procesin e krijimit të muzeut digjital (nëpërmjet punëtorive, konkurseve) – definimi i kushteve të konkursit, komisionit, fondeve shpërblyese</p>	<p>KKSH – Komisioni për kulturë</p> <p>Të rinjët nga bashkësia nacionale shqiptare</p> <p>Shkollat</p>	<p>Një herë në vit</p>	<p>Janë mbajtur kurset për të rinjë në sferën e krijimtarisë kulturore (në sfera të ndryshme)</p> <p>Janë publikuar punimet më të mira në sajtin e muzeut</p>	<p>Me inkuadrimin e të rinjëve në këto aktivitete realizohet interes i dyanshëm: të rinjët bëhen kuriozë dhe shfaqin interesim për trashëgimin e tyre kulturore, ndërsa muzeu digjital bëhet aktual, duke krijuar kontakte me gjeneratat e reja.</p> <p>KKSH mund të realizojë bashkëpunim me shkollat dhe të propozojë temat dhe format e realizimit të këtyre temave, të cilat ndërkohë do të ndodheshin në dispozicion nëpërmjet muzeut digjital. Temat mund të përfshijnë edhe krijimtarinë tradicionale dhe atë bashkëkohore.</p>

**- Plotësimi i fondit letrar në gjuhën shqipe në bibliotekat publike në tri komunitat**

Ministria e kulturës çdo vit shpall konkurs për blerjen e publikimeve të reja për bibliotekat publike. Dokumentacioni i cili mbërrin, ministria ia dërgon për dhënjen të mendimit këshillave nacionale të pakicave të cilat kanë afat prej 2 muajve të dorëzojnë listën me prioritetet e tyre. Pas skadimit të këtij afati Biblioteka kombëtare e Serbisë vërteton dokumentacionin e arritur dhe i dërgon në përpunim Ministrisë së kulturës. Të dhënat mbi blerjen e librave për dy vitet e fundit janë si në vijim: në vitin 2017 në gjuhën shqipe është paraqitur dhe siguruar një publikim; në vitin 2018 në gjuhën shqipe janë paraqitur dhe siguruar 3 publikime. Këto libra u janë dorëzuar bibliotekave në Preshevë dhe Medvegjë. Tirazhi ka qenë shumë i vogël, 2-3 kopje.<sup>45</sup>

Botime bashkëkohore letrare në gjuhën shqipe mund të sigurohen edhe nëpërmjet donacioneve nga shteti amë dhe ambasadat. Kjo është një formë e shpeshtë e plotësimit të fondit letrar në gjuhët e pakicave nacionale në Serbi.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Konstatimi i gjendjes në bibliotekat publike	KKSH – Komisioni për kulturë Drejtorët e bibliotekave Punonjësit në biblioteka	6 muaj	Është përpiluar analiza e cila konstaton gjendjen e fondeve me libra në bibliotekat publike.	Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet letërsisë bashkëkohore të shkrimtarëve shqiptar dhe përkthimeve të autorëve nga Serbia dhe autorëve të huaj. Nëse konstatohet se ekziston nevoja për përkthimin e ndonjë libri atëherë mund të konkurrohet në Ministrinë e kulturës (konkursi për përkthimin e botimeve në gjuhën e pakicave nacionale)
Përpilimi i listës me librat që duhet të sigurohen për secilën komunë	KKSH – Komisioni për kulturë Bibliotekat	3 muaj	Është definuar lista e librave me prioritet për blerje për secilën komunë	Përgjatë përpilimit të listës duhet përkujdesje për strukturën e moshave tek shfrytëzuesit e bibliotekave.

<sup>45</sup>Raporti i 11 mbi realizimin e Planit akcional për realizimin e të drejtave të pakicave nacionale, 1\_2019, në dispozicion në: <https://www.ljudskaprava.gov.rs/sr/node/21794>

				Vëmendje të veçanta të i kushtohet bibliotekave që kanë nëndegët e veta edhe nëpër zonat rurale.
Sigurimi i librave për bibliotekat publike	KKSH – Komisioni për kulturë	8 muaj	Janë siguruar 10tituj për secilën komunë në nivelin vjetor	Nëpërmjet konkursit të Ministrisë së kulturës, ose nëpërmjet donacionit të ambasadë së Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me bibliotekat, në mënyrë të vazhdueshme të punohet në modernizimin e fondit të bibliotekave në gjuhën shqipe.
Promovimi dhe informimi i qytetarëve mbi librat e siguruar	KKSH – Komisioni për kulturë	3 muaj	Janë mbajtur aktivitete publike – në secilën komunë nga një	Këtu do duhej që të përfshihen sa më shumë të rinjë – që nëpërmjet narracionit, përgatitjes së pjesës së tekstit të ndonjë libri të prezantojnë librin në shkollat e tyre ose rrethin në të cilin janë aktiv. Veçanërisht t'i kushtohet vëmendje qytetarëve që jetojnë në zonat rurale, para së gjithash të rinjëve dhe grave/vajzave.
Pjesëmarrja në panairin e librit ose bashkëpjesëmarrja me shtëpitë botuese pjesëmarrëse në panair të cilat kanë botime në gjuhën shqipe	KKSH – Komisioni për kulturë Panairi i librit Shtëpitë botuese	2 muaj	Prezantimi i një libri të një shkrimtari shqiptar nga Jugu i Serbisë	KKSH mund të lidhet me ndonjërin prej shtëpive botuese dhe të organizojë prezantimin e një libri të autorit lokal në hapësirën e asaj

				shtëpie botuese në panair.
--	--	--	--	----------------------------

**- Nxitja e zhvillimit të përmbajtjeve bashkëkohore kulturore**

Në vlerësimin se çfarë mund tri komunat nga jugu i Serbisë dhe kultura shqiptare t'i ofroj skenës së kulturës bashkëkohore në Serbi dhe rajon, duhet të nisemi nga gjendja se çfarë aktualisht ka në dispozicion kultura shqiptare në këto komuna. Kjo d.m.th. që KKSH duhet të përcaktoj:

- 1) Listën e manifestimeve me rëndësi të veçantë për kulturën shqiptare;
- 2) Listën e institucioneve të cilat janë me rëndësi të veçantë për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturë shqiptare;
- 3) Listën me personalitetet më të rëndësishëm për zhvillimin e kulturës tradicionale dhe bashkëkohore shqiptare;
- 4) Listën me ndodhitë më të rëndësishme në kulturën shqiptare.

Lista e manifestimeve me përshkrimin e tyre dhe lista e institucioneve me përshkrimin e aktiviteteve të tyre do të ofroj fotografi reale mbi atë se sa aktivitetet kulturore organizohen në sferën e kulturës tradicionale, ndërsa sa aktivitete në sferën e krijimtarisë kulturore bashkëkohore

Në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale, KKSH ka mundësi dhe të drejtë që të formuloj propozimin për përcaktimin e institucioneve kulturore që kanë rëndësi të veçantë për pakicën nacionale. Propozimi i elaboruar i dorëzohet themeluesit të institucionit (Republikës, Krahinës autonome, njësisë së vetëqeverisjes lokale), të cilët më pastaj mund të, nëse e konsiderojnë që propozimi është me bazë dhe në përputhje me rregullat, ndryshojë aktin themelues dhe të shpallë këtë institucion si të rëndësishëm së veçantë për pakicën nacionale shqiptare. Me përcaktimin e këtij statusi, KKSH fiton të drejtën të: 1) të emëroj së paku një anëtarë të këshillit drejtues të atij institucioni; 2) të jap mendim për anëtarët e propozuar të këshillit drejtues dhe 3) të jap mendim për procedurën e zgjedhjes së drejtorit të atij institucioni.

Për të nxitur zhvillimin e krijimtarisë bashkëkohore është e domosdoshme që në planifikimin dhe përpilimin e aktiviteteve të inkuadrohen krijuesit e rinjë. Ata më së miri e dine cilat përmbajtja do t'i zgjedhin dhe në cilën mënyrë t'ju prezantojnë moshatarëve të tyre.

Organizimi i punëtorive kreative në tema të ndryshme me përdorimin e rrjeteve sociale (Facebook, Instagram) është dëshmuar edhe në kulturat tjera si mënyrë nxitëse dhe inkurajuese për të rinjët dhe të rejtat. Mjetet mund të sigurohen nëpërmjet konkursit të Ministrisë së kulturës dhe NJVL. Edhe vet KKSH-ja mund të ndajë mjete në nivel vjetor për kësi lloj aktiviteteve.

Njëri prej motivit i cili, p.sh., do të mund të tërheq vëmendjen e publikut të gjerë janë Ditët e Bekim Fehmiut, artistit më të njohur shqiptar, dhe ky aktivitet do të mund të shndërrohet në manifestim të rregullt vjetor me të gjitha ndodhitë përcjellës bashkëkohore dhe me përkrahje financiare nga institucione dhe donator të ndryshëm.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Vërtetimi i nevojave kulturore të qytetarëve të tri komunave në bazë të strukturës gjinore, asaj të gjeneratave dhe strukturës gjeografike.	KKSH – Komisioni për kulturë	2 muaj	<p>Është dakorduar mënyra e punës për grumbullimin e të dhënave</p> <p>Janë vërtetuar nevojat</p> <p>Janë definuar konkluzionet dhe drejtimet për punën e mëtuftjeshme të KKSH në sferën e kulturës</p>	<p>Njëra prej mënyrave për vërtetimin e nevojave është nëpërmjet pyetësorëve. KKSH mund t'i dorëzojë pyetësorët tek drejtorët e shkollave të mesme në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe në mënyrë që të hulumtoj nevojat kulturore të nxënësve të shkollave të mesme.</p> <p>KKSH mundet që edhe nëpërmjet ndonjë organizmi publik në tri komunat ose vizitave nëpër fshatra të banuara me shqiptar të hulumtoj për nevojat e qytetarëve në këtë sferë.</p>
Organizimi i punëtorive tematike për të rinjtë dhe fëmijët me qëllim të nxitjes së krijimtarisë bashkëkohore kulturore	<p>KKSH – Komisioni për kulturë</p> <p>profesorët e letërsisë, muzikës dhe artit</p> <p>Artistët lokal</p> <p>Artistët nga rajoni</p>	Në mënyrë të vazhdueshme	<p>Punimet e dala nga punëtoritë tematike.</p> <p>Janë shpallur punimet më të mira.</p> <p>Punimet dhe punëtorit në dispozicion në sajtin e KKSH dhe nëpër portale në tri komunat, në fb faqet e shtëpive të kulturës, Instagram dhe në muzeun digjital.</p>	Temat e punëtorive i dakordon Këshilli në bashkëpunim me artistët dhe profesorët të cilët do të punojnë me fëmijët.
Përpilimi i listës me personalitetet më të rëndësishëm nga kultura shqiptare, si ata	KKSH – Komisioni për kulturë	12 muaj	<p>Është përpiluar lista</p> <p>E publikuar në ueb sajtin e KKSH</p>	Në bazë të kësaj liste KKSH mund të organizoj manifestime të cilat do të emërohenin



bashkëkohor po ashtu edhe ata tradicional				<p>me emrin e ndonjërit prej personaliteteve dhe të cilët do të avancojnë pikëpamjen e krijimtarisë bashkëkohore (muzikë, poezi, etj.)</p> <p>Po ashtu një listë si kjo do të mund të shërbente edhe për zhvillimin e kulturës shqiptare në sferat tjera – arsim (për shkrimin e shtojcave të teksteve mësimore), përdorimin zyrtarë të gjuhës dhe shkrimit (emërimin e rrugëve, shesheve, etj.).</p>
Përpilimi i listës me datat më të rëndësishme për zhvillimin e kulturës shqiptare	KKSH – Komisioni për kulturë Ekspertë	12 muaj	Është përpiluar lista Është publikuar në ueb faqen e KKSH	Edhe kjo listë mund të shfrytëzohet për nevojat e njëjta si lista e mëparshme
Organizimi i një aktiviteti ndërkulturor, çdo vit në një vend tjetër (Preshevë, Bujanoc, Medvegjë)	KKSH – Komisioni për kulturë Shkollat e mesme Zyra për të rinjë NJVL Shoqatat e qytetarëve	6 muaj	Ndarja e diplomave për pjesëmarrësit Mbulesë mediave në të gjitha mediat lokale (tri komunitet)	<p>Temat e këtyre takimeve me të rinjtë mund të jenë prej më të ndryshmeve.</p> <p>Përkrahja për këto aktivitete duhet të kërkohet nga NJVL-të por edhe nëpërmjet projekteve të cilat KKSH vet ose nëpërmjet Fondacionit i ka shkruar. Përgjatë organizimit të këtyre aktiviteteve duhet të shfrytëzohen edhe përvojat e shoqatave dhe Zyrës për të rinjë.</p>

--	--	--	--	--

**- Inkuadrimi i shoqërisë civile në zhvillimin, promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të bashkësisë shqiptare**

Potencial i madhë kreativ për dizajnimin e programeve kulturore ndodhet tek të rinjtë të cilët vetëm se janë angazhuar në shoqata të ndryshme, Zyrën për të rinjë, media në gjuhën shqipe ose janë mësimdhënës nëpër shkolla. KKSH duhet t'i motivoj dhe t'i nxisë që me idetë dhe projektet e tyre të inkuadrohen në jetën kulturore. Materiale për projekte në sferën e kulturës ka mjaft, të përmendim vetëm një shembull për të ilustruar: në fshatin Nesalce (komuna e Bujanocit) ekziston teqeja e dervishëve e vjetër 250 vite dhe atje ekziston edhe komuniteti i dervishëve. Rreth kësaj teqe në bashkësinë shqiptare mund të mendohet për një insert mediatik ose për filmimin e një filmi dokumentar. Një produksion i tillë kulturor mund t'i interesoj masës së gjerë dhe të ndikoj në rritjen e prezencës së kulturës shqiptare në Serbi.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Definimi i prioriteteve dhe kushteve të konkursit për ndarjen e mjeteve për shoqatat qytetare në sferën e kulturës	KKSH –Komisioni për kulturë	1 muaj	Janë definuar prioritetet dhe kushtet e konkursit (është formuar komisioni, vendimi mbi shpalljen e konkursit, formularët për evaluimin e projekteve...)	Përgjatë definimit të prioriteteve duhet të nisët nga fakti se çfarë përmbajtje kulturore nuk ka në programet e institucioneve kulturore dhe atyre përmbajtjeve duhet t'i jepet përparësi.
Shpallja e konkursit për shoqatat qytetare me qëllim të zhvillimit të krijimtarisë kulturore bashkëkohore	KKSH – Komisioni për kulturë Shoqatat qytetare NJVL	1 muaj	Numri i projekteve të përkrahura	Mjetet mund të sigurohen nëpërmjet projekteve të KKSH, nga fondacionet, me përkrahjen e NJVL, institucione të ndryshme, donacione nga shteti amë.
Përpilimi i kalendarit me manifestimet dhe aktivitetet në sferën e kulturës shqiptare	KKSH – Komisioni për kulturë	4 muaj	Është përpiluar katalogu i manifestimeve kulturore në tri komunat I publikuar në ueb faqen e KKSH	Në kalendar të përfshihen edhe manifestimet të cilat organizohen në Republikën e Serbisë e që kanë të bëjnë me kulturën shqiptare.

				<p>Katalogu shërben për promovimin e aktiviteteve kulturore dhe paralajmërimin e tyre me kohë.</p> <p>Ai duhet të përmbajë: përshkrimin e manifestimit, emrin e organizatorit, vendin dhe datën e organizimit, përshkrim të shkurtët historik.</p> <p>Katalogu i aktiviteteve duhet të jetë publik në faqen e internetit të KKSH dhe duhet të azhurohet vazhdimisht (nëse ka ndryshime).</p> <p>Në grumbullimin e të dhënave KKSH mund të konsultoj edhe shoqatat qytetare dhe shtëpitë e kulturës.</p>
--	--	--	--	---

- **Ndërtimi i sistemit të shkëmbimit me institucionet, ansamblet dhe artistët nga Serbia dhe rajoni**

Në hartën kulturore të Serbisë ekzistojnë numër i madhë i manifestimeve me të cilat KKSH nuk ka të ndërtuar bashkëpunim. Me investime minimale organizative dhe financiare mund të rritet prezenca e kulturës shqiptare nga jugu i Serbisë, por edhe shkëmbimi dhe bashkëpunimi me shoqatat tjera. Duhet të merret parasysh mundësia që disa prej shoqatave shqiptare ose disa artist shqiptar të inkuadrohen në këto manifestime. Janë interesant, para së gjithash, festivali *Mirëdita, dobar dan!* i cili organizohet për çdo vit në Beograd ose festivali *Interetno*<sup>46</sup> në Suboticë. Çdo inkuadrim në manifestime jashtë këtyre tri komunave në jug të Serbisë në mënyrë të konsiderueshme do të ngritë prezencën e kulturës shqiptare në përgjithësi dhe do të zvogëlonte distancën etnike. Pjesëmarrja do t'i kontribuonte edhe zhvillimit të tolerancës ndëretnike dhe bashkëpunimit.

<sup>46</sup> Organizatore është qendra kulturore hungareze *Népkör* (Subotica); më shumë rreth festivalit në: <https://interetno.net/sh/pocetna>

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Krijimi i bazës së të dhënave mbi artistët nga bashkësia shqiptare	KKSH – Komisioni	3 muaj	Është krijuar baza e shoqatave dhe artistëve të cilët merren me kulturë në bashkësinë shqiptare në Serbi	Rekomandohet që baza e të dhënave, përveç llojit të artit me të cilin artisti në fjalëmerret, te ketë edhe të dhëna mbi atë se a është artisti në fjalë i përkushtuar në zhvillimin dhe krijimin e kulturës tradicionale apo asaj bashkëkohore.
Janë përkrahur krijuesit, artistët dhe autorët e bashkësisë nëpërmjet pjesëmarrjes në festivalin Mirëdita, dobar dan!	KKSH – Komisioni për kulturë Organizatorët e festivalit Shoqatat qytetare nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja	1 muaj	Promovimi i autorëve, krijuesve dhe artistëve nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja në festival Është rritur prezenca mediale e autorëve të rinjë, krijuesve dhe artistëve Është përgatitur së paku një përmbajtje mediale në mediat lokale për secilin pjesëmarrës që ka marr pjesë në festivalin Mirëdita, dobar dan!	Bazuar në shumëllojshmërinë e programit të festivalit, KKSH duhet të krijoj bashkëpunim me Festivalin Mirëdita, dobar dan! në mënyrë që në të të marrin pjesë krijuesit, artistët dhe autorët nga këto tri komuna. Është me rëndësi që KKSH në këtë mënyrë të përkrahë të rinjët e komunitetit të vet në mënyrë që të ndikoj në 1) ngritjen e prezencës dhe përfaqësimit të pjesëmarrësve të rinjë dhe punës së tyre dhe 2) në rritjen e prezencës së specifikave kulturore në kontekstin e gjerë.

- Themelimi i Entit për kulturën Shqiptare

Praktika ka treguar që për sferën e ruajtjes dhe zhvillimit të kulturës të pakicave nacionale një rrol të veçantë mund ta kenë Entet për kulturë. Bazën ligjore për themelimin e institucioneve kulturore e ofron Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale, në bazë të të cilit mund të themelohen institucione për ruajtjen e identitetit kombëtar. Deri më tani në Serbi ka pesë institucione të këtij lloji (hungarezët, sllovakët, kroatët, rumunët dhe rusinët). Përgjatë inicimit të themelimit të entit duhet të përdoret eksperiencia e atyre pakicave nacionale të cilit kanë themeluar institucionet e tyre kulturore.

Enti për kulturë i pakicave nacionale është institucion profesional i cili themelohet për hirë të ruajtjes, avancimit dhe zhvillimit të kulturës së asaj pakice nacionale edhe atë nëpërmjet: veprimtarive hulumtuese në sferën e kulturës, botimeve, veprimtarive edukative, shkencore duke ruajtur, arkivuar e digjitalizuar të mirat kulturore dhe duke përkrahur krijimtarinë kulturore bashkëkohore. Enti do të mundësonte qasje sistematike në kulturë dhe do të eliminonte dominimin e deritanishëm *ad hoc* në sferën e kulturës shqiptare.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Nisja e iniciativës për themelimin e Entit për kulturë	KKSH –Komisioni për kulturë	8 muaj	<p>Është përshtatur Statuti i KKSH (nëse është e nevojshme.</p> <p>Është marr Vendimi për themelimin e Entit për kulturë</p> <p>Është aprovuar Statuti i Entit për kulturë</p>	Para fillimit të iniciativës KKSH duhet të mbledhë informacionet e nevojshme për themelimin e Entit për kulturë nga këshillat nacionale të cilët veçse kanë themeluar entet e tyre.
Themelimi i Entit për kulturë	KKSH	6 muaj	<p>Publikimi i Vendimit mbi themelimin e Entit për kulturë në Gazetën zyrtare të RS.</p> <p>Regjistrimi i Entit si person juridik në regjistrin gjyqësor.</p> <p>Është siguruar hapësira për punë dhe mjetet për funksionim të Entit.</p>	Enti për kulturë duhet patjetër të ketë hapësirat e veta të punës të cilat do duhej t'i siguroj njësia e vetëqeverisjes lokale. Për themelimin e Entit, duhet vendimi i Ministrisë së kulturës dhe informimit të Republikës së Serbisë. Është shumë me rëndësi që mjetet për funksionimin e këtij institucioni të sigurohen edhe nëpër projekteve.

## 6. Rekomandimet për Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi në sferën e kulturës

- 1) Të përcaktohet lista me personalitetet më të rëndësishme për zhvillimin e kulturës bashkëkohore dhe tradicionale shqiptare.
- 2) Të përcaktohet lista me datat më të rëndësishme për zhvillimin e kulturës shqiptare.
- 3) Të përpilohet kalendari i manifestimeve që i përkasin rëndësisë së veçantë për ruajtjen, avancimin dhe zhvillimin e kulturës shqiptare, duke përfshirë përshkrimin e manifestimit, historikun e shkurtër, datën dhe vendin ku manifestimi mbahet. Kalendari të jetë në dispozicion të masës së gjerë duke u publikuar në ueb faqen e KKSH-së.
- 4) Të përpilohet lista me artistët dhe krijuesit aktiv në bashkësinë shqiptare.
- 5) Të përkrahen artistët lokal dhe puna e tyre, të lidhen me të rinjët e bashkësisë dhe të inkurajohet bashkëpunimi në mes tyre me punë të përbashkëta, të krijohet rrjeti me artistë nga vendi dhe rajoni, të përkrahet pjesëmarrja e tyre në festivale që organizohen në vend dhe jashtë vendit.
- 6) Të përpilohet lista me shoqatat e qytetarëve që janë aktive në sferën e kulturës.
- 7) Të përkrahen shoqatat në veprimtaritë e tyre kreative, në bashkëpunim dhe punë të përbashkët me të rinjët dhe me shoqatat nga vendi dhe rajoni, të përkrahet dhe mbështetet përkrahja e tyre për pjesëmarrje nëpër festival.
- 8) Të përkrahet krijimtaria kulturore bashkëkohore, muzika bashkëkohore (hip hop, etj.), letërsia, poezia, fotografia, artii aplikuar. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet artit i cili nënkupton aksione nëpër rrugë (grafitë, etj.). Të mendohet për aktivitete në të cilat përfshihen të rinjët nga vendet rurale.
- 9) Të përcaktohet manifestimi me rëndësi të veçantë (për shembull – ditët e Bekim Fehmiut).
- 10) Të përcaktohet lista e institucioneve kulturore me rëndësi për ruajtjen e identitetit të pakicës nacionale shqiptare.
- 11) Të përcaktohet lista me të mirat kulturore të (pa)lëvizshme të rëndësisë së veçantë për pakicën nacionale shqiptare dhe të evidentohet nëse kanë statusin e të mirave të (pa)lëvizshme kulturore në Republikën e Serbisë.
- 12) Të përcaktohet çmimi vjetor për kontributin e dhënë në sferën e ruajtjes dhe zhvillimit të kulturës shqiptare.
- 13) Në mënyrë të vazhdueshme të punohet në sigurimin e librave për biblioteka.
- 14) Digjitalizimi i trashëgimisë kulturore.
- 15) T'i dërgohen mendimet e kërkuara komisioneve të Ministrisë së kulturës dhe informimit mbi përkrahjen e projekteve nga sfera e kulturës dhe informimit në gjuhën shqipe.
- 16) Të shpallen konkurse në sferën e kulturës për shoqatat të cilat merren me kulturën shqiptare. Të jenë në mënyrë të qartë të definuara prioritetet dhe procedura të jetë transparente.
- 17) Të themelohet Enti për kulturën Shqiptare në Serbi.

# INFORMIMI NË GJUHËN SHQIPE

---

## 1. Hyrje

Sfera e informimit publik në gjuhën e pakicave është çështje jashtëzakonisht e rëndësishme sepse nënkupton të drejtën e qytetarëve të pakicave nacionale të informohen në gjuhën e tyre amtare rreth temave të cilat konsiderohen të rëndësishme dhe që u përkasin e janë interes i tyre. Me prodhimin e emisioneve shkencore, emisioneve për fëmijë, emisioneve informative dhe tjera, dhe me emetimin e tyre nëpër televizione dhe radio në gjuhën e pakicave nacionale, i kontribuohet ruajtjes dhe identitetit kulturor e gjuhësor të pakicave nacionale.

Zhvillimi i vetëdijes mbi ekzistimin e dallimeve, duke përfshirë edhe dallimet gjuhësore të shoqërive të ndryshme, si dhe informimi dhe njohja me kulturat e bashkësive pakicë si pjesë të pandashme të trashëgimisë kulturore të Serbisë, i kontribuon ndërtimit të shoqërisë demokratike e cila vlerat e saja i mbështetë dhe bazon në pluralizmin e mediave dhe përmbajtjeve mediatike dhe në ofrimin e mundësisë për qytetarët që më mirë të kuptohen dhe të pranojnë dallimet.

Duke marr parasysh që janë aprovuar ligjet e reja mediatike dhe që ka përfunduar procesi i privatizimit, me rëndësi të veçantë është fakti që edhe pse struktura pronësore ka ndryshuar, kjo nuk ndikon në obligimin e shtetit të mbrojë interesin publik në sferën e informimit dhe të mbrojë të drejtën për informim të drejtë, të paanshëm dhe në kohë të duhur në gjuhën amtare të pakicave nacionale dhe po ashtu të ruaj identitetin kulturor e gjuhësor të pakicave nacionale. Me nxjerrjen e sektorit publik nga pronësia mbi mediat, puna e tyre nuk varet vetëm nga konkurset e Ministrisë së kulturës dhe informimit dhe konkurset e pushteteve lokale, por edhe nga gatishmëria e këshillave nacionale të pakicave nacionale që me aktivitetet e tyre të mbështesin dhe t'u dalin në ndihmë qëndrueshmërisë së përmbajtjeve mediatike në gjuhën e pakicave nacionale. Në të njëjtën kohë, rënja drastike e numrit të mediave në gjuhët e pakicave nacionale përgjatë procesit të privatizimit të mediave lokale ka rezultuar me rritjen e formimit të medimeve të reja elektronike (e-media). Si relativisht të lirë dhe me shpenzime të vogla për t'u krijuar, mediat e reja luajnë rol të rëndësishëm në ruajtjen e gjuhës së pakicave. Pjesa e tyre e dobët është jo stabiliteti financiar dhe shpeshherë resurset e pakta kadrovike që ndodhen në dispozicion.

## 2. Realizimi i të drejtës për informim në gjuhën shqipe – pasqyrimi i gjendjes

Informimi publik në gjuhën shqipe përbehet prej segmenteve të ndryshëm: sigurimin e shërbimeve mediale të emetimit televiziv dhe në radio në gjuhën shqipe, veprimtarinë bazë të serviseve mediale dhe financimin e përmbajtjeve mediatike në gjuhën shqipe të medimeve të cilat janë në pronësi private.

**Programi në radio në gjuhën shqipe emitohet në katër radio - stacione:** Radio Bujanoci; Radio Medvegja; Radio Novi Sad dhe Radio Presheva.

**Programi televiziv në gjuhën shqipe emitohet në katër televizione:** TV Bujanoci; TV Aldi (Preshevë), TV Presheva dhe TV Spektri (Bujanoc).

Në gjuhën shqipe botohen edhe Nacionali (nga Këshilli nacional) dhe Perspektiva (Bujanoc).

Kur është fjala tek informimi në gjuhën shqipe duhet të vërehet që portalet elektronike janë më dinamike, që padyshim duhet të vlerësohet, pasi që kjo formë e informimit jo vetëm që i përshtatet popullsisë më të re, ajo është edhe më e përballeshme për nga aspekti i financimit. Disa prej **portaleve elektronike** më të rëndësishme të cilët raportojnë në gjuhën shqipe janë: [www.preshevajone.com](http://www.preshevajone.com), [www.preshevanews.com](http://www.preshevanews.com), [www.preshevasot.com](http://www.preshevasot.com), [www.titulli.com](http://www.titulli.com), [www.lugina-lajm.com](http://www.lugina-lajm.com), [www.luginapress.com](http://www.luginapress.com), [www.bujanoci.net](http://www.bujanoci.net), [www.wikiliks.org](http://www.wikiliks.org), [www.medvegja.net](http://www.medvegja.net), [www.jetapress.com](http://www.jetapress.com), [www.femrat.info](http://www.femrat.info).

Radio Televizioni i Serbisë ka filluar me emetimin e programit informativ në gjuhën shqipe nga 1 Tetori i vitit 2018. Programi është i emëruar „Lajmet” dhe emitohet çdo ditë nga ora 19 me kohëzgjatje prej përafërsisht 5 minuta. Përveç kësaj, në programin e tretë të RTV Vojvodinës, një herë në javë, **emitohet emisioni prej tridhjetë minutave në gjuhën shqipe.**<sup>47</sup>

Informimi në gjuhën shqipe financiarisht mbështetet nga buxheti shtetëror dhe ai lokal, me bashkëfinancim të projekteve nëpërmjet konkurseve. Në kuadër të Ministrisë së pushtetit lokal dhe vetëqeverisjes lokale ekziston edhe Fondi buxhetor për pakicat nacionale nga i cili një herë në vit shpallet konkurs për financimin e programeve dhe projekteve të bazuara në njërin prej katër fushave të cilat janë kompetencë e Këshillave nacionale të pakicave.

Në bazë të propozimit të Koordinimit të Këshillave nacionale të pakicave, mjetet buxhetore të ndara me konkursin e vitit 2017 dhe 2018 u janë dedikuar sferës së informimit në gjuhët e pakicave nacionale. Me anë të kësaj përkrahje të ofruar mediave dhe produksioneve për prodhimin dhe emetimin e programeve në gjuhën shqipe, mjetet kryesisht i ndahen radiove dhe televizioneve, mediave të shkruara, shoqatave dhe produksioneve për përmbajtje mediale.

Me qëllim të përcjelljes së realizimit të projekteve dhe vlerësimit të efekteve që projektet e bashke financuara japin në kualitetin e informimit në gjuhët e pakicave nacionale, Ministria e kulturës dhe informimit përpilon raporte vjetore mbi konkursin e dedikuar informimit të pakicave nacionale.

Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi, përfaqësuesit e bashkësisë që i përfaqëson, do duhej t'i informoj rreth punës së vet edhe nëpërmjet ueb faqes zyrtare të KKSH-së, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, faqe kjo e cila në gjuhën serbe nuk është azhuruar (përditësuar) qysh nga viti 2014.<sup>48</sup> Përveç kësaj, KKSH shfrytëzon edhe Facebook-un dhe Instagramin me qëllim të promovimit të aktiviteteve të veta dhe informimit të qytetarëve me punën që po e bënë, rrjete sociale këto që i përfshijnë më së shumti popullsinë e re.

Pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare përcjellin edhe programet televizive të shtetit amë dhe shteteve fqinje.

---

<sup>47</sup>Raporti 1/2019 mbi realizimin e Planit akcional: [https://www.ljudskaprava.gov.rs/sites/default/files/dokument\\_file/izveshtaj\\_1-2019.pdf](https://www.ljudskaprava.gov.rs/sites/default/files/dokument_file/izveshtaj_1-2019.pdf)

<sup>48</sup>Është me rëndësi të përmendet që në bazë të Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale këto organe kanë për obligim të kenë ueb faqe në dy gjuhë me përmbajtje mbi aktivitetet e tyre, autorizimet publike, dokumentet me rëndësi dhe vendimet e tyre. Internet prezentimi (ueb faqja) duhet në mënyrë paralele dhe me kohë të përditësohet dhe plotësohet me të dhënat e reja në të dy gjuhët. Ueb faqja e KNSH <http://www.knsh.org/sq-al/ballina.aspx>



### 3. Korniza normative dhe ligjore për informim në gjuhën shqipe

#### 3.1 Korniza normative

**Kushtetuta e Republikës së Serbisë** parasheh që Republika e Serbisë rregullon dhe siguron sistemin në sferën e informimit publik. Në sferën e informimit, Serbia inkurajon frymën e tolerancës dhe dialogut ndërkulturor dhe ndërmerr masa efikase për avancimin e respektimit të ndërsjellë, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në mes të të gjithë njerëzve që jetojnë në territorin e saj, pa ma parasysh identitetin dhe përkatësinë e tyre etnike, kulturore, gjuhësore ose fetare.<sup>49</sup>

**Ligji për informimin publik dhe mediat**<sup>50</sup> definon që informimi i plotë në gjuhën amtare të pakicave nacionale, i bazuar në paanshmëri, duke qenë i drejtë dhe me kohë, është interes publik në sferën e informimit publik në Republikën e Serbisë dhe i kontribuon ruajtjes së identitetit kulturor të pakicave nacionale që jetojnë këtu.

Ligji po ashtu i përcakton obligimin, jo vetëm nivelit qendror por edhe atij lokal, që për çdo vit të shpallin konkurse me qëllim të ngritjes së kualitetit të informimit tek pjesëtarët e pakicave nacionale. Me këtë u mundësohet mediave që funksionojnë në gjuhën e pakicave nacionale që të financohen nga buxheti nëpërmjet projekteve me bashkëfinancim. Për ndarjen e këtyre mjeteve janë të përshkruara procedurat në mënyrë të detajuara. Është bërë përjashtim kur janë në pyetje mediat dhe serviset publike të cilat janë të themeluara nga Këshillat nacionale të pakicave nacionale. Në fazën e privatizimit, ligji parasheh masa afirmative në shërbim të medimeve që kanë përmbajtje në gjuhët e pakicave. Përveç asaj që blerësit e këtyre medimeve duhet të ruajnë veprimtarinë e tyre bazë për më së paku 5 vite nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për shitjen/blerjen e kapitalit, ato kanë obligim ligjor të ruajnë programin e caktuar në gjuhën e caktuar, në përputhje me skemën e programit e cila ka qenë duke u aplikuar në periudhën prej dymbëdhjeta muajve para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në këtë mënyrë është siguruar që blerësit e ndërmarrjeve publike, të cilat pjesë të përmbajtjes mediatike kanë pasur edhe në gjuhën e pakicave nacionale, të sigurojnë hapësirë edhe për këto përmbajtje, në mënyrë që të ruhet edhe kjo formë e informimit të pjesëtareve të pakicave nacionale. Me ligj parashihet edhe **Regjistri i mediave**, i cili do të mundësoj të dhëna publike për botuesit mediatik, përfshirë edhe ato në gjuhët e pakicave nacionale.

**Me Ligjin për shërbimin e medias publike** janë përcaktuar dy lloje të shërbimit të medias publike, Radio televizioni i Serbisë dhe Radio televizioni i Vojvodinës. Obligimi i shërbimit të medias publike është që nëpërmjet përmbajtjeve të tyre programore të realizojnë interesin e përgjithshëm publik i cili nënkupton, në mes tjerash, edhe përmbushjen e nevojave të qytetarëve me përmbajtje programore që sigurojnë ruajtjen dhe shprehjen e identitetit kulturor të pakicave nacionale, duke kushtuar vëmendje që pakicat nacionale të mund të përcjellin programe të caktuara edhe në gjuhën e tyre amtare.

**Ligji për mediat elektronike** ka sjellur risi e cila mund të jetë e një rëndësie të veçantë për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtës për t'u informuar në gjuhën e pakicave nacionale. Ky ligj karakterizohet me kompetencën e dedikuar për këshillat nacionale që nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët në kuadër të

<sup>49</sup>Kushtetuta e Republikës së Serbisë, Neni. 81

<sup>50</sup>"Gz. Zyrtare e RS", nr. 83/2014, 58/2015 dhe 12/2016 – interpretim autentik

organit joformal Koordinimi i këshillave nacionale të pakicave nacionale t'i propozojnë **anëtarë në Këshillin e trupave rregullative për mediat elektronike**<sup>51</sup>. Interesat e shfrytëzuesve të gjuhës së pakicave janë të siguruara edhe me organizimin dhe punën e Trupës rregullative për mediat elektronike. Në të njëjtën kohë edhe **Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale** parasheh që me marrëveshje të përbashkët, nëpërmjet Koordinimit të këshillave nacionale të pakicave, pakicat nacionale mund të dorëzojnë propozim për dy kandidatë për anëtar të Këshillit të trupave rregullative për mediat elektronike. Kuvendi popullor, në seancën plenare, me anë të votimit zgjedh njërin prej kandidatëve për anëtarë të Këshillit të trupave rregullative për mediat elektronike.

**Me Ligjin mbi ruajtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale** pjesëtarët e pakicave nacionale kanë të drejtë mbi informimin e plotë dhe të paanshëm në gjuhën e tyre, përfshirë edhe të drejtën e shprehjes, marrjes, dërgimit dhe shkëmbimit të informacioneve dhe ideve nëpërmjet shtypit dhe mjeteve tjera të informimit publik. Ligji parasheh që shteti, në programet e radiove dhe televizioneve që ndodhen në shërbimin publik, të sigurojë përmbajtje informative, kulturore e arsimore në gjuhët e pakicave nacionale.

## Dokumentet strategjikë

Një nga dokumentet më të rëndësishëm strategjik i cili merret me informimin, **Strategjia e zhvillimit të sistemit të informimit publik në Republikën e Serbisë** (tash e tutje: Strategjia mediatike), për momentin ndodhet në procesin e shqyrtimit dhe formësimit definitiv, ndërsa aprovimi i dokumentit pritet të ndodhë deri në fundin e vitit 2019. Drafti ekzistues i strategjisë<sup>52</sup> në mënyrë të qartë e trajton çështjen e informimit të qytetarëve për të cilët gjuha serbe nuk është gjuhë amtare, në kuadër të sferës *Diversiteti dhe kualiteti i përmbajtjeve mediale*.<sup>53</sup> Duke u nisur nga supozimi që mediumet duhet të jenë të pavarura dhe të udhëheqin politika editoriale të pavarura, në mes të tjerash të jenë të pavarura në raport edhe me veprimin dhe punën e këshillave nacionale të pakicave nacionale, në strategji propozohen një sërë aktiviteteve që për qëllim kanë **rritjen e objektivitetit dhe shumëllojshmërinë e burimeve dhe përmbajtjeve mediale në mediat që janë në gjuhën e pakicave nacionale**.<sup>54</sup>

**Plani akcional për realizimin e të drejtave të pakicave nacionale** definon aktivitetet që i dedikohen edhe avancimit të informimit në gjuhën e pakicave nacionale. Kapitulli i cili i dedikohet **sferës së kulturës dhe mediave** si qëllim strategjik ka paraparë avancimin e gjendjes në media dhe zhvillimin e përmbajtjeve mediale me rëndësi për pjesëtarët e pakicave nacionale, nëpërmjet sigurimit të informimit kualitativ, gjeografikisht gjithëpërfshirës dhe financiarisht të qëndrueshëm në gjuhët e pakicave nacionale, si dhe sigurimin e financimit në kontinuitet të mediumeve në gjuhët e pakicave nacionale.

Disa prej aktiviteteve të cilat përmenden në këtë dokument janë:

---

<sup>51</sup> Këshillat nacionale me 4 Korrik të vitit 2017 kanë propozuar dy kandidatë (Dragan Marcelo nga Këshilli nacional i pakicës nacionale rumune dhe Stefan Jovanovic nga Këshilli nacional i pakicës nacionale rome), por anëtarët nuk janë emëruar. Nga viti 2017 nuk është shënuar progres në këtë drejtim.

<sup>52</sup> Drafti i strategjisë ndodhet në dispozicion në linkun në vijim <https://www.srbija.gov.rs/specijal/362240>

<sup>53</sup> Përmbajtja është në dispozicion në kapitullin 4.1, fq 30-31

<sup>54</sup> Pasqyra e aktiviteteve që çojnë ka realizimi i këtij qëllimi janë në dispozicion në fq 62-64 të dokumentit

- 1) Sigurimi i financimit të mjaftueshëm dhe stabil me anë të së cilit garantohet qëndrueshmëria e mediave në gjuhën e pakicave nacionale;
- 2) Vlerësimi i dallimeve kulturore dhe gjuhësore nëpërmjet përkrahjes së prodhimeve mediatike të përmbajtjeve me qëllim të realizimit të drejtave të barabarta;
- 3) Promovimi i kulturave të pakicave nacionale si pjesë integrale e shoqërisë në përgjithësi.

### **Standardet ndërkombëtare në realizimin e të drejtës për informimin e pjesëtareve të pakicës nacionale**

Dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e pakicave në Republikën e Serbisë janë të bazuara para së gjithash në Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale dhe në Kartën evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave. Të dy dokumentet janë instrumente të Këshillit të Evropës.

Me anë të Konventës kornizë Republika e Serbisë ka marrë për obligim që të pranojë që në të drejtën për lirinë e shprehjes të secilit pjesëtarë të pakicës nacionale të inkuadrojë edhe lirinë e të menduarit, përcjelljes së informacioneve dhe ideve në gjuhën e pakicës duke mos i përzier organet publike dhe duke mos marrë në konsideratë kufizimet. Po ashtu ka marrë obligim që në kuadër të sistemit të vet ligjor të sigurojë që pjesëtarët e pakicave nacionale të kenë qasje më të lehtë në media, me qëllim të rritjes së tolerancës dhe ofrimit të mundësisë për pluralizëm kulturor.

Karta evropiane për gjuhë rajonale ose të pakicave simbolizon kontributin e dhënë në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e pasurisë kulturore evropiane, nëpërmjet ruajtjes së gjuhëve historike, rajonale dhe atyre të pakicave. Më ligjin mbi ratifikimin e Kartës evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave dhe instrumentin ratifikues i cili është dorëzuar organeve përgjegjëse në Këshillin e Evropës, gjuha shqipe është konstatuar si njëra prej gjuhëve për të cilën janë marrë obligime të përfshira në Kartën evropiane. Karta përshkruan obligimin e shteteve nënshkruese (në këtë rast Republika e Serbisë), që të sigurojnë, inkurajojnë ose lehtësojnë krijimin e kanaleve informative (në këtë rast Radio stacion ose Televizion) në gjuhët rajonale ose të pakicave, të inkurajojnë ose lehtësojnë emetimin e tyre të rregullt, por edhe të ndihmojnë edukimin e gazetarëve dhe të punësuarve të tjerë në sektorin e informimit publik të cilat shfrytëzojnë gjuhët e pakicave.<sup>55</sup>

### **3.2 Korniza institucionale**

Institucionet më të rëndësishme përgjegjëse për implementimin e ligjit në sferën e informimit publik janë:

**1) Ministria e kulturës dhe informimit** është e angazhuar për realizimin e ligjit në sferën e informimit publik. Ministria çdo vit shpallë konkurse për bashkëfinancimin e projekteve që kanë të bëjnë me përmbajtjet mediale në gjuhët e pakicave nacionale. Ministria i dorëzon Këshillave nacionale propozimet e të gjithë projekteve që kanë të bëjnë me pakicat që këshillat i përfaqësojnë, pas së cilës edhe Këshilli nacional i asaj pakice nacionale jep mendimin e vet mbi këto propozime. Komisioni i cili vlerëson kualitetin e projekteve të kandiduara shqyrton

---

<sup>55</sup> Neni 11 i Kartës evropiane.

mendimin e Këshillit nacional, edhe pse sipas ligjit nuk është i obligueshëm që ta marrë parasysh në procesin e marrjes së vendimit.

**2) Njësitë e vetëqeverisjeve lokale** për çdo vit shpallin konkurse me qëllim të ngritjes së kualitetit të informimit. Me qëllim të ofrimit të mundësisë për realizimin e të drejtave të pakicave për informim në gjuhën e tyre amtare dhe kultivimin e kulturës dhe identitetit, njësitë e vetëqeverisjeve lokale sigurojnë një pjesë të mjeteve nëpërmjet bashkëfinancimit ose sigurojnë kushte për punë për mediat të cilat merren me informim në gjuhët e pakicave nacionale.

**3) Autoriteti rregullativ i mediave elektronike** është institucion i pavarur rregullativ i cili kryen autorizimet publike të cilat, në mes tjerash, japin leje për ofrimin e shërbimeve mediale të televizioneve dhe radiove; udhëheqin Regjistrin e shërbimeve mediale dhe evidencën e ofruesve të shërbimeve mediale; përcakton rregullat më të afërta të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjet programore mbi ruajtjen e dinjitetit personal dhe të drejtat tjera personale, ruajtjen e të drejtave të personave nën moshën madhore, ndalimin e gjuhës së urrejtjes etj.; inkurajon ruajtjen dhe mbrojtjen e gjuhës dhe kulturës serbe, si dhe ruajtjen e gjuhëve dhe kulturave të pakicave nacionale. Anëtarët e Autoritetit rregullativ i zgjedh Kuvendi popullor i Republikës së Serbisë, në bazë të propozimit të propozuesit të autorizuar. Në mesin e propozuesve të autorizuar janë, sikur edhe qysh është përmendur, edhe këshillat nacionale të pakicave nacionale të cilët kanë mundësi që me marrëveshje të propozojnë një anëtar të Këshillit rregullativ.<sup>56</sup>

**4) Televizionet publike** emitojnë përmbajtje mediale që janë të definuara si interes publik në sferën e informimit publik. Televizionet publike kanë për obligim që interesin publik ta realizojnë nëpërmjet përmbajtjeve të tyre programore, rrespektivisht të i mundësojnë përfaqësuesve të pakicave nacionale të përcjellin disa programe të caktuara të televizioneve publike edhe në gjuhën e tyre amtare. Televizionet publike emitojnë programe të cilat mundësojnë që edhe bashkësitë tjera, përfshi këtu edhe bashkësinë shumicë, të njohohen me kulturën dhe zakonet e të gjitha pakicave nacionale në Republikën e Serbisë.

#### **4. Roli dhe autorizimet publike të KKSH-së në sferën e informimit**

Në avancimin e informimit në gjuhën shqipe një rol të rëndësishëm ka edhe KKSH, në veçanti Komisioni për informim. Patur parasysh që informimi në gjuhën shqipe në televizionet publike është minorë, e drejta thelbësore për informim në gjuhën amtare të pakicës nacionale shqiptare në këtë moment, në masë të madhe, mund të realizohet nëpërmjet mediave lokale. Për atë është me rëndësi të veçantë që secili konkurs publik për përkrahjen e mediave në vetëqeverisjet lokale të jetë transparent dhe të realizohet në përputhshmëri me kushtet dhe kriteriumet e definuara qartësisht.

Njëri prej roleve të KKSH në sferën e informimit është edhe realizimi i të drejtës për informim publik në gjuhën shqipe. Sipas **Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale**, KKSH mund të themeloj institucione

---

<sup>56</sup> Koordinimi i këshillave nacionale të pakicave nacionale me 4.7.2017 ka propozuar kanë propozuar dy kandidatë (Dargan Marcelo nga Këshilli nacional i pakicës nacionale rumune dhe Stefan Jovanovic i cili atëkohë ka qenë në Këshillin nacional të pakicës nacionale rome), por anëtarët nuk janë emëruar. Nga viti 2017 nuk është shënuar progres në këtë drejtim.

dhe kompani me qëllim të realizimit të të drejtës për informim në gjuhën shqipe, rrespektivisht fondacione për realizimin e objektivave të përgjithshme të qëllimit dhe angazhimit për përmirësimin dhe avancimin e informimit publik.<sup>57</sup>

KKSH me ligj jep propozime për ndarjen e mjeteve për projekte, të cilat financohen nëpërmjet konkurseve të shpallura nga organet e pushtetit publik, me qëllim të ngritjes së kualitetit të informimit për pjesëtarët e pakicave nacionale dhe jep propozime komisioneve për ndarjen e mjeteve sipas konkursit.

Në rast të financimit të projektit të caktuar nga ministrisë përkatëse, njëjtë edhe në rastin e projekteve të cilat i (bashkë)financojnë vetëqeverisjet lokale, KKSH duhet të dorëzojë mendimin mbi të gjitha projekt - propozimet me të cilat është aplikuar në konkursin e ministrisë, rrespektivisht të vetëqeverisjes lokale, e të cilat kanë të bëjnë me gjuhën shqipe. Edhe pse mendimi i KKSH nuk është obligativ për komisionin i cila sjell vendim mbi financimin e projekteve, në përputhshmëri me praktikën e mirë, komisioni përgjatë shqyrtimit të aplikacioneve merr parasysh qëndrimin e Këshillit nacional.

Roli proaktiv i KKSH-së, ndërtimi i bashkëpunimit të ngushtë me mediat dhe shërbimet mediatike me qëllim të avancimit të situatës aktuale në kuadër të planit për rritjen e përmbajtjeve mediale në gjuhën shqipe, dhe pjesëmarrja transparente në procesin e marrjes së vendimeve, paraqesin “mekanizmat” të cilët në mënyrë konstante dhe afatgjate duhet të aplikohen në nivelin nacional. KKSH duhet patjetër t’i shfrytëzoj mundësitë e veta ligjore (të cilat në këtë moment nuk po i shfrytëzon në masën e duhur) dhe në mënyrë konstante të provojë të ndikojë në procesin e marrjes së vendimeve strategjike, e po ashtu edhe të marrë pjesë në procesin e marrjes së vendimeve dhe akteve të cilat ndikojnë edhe në të drejtën për informim të pakicave nacionale. Në këtë mënyrë KKSH duhet patjetër, në mënyrë të vazhdueshme, të përcjellë dhe të marrë pjesë në diskutimet dhe dëgjimet publike, të jep propozime dhe mendime, dhe në këtë proces të jetë shumë transparente. KKSH duhet të realizoj të drejtat e pakicës shqiptare duke vepruar në përputhshmëri me autorizimet publike të definuara në ligjin për këshillat nacionale të pakicave nacionale:

- 1) Duke iniciuar ligje, rrespektivisht duke përcjellë realizimin e ligjeve dhe rregullave tjera nga sfera e informimit;
- 2) Duke marrë pjesë në përgatitjen e ligjeve dhe rregullave tjera dhe inicimin dhe sjelljen rrespektivisht ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe rregullave tjera me anë të së cilave rregullohen të drejtat e pakicave nacionale në sferën e informimit, të drejta këto të garantuara me Kushtetutë;
- 3) Duke shfrytëzuar të drejtat për të qenë themelues në sferën e informimit;
- 4) Duke zgjedhur anëtarë në Autoritetin rregullativ, në dakordim me Këshillat e tjera të pakicave nacionaleve, d.m.th. nëpërmjet pjesëmarrjes së rregullt në takime të Koordinimit të këshillave nacionale të pakicave nacionale;
- 5) Duke shfrytëzuar autorizimet tjera në sferën e informimit:
  - Aprovimin e Strategjisë për zhvillimin e informimit në gjuhën e pakicës nacionale;

---

<sup>57</sup> Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale

- Dhënjen e propozimeve për ndarjen e mjeteve për projektet me të cilët aplikohet në konkurset që i publikojnë organet e ndryshme qendrore ose lokale; në këtë rast KKSH duhet të lexoj të gjitha projektet me të cilat është konkurruar në këto konkurse dhe të jep vlerësimin objektiv mbi kualitetin e tyre; në mënyrë që mendimi i KKSH të merret parasysh, është e nevojshme që në mënyrë adekuate, të argumentuar dhe të detajuar të shpjegohet vendimi mbi arsyen se pse një projekt duhet apo nuk duhet të përkrahet rrespektivisht pse mendohet që projekti i propozuar ndikon në informim më kualitativ në gjuhën shqipe;
- Njëpërmjet Koordinimit të këshillave nacionale të pakicave nacionale të jepen propozime dhe rekomandime drejtuar këshillave drejtues dhe këshillave programor të mediave publike në lidhje me programet në gjuhët e pakicave nacionale;
- Dhënia e mendimit mbi kandidatët për redaktorët e programeve në gjuhën e pakicave nacionale në mediat publike (RTS dhe RTV) nëse mediat e lartpërmendura publike kanë redaktorë për programin në gjuhët e pakicave nacionale dhe
- Dhënia e mendimit për raportin e Këshillit programor të mediave publike në lidhje me përmbajtjet programore në gjuhët e pakicave nacionale.

Në anën tjetër, në nivelin lokal, KKSH ka në dispozicion mekanizma dhe resurse të shumta për avancimin e formës, kualitetit dhe përmbajtjes së informimit në gjuhën shqipe njëpërmjet veprimit të KKSH: inicimi i fondacioneve, themelimi i mediave, ofrimi i mbështetjes financiare përmbajtjeve mediale, avancimin e ueb faqes, etj.

Në këtë proces KKSH duhet të jetë e vendosur, t'i përmbahet qëllimeve të veta dhe mundësive ligjore, të jetë transparent dhe gjithëpërfshirës.

## 5. Qëllimet strategjike në sferën e informimit

**Qëllimi i përgjithshëm:** Rritja e kualitetit të informimit dhe raportimit në gjuhën shqipe

**Qëllimet e veçanta:**

- **Digjitalizimi i revistës „Nacionali” dhe krijimi i mundësisë për një shtrirje më të gjerë të kësaj reviste**

Revista „Nacionali” është botim zyrtar i KKSH-së.

„Nacionali” është revistë javore, publikimi i fundit i së cilës, në ueb faqen e KKSH në versionin në gjuhën shqipe është bërë para më shumë se pesë viteve, rrespektivisht në Prill të vitit 2014. „Nacionali

125".<sup>58</sup>Versionet e fundit të revistës në gjuhën serbe dhe angleze në ueb faqen e KKSH-së janë publikuar në Shtator të vitit 2013.<sup>59</sup>

Patur parasysh rolin e KKSH-së në sferën e informimit, është me rëndësi që të riformohet redaksia e revistës dhe të punojë në ngritjen e kualitetit dhe pasurimin e përmbajtjes së revistës. Komisioni për arsim do duhet të përcaktoj strukturën e revistës, të vërtetoj se a janë përmbajtjet relevante për informimin e qytetarëve shqiptar rreth aktiviteteve të këshillit, por edhe përmbajtjet tjera për kulturën, arsimin, përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit. KKSH do duhej të merr në konsideratë mundësinë që një pjesë e revistës t'i kushtohet edhe të rinjëve dhe eventualisht t'i dedikohet një pjesë e revistës të cilën të rinjtë do ta shfrytëzonin dhe plotësonin në bazë të ideve të tyre.

Tash kur interneti po shndërrohet çdo ditë e më shumë në zgjedhjen e të rinjëve për të hulumtuar informacione, është me rëndësi që KKSH të mundohet të digjitalizojë të gjitha botimet e mëparshme dhe botimet e ardhshme të revistës. Rolin kryesor në këtë proces duhet ta marrë Komisioni për informim, i cili, me qëllim të rritjes së kualitetit të informimit, duhet të përkrahë krijimin e përmbajtjeve të reja elektronike. Digjitalizimi i revistës mund të kryhet me përkrahjen dhe përvojën teknike të kompanive të IT, ndërsa në këtë proces në veçanti mund të inkuadrohen të rinjtë.

Paralelisht me procesin e digjitalizimit, është më rëndësi të promovohet dhe paralajmërohet publikimi i çdo numri të revistës në formën elektronike – në mënyrë që drejtpërsëdrejti të ndikohet në promovimin sa më të madhe të revistës dhe në ngritjen e nivelit mbi informacionet që ndodhen në dispozicion e të cilat i përkasin dhe u dedikohen bashkësisë shqiptare.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Pasurimi dhe rritja e kualitetit të përmbajtjes së revistës „Nacionali“	Komisioni për informim	Në mënyrë të vazhdueshme	Është përcaktuar struktura e re e revistës Nacionali dhe janë pasuruar temat rreth të cilave shkruhet Janë vërtetuar kapacitetet e punës së redaksisë së revistës Nacionali Janë organizuar trajnime për të punësuarit në	Është e nevojshme të pasurohet përmbajtja me numër më të madhe të temave, sidomos me tema që janë të rëndësishme dhe interesante për të rinjtë. Preferohet që të zvogëlohen temat politike ndërsa përmbajtjet të

<sup>58</sup> Lista e publikimeve në versionin shqip të ueb sajtit të Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare:  
<http://www.knsh.org/Publikime/tabid/83/Revista/Po/language/sq-AL/Default.aspx>

<sup>59</sup> Lista e publikimeve në versionin serbishte të ueb sajtit të Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare:  
<http://www.knsh.org/Publikacije/tabid/131/Revista/Po/language/hr-HR/Default.aspx>

Lista e publikimeve në versionin anglishte të ueb sajtit të Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare:  
<http://www.knsh.org/Publications/tabid/109/Revista/Po/language/en-US/Default.aspx>

			<p>redaksinë e revistës Nacionali</p> <p>Janë gjetur bashkëpunëtorët e jashtëm të cilët do të shkruajnë në mënyrë periodike dhe kohë pas kohe për revistën Nacionali.</p> <p>Numri i bashkëpunëtorëve të ri të jashtëm është definuar.</p>	<p>pasurohen me tekste nga sfera e kulturës, sportit, muzikës, shkencës, teknologjisë etj. por edhe me tekste nga jeta e përditshme (të paralajmërohen aktivitetet, të ofrohen informacione për sferat për të cilat KKSJH është kompetente, të ftohen qytetarët të kandidojnë temat të cilat i konsiderojnë interesante për ta etj.).</p> <p>Të mundësohet informim kualitativ dhe i plotë për pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare mbi të gjitha temat relevante. Të inkuadrohen të rinjtë në këtë proces nëpërmjet shkrimit të teksteve dhe përmbajtjeve.</p> <p>KKSJH mundet të shpallë edhe konkurse për nxënësit dhe të rinjtë për një temë të caktuar dhe t'i publikojë temat më të mira.</p> <p>Është me rëndësi që autorët e teksteve të cilat janë për një periudhë më të gjatë kohore të inkuadruar në përgatitjen e përmbajtjeve të kalojnë edhe trajnime të</p>
--	--	--	--	---



				gazetarisë në mënyrë që jenë sa më profesional.
Digjitalizimi i revistës „Nacionali“	Komisioni për informim IT shërbimet/kompanitë/ profesionistët – kryerja e punës teknike për digjitalizim në përputhshmëri me kërkesat e komisionit	Në mënyrë të vazhdueshme	“Nacionali” është publikuar në formë elektronike	Është me rëndësi që KKSHT në mënyrë të rregullt të publikoj revistën në ueb faqen e vet zyrtare e cila është në dy gjuhë.

- **Krijimi dhe përditësimi (azhurimi) i rregullt i ueb faqes së KKSHT-së**

Ligji mbi Këshillat nacionale të pakicave nacionale<sup>60</sup> parasheh që puna e këshillave nacionale është publike dhe që çdo vendim dhe akt i këshillit nacional publikohet më së voni në afat prej 10 ditëve nga dita e cila hyn në fuqi, rrespektivisht nga dita e marrjes së vendimit, **në ueb faqen e këshillit nacional, e cila duhet të jetë në dy gjuhë, në gjuhën serbe dhe në gjuhën e pakicës nacionale** në këtë rast në gjuhën shqipe.

Ueb faqja aktuale e KKSHT për të fundit është përditësuar (azhuruar) në Maj të vitit 2019 në bazë të cilës mund të krijohet përshtypje e gabuar që këshilli nuk është aktiv. Versioni ueb faqes në gjuhën serbe dhe angleze për të fundit janë përditësuar (azhuruar) me të dhënat mbi aktivitetet e KKSHT, në vitin 2014. Kur është fjala për Vendimet dhe Aktet, në faqen e KKSHT-së janë të publikuara dokumentet kryesore në gjuhën shqipe: Statuti, Rregullorja e punës së KKSHT dhe Strategjia e punës për periudhën 2011 – 2015.<sup>61</sup>

Duke e pasur parasysh (1) obligimin ligjor që puna e KKSHT të jetë publike dhe të gjitha të dhënat të jenë në dispozicion e të publikuara në ueb faqe, (2) domosdoshmërinë e dhënies së informacioneve të qarta, aktuale dhe me kohë mbi aktivitetet, vendimet dhe aktet e aprovuara të këshillit, (3) rëndësinë e krijimit të identitetit vizual dhe (4) rëndësinë e funksionalizimit të plotë, shikueshmërinë dhe thjeshtësinë e ueb faqes, faqja ekzistuese nuk i plotëson këto nevoja dhe obligime të parapara me ligj. Prandaj KKSHT dhe Komisioni për informim, duhet në një afat sa më të shkurtër të krijojnë një ueb faqe të re të KKSHT-së, me anë të së cilës do të tregojnë që KKSHT është e përgjegjshme ndaj qytetarëve të cilët i përfaqëson.

Ueb faqja e re duhet të plotësoj minimumin ligjor për dygjuhësinë, në mënyrë që të mundësohet qasje më e lehtë dhe të pajisen më lehtë me informacione grupet e ndryshme të interesuara, përfshi këtu edhe:

- 1) Përfaqësuesit e pakicës nacionale shqiptare të cilët janë në kërkim e sipër të informacioneve mbi punën dhe aktivitetet e organit që ata i përfaqëson,
- 2) Qytetarët e bashkësive tjera etnike të cilët janë të interesuar për punën e Këshillit dhe kulturën e bashkësisë shqiptare – në këtë mënyrë punohet edhe për interkulturalizëm,

<sup>60</sup> Neni 8a Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale

<sup>61</sup> Lista e dokumentacioneve që ndodhen në dispozicion në ueb faqen zyrtare të KKSHT: <http://www.knsh.org/sq-al/aktetnormative.aspx>. Statu dhe strategjia e zhvillimit janë në dispozicion edhe në gjuhën serbe

- 3) Organet shtetërore të cilat informohen rreth punës së KKSH, dhe
- 4) Përfaqësuesit e donatorëve, ambasadave dhe organizatave tjera ndërkombëtare të cilët vizitojnë ueb faqen e KKSH për të marrë informacione të sakta dhe me kohë.

Ueb faqja, në kuptimin minimal, do duhet të përfshijë këto të dhëna mbi:

- 1) Këshillin dhe autorizimet publike, obligimet, anëtarët, komisionet dhe kryetarin;
- 2) Kontaktet, rrespektivisht mundësi për t'ju drejtuar KKSH-së (adresa, numri i telefonit, email adresa, kontakt personi ose personat, varësisht prej organizimit të brendshëm);
- 3) Aktualitetet dhe informacionet e punës së KKSH-së, rrespektivisht lajmet dhe të dhënat mbi aktivitetet e KKSH-së dhe anëtarëve të saj të cilat janë në interes të masës së gjerë, komunikata dhe lajmërimi të aktiviteteve në vijim. Këtu do të ishte me rëndësi të shqyrtohet mundësia e ndarjes së pjesës në të cilën publikohen lajmet dhe aktualitetet në katër nën pjesë, me çrast secila nën pjesë do t'i dedikohet fushave me të cilat merret Këshilli nacional;
- 4) Dokumentet në kuadër të punës së KKSH (Statuti, korniza strategjike, rregullorja e punës, korniza relevante ligjore dhe rregullat me të cilat rregullohet puna e këshillave nacionale);
- 5) Publikimet (përfshi këtu edhe botimet digjitale të revistës "Nacionali").

Përveç këtyre elementeve të cilat do të shërbenin për informim adekuat të shoqërisë, pjesë të veçanta të ueb faqes mund të prezantojnë edhe informacione rreth Shqiptarëve që jetojnë në Serbi, përfshi këtu edhe pasqyrimin e të gjithë subjekteve dhe ndodhive tjera të cilat janë të rëndësishme për bashkësinë etnike shqiptare.

Një pjesë do të mund t'i kushtohet të dhënave të rëndësishme për grupe të ndryshme:

- 1) Për të rinjtë – këtu të merret parasysh që një pjesë t'i kushtohet të rinjëve, aktiviteteve t tyre ose temave që janë të rëndësishme për nën kulturën (subkulturën) e të rinjëve; të bëhet dallimi në mes të rinjëve të tri komunave dhe të rinjëve nga zonat rurale rrespektivisht urbane.
- 2) Për gratë – në bazë të nevojave të cilat paraprakisht janë konstatuar të vendoset cilat janë të dhënat për të cilat kanë nevojë gratë dhe vajzat shqiptare e të cilat janë në përputhshmëri me autorizimet e KKSH-së;
- 3) Për mediat – të dhënat mbi konkurset e publikuara për prodhimin e përmbajtjeve mediale;
- 4) Për shoqërinë civile – të dhënat mbi konkurset e publikuara që i dedikohen shoqërisë civile.

Ueb faqja e KKSH duhet rregullisht të përditësohet (azhurohet) në mënyrë që të realizohet thelbi i qëllimit mbi informimin dhe transparencën e punës së KKSH-së. Këshilli, rrespektivisht Komisioni për informim, duhet të sigurohet që të gjitha informacionet me rëndësi të publikohen me kohë (në afat sa më të shkurtër) por edhe që informacionet e publikuara të jenë të sakta dhe të plota. Me informacione të sakta, të plota dhe të publikuara me kohë nënkuptohet publikimi i informacioneve në pjesën e dedikuar të ueb faqes, në periudhën sa më të shkurtër – menjëherë pas kryerjes së ndonjë aktiviteti ose marrjes së ndonjë vendimi, në atë mënyrë sa që qytetarëve dhe masës së gjerë t'i sigurohet mirëkuptim i plotë për aktivitetin e bërë ose vendimin e

marrë. Këtu një rol të veçantë e luan edhe koordinimi dhe bashkëpunimi i të gjitha komisioneve, bashkëpunim ky që mundëson grumbullimin dhe publikimin e të dhënave nga të gjitha sferat me të cilat merret KKSH-ja dhe që të njëjtat të publikohen me kohë në ueb faqe. Përveç kësaj, KKSH do duhej të paralajmërojë dhe informoj publikun për aktivitetet e planifikuara për të ardhmen, nëpërmjet komunikatave, paralajmërimit të aktiviteteve dhe forma tjera.

Përditësimi (azhurimi) i ueb faqes nënkupton një proces të vazhdueshëm i cili kërkon njohuri bazë të paisjeve dhe procedurave për publikimin e informacioneve në ueb faqe, prandaj edhe paraqet mundësi për angazhimin e njerëzve të rinjë të cilat i posedojnë këto njohuri. Përveç posedimit të njohurive të lartpërmendura, procesi i përditësimit të vazhdueshëm të përmbajtjeve në ueb faqe nënkupton edhe angazhimin e resurseve për përkthim: nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe angleze, për çka edhe KKSH duhet qysh në fillim të këtij procesi të caktoj se kush do të jetë përgjegjës për përkthim.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Krijimi i ueb faqes së KKSH në dy gjuhë	Komisioni për informim Shërbimi IT/ kompania për IT Përkthyesit	6 muaj	Është krijuar ueb faqja funksionale në dy gjuhë	<p>KKSH duhet të ketë kujdes që ueb faqja e re t'i plotësoj kriteriumet e identitetit vizual dhe funksionalizimit të plotë, shikueshmërisë dhe thjeshtësisë së ueb faqes.</p> <p>Nismëtar i kësaj iniciative është Komisioni për informim i cili përgatit të gjitha materialet dhe udhëzimet për punë (propozimin e strukturës së faqes, propozimin e identitetit vizual, të dhënave).</p> <p>Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi i të gjitha Komisioneve të KKSH-së me qëllim të publikimit me kohë të të gjitha të dhënave nga</p>

				<p>sferat që i mbulon Këshilli nacional.</p> <p>KKSH duhet në mënyrë të vazhdueshme ta përditësoj (azhuroj) faqen në të dy gjuhë për çka edhe nevojiten përkthyesit. KKSH nuk ka kapacitete, prandaj duhet të ndahen mjete për përkthyes profesional në gjuhën serbe.</p> <p>Këshilli do duhej të shqyrtoj angazhimin e të rinjëve, gjuhëtarëve, në procesin e përkthimit të materialeve bazë për krijimin e ueb faqes.</p>
<p>Përditësimi (azhurimi) i rregullt i ueb faqes së KKSH-së në gjuhën shqipe dhe serbe</p>	<p>Komisioni për informim Shërbimi i IT Përkthyesit</p>	<p>Në mënyrë të rregullt, të vazhdueshme dhe me kohë</p>	<p>Janë publikuar më së paku pesë teksteve mbi aktivitetet e KKSH-së në nivelin mujor</p> <p>Janë përkthyer tekstat e publikuara mbi aktivitetet e KKSH edhe në gjuhën serbe</p> <p>Publikohen së paku dy tekste në muaj nga autorët e rinjë</p> <p>Përkthehen së paku dy tekste në muaj të autorëve të rinjë</p>	<p>Të dhënat në faqe duhet të jenë të plota, të sakta dhe të publikohen me kohë. KKSH duhet të mendoj rreth angazhimit të njerëzve të rinjë në mënyrë që të lehtësojë dhe përshejtoj procesin e informimit për shoqërinë e gjerë mbi aktivitetet vendimet dhe aktet e saja.</p> <p>Këshilli po ashtu mundet të shqyrtoj mundësinë për organizimin dhe realizimin e trajnimeve për</p>

				anëtarët e Komisionit për informim për shfrytëzimin e mjeteve për përditësimin e ueb faqes. Në këtë mënyrë do të përshpejtohej dhe do të kushtonte më pak procesi i publikimit (sepse nuk do të angazhohej kompani e IT nga jashtë).
--	--	--	--	--

- **Bashkëpunimi me televizionet publike dhe institucionet**

Nga Tetori i vitit 2018 Radio televizioni i Serbisë çdo ditë emiton programin “**Lajmet**”. Duke e pasur parasysh që lajmet e fundit në gjuhën shqipe në Televizion publik janë emituar në vitin 1999, ky hap i ndërmarrë në vitin 2018 është i rëndësishëm. Bëhet fjalë për një emision të formatit të shkurtër i cili nuk incizohet në studio por në të cilin trajtohen përmbajtje të shkurta të ndodhive ditore, me narracion në gjuhën shqipe.

Përveç Lajmeve, në kanalën e tretë të Radio televizionit të Vojvodinës, një herë në javë, emitohej program tridhjetë minutësh në gjuhën shqipe.

Për të realizuar thelbësisht interesin publik në informimin publik, rrespektivisht informimin e paanshëm, të saktë, të plotë dhe me kohë në gjuhën amtare të qytetarëve të Republikës së Serbisë të cilët janë pjesëtarë të pakicave, KKSJ do duhet të marrë rol proaktiv, nëpërmjet disa metodave:

- 1) Nëpërmjet ndërtimit të bashkëpunimit me RTS dhe RTV, në mënyrë që në prodhimin dhe produksionin e përmbajtjeve në gjuhën shqipe në masë të madhe të inkuadrohen folësit e gjuhës shqipe;
- 2) Që kjo të arrihet, duhet të sigurohet kuadër i cili do të plotësonte kushtet e parapara;
- 3) Do të duhet të ndërtojë bashkëpunim edhe mediat lokale dhe të vërtetoj nëse kanë kapacitete teknike që të krijojnë përmbajtje të cilat i plotësojnë standardet e parapara për emetim në televizionet publike;
- 4) Të vërtetohen nevojat e qytetarëve në kuptimin e shikueshmërisë së televizioneve publike;
- 5) Të shikohet mundësia e mediave lokale dhe gazetarëve që të krijojnë përmbajtje, në bazë të nevojave të shprehura të qytetarëve, dhe në përputhje me kualitetin e planifikuar për emetim në televizione publike;
- 6) Nëse puna në terren tregon një shikueshmëri të lartë të televizioneve publike dhe kërkon mundësinë e nevojën për rritjen e përmbajtjeve në gjuhën shqipe, gradualisht të punohet në rritjen e përmbajtjeve

në gjuhën shqipe ose përmbajtjeve që kanë për qëllim prezantimin e kulturës së shqiptarëve që jetojnë në jug të Serbisë e të cilat do të ndodhen në dispozicion për televizionet publike.

Kur është fjala për ndërtimin e bashkëpunimit me RTS dhe RTV në mënyrë që në përmbajtjen e prodhuar dhe projektuar në gjuhën shqipe në masë më të madhe të inkuadrohen pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare, duhet që në radhë të parë të konstatohet mundësia dhe kapacitetet për prodhimin dhe emetimin e përmbajtjeve. Është me rëndësi që KKSH, me përkrahjen e tri komunave dhe mediave lokale, të përpiloj një bazë të veçantë të të dhënave me informacionet mbi:

- 1) Teknikën ekzistuese që ndodhet në dispozicion për prodhimin dhe emetimin e përmbajtjeve mediale;
- 2) Numrin e individëve të cilët mund të inkuadrohen në procesin e prodhimit të përmbajtjeve mediale, duke përfshirë këtu edhe kameramanët, gazetarët, personelin teknik, përkthyesit etj.;
- 3) Numrin e organizatave të shoqërisë civile të cilat edhe vet merren me prodhimin e përmbajtjeve mediale (lajme, filma dhe të ngjashëm) e të cilët mund të inkuadrohen në këtë proces;
- 4) Numrin e akterëve tjerë (konsultant, ekspert) të cilët mund të jenë të rëndësishëm për këtë proces.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Përcaktimi i kapaciteteve për prodhim dhe emetim të përmbajtjeve në gjuhën shqipe	Komisioni për informim Mediat lokale Vetëqeverisjet lokale Organizatave e shoqërisë civile të cilat merren me prodhimin e përmbajtjeve mediale	3 muaj	Janë konstatuar kapacitetet profesionale, dije dhe nevojës për avancim të mëtutjeshëm të atyre që prodhojnë përmbajtje mediatike (lajme, emisione, përmbajtje të ndryshme, filma, etj.) Janë përcaktuar kapacitetet teknike të mediave të cilët merren me prodhimin e përmbajtjeve në gjuhën shqipe. Është krijuar baza me të dhënat mbi kapacitetet kadrovike dhe teknike të bashkësisë shqiptare për prodhimin e përmbajtjeve mediale	Baza me të dhënat mbi kapacitetet kadrovike e teknike për prodhimin e përmbajtjeve në gjuhën shqipe shërben si bazë për të kuptuar mundësinë për bashkëpunim me televizionet publike dhe tregon potencialet për rritjen e kohëzgjatjes së programit në gjuhën shqipe. Baza e të dhënave duhet rregullisht të azhurohet. Para se të vendoset për bashkëpunim me RTS, KKSH duhet të vërtetohet nëse për një bashkëpunim të tillë ka nevojë të arsyeshme.

				<p>Nëpërmjet hulumtimit për nevojat e qytetarëve në sferën e informimit, KKSH duhet të vërtetoj në çfarë mase qytetarët e përcjellin RTS-in dhe cilat emisione i përcjellin më shumë.</p> <p>Dhe krejt në bazë të të dhënave të qarta, KKSH duhet të vendosë nëse është apo nuk është e nevojshme të investohen resurse në këtë lloje të aktivitetit e bashkëpunimit.</p>
<p>Është ndërtuar bashkëpunimi me Ministrinë e kulturës për përcjelljen e kualitetit të realizimit të projekteve që kanë të bëjnë me informimin në gjuhën shqipe.</p>	<p>Komisioni për informim Komisioni për kulturë</p>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme</p>	<p>Monitorimi dhe evaluimi i emisionit „Lajmet“.</p>	<p>KKSH duhet të ndërtojë bashkëpunim me Ministrinë e kulturës në mënyrë që rregullisht të përcjell dhe evaluoj (1) kualitetin e përmbajtjes së emisionit Lajmet(2) kualitetin e narracionit dhe diktimit në gjuhën shqipe në emision (3) nivelin e inkuadrimin të bashkësisë shqiptare në prodhimin e emisionit.</p> <p>Në bazë të monitorimit dhe evaluimit dhe rrolit proaktiv, KKSH duhet t'i dorëzojë ministrisë mendimin dhe të angazhohet për përshtatshmërinë dhe avancimin e</p>

				mëtutjeshëm të përmbajtjes së emisionit.
--	--	--	--	--

- **Mbështetja dhe ofrimi i përkrahjes ndaj prodhimit të përmbajtjeve mediale**

Me qëllim të avancimit të informimit në gjuhën shqipe, KKSH mund të shpallë konkurse publike. Në radhë të parë Këshilli duhet të vendosë prioritete të qarta dhe kushte për konkurs për ndarjen e mjeteve për përpiluesit e përmbajtjeve mediale. Sugjerohet që para kësaj të përpilohet Rregullorja mbi bashkëfinancimin e projekteve në sferën e informimit publik. Rregullorja mund të përpilohet në bazë të modelit të Rregullores ekzistuese mbi bashkëfinancimin e projekteve për realizimin e interes publik në sferën e informimit publik që përdoret nga organet shtetërore.<sup>62</sup> Megjithatë KKSH duhet të konsultohet edhe me kolegët e Këshillave tjera nacionale të cilët po ashtu në këtë mënyrë mbështesin informimin në gjuhën e pakicave nacionale dhe në bashkëpunim me ta të përcaktoj procedurat, rregullat dhe dinamikën e punës. Kjo nënkupton edhe ndërmarrjeje e të gjitha hapave procedural dhe teknike të cilat në fakte nënkuptojnë:

- 1) Marrjen e Vendimit mbi shpalljen e konkursit, me kushtet e definuara në mënyrë të qartë, me shumën e mjeteve që ndodhen në dispozicion, qëllimet e konkursit, afatet, kriteriumet për vlerësimin e kualitetit të projektit, formularët për plotësimin e propozim – projektit, formularët për raportim dhe të gjitha detajet tjera të cilat janë të rëndësishme për aplikuesin; këto të dhëna duhet të jenë të publikuara në ueb faqen e KKSH-së;
- 2) Formimin e komisionit për vlerësimin e kualitet të propozimeve që kanë aplikuar.
- 3) Sigurimin e transparencës së plotë të punës së komisionit, nëpërmjet publikimit të evaluimit dhe ndarjes së mjeteve. Është me rëndësi që vendimi për ndarjen e mjeteve të merret ekskluzivisht në bazë të kriteriumeve të vendosura më herët, duke siguruar paanshmëri dhe objektivitet, vlerësim profesional të propozimeve me të cilat është aplikuar. Këto të dhëna duhet të publikohen dhe të jenë në dispozicion në ueb faqen e KKSH-së.
- 4) Emërimin e një apo më shumë personave (varësisht prej shumës së mjeteve që mund të ndahen, rrespektivisht numrit të projekteve të financuara) për monitorimin e punës së aplikuesit të cilit iu është aprovuar financimi i projektit.

Ndarja e mjeteve për prodhuesit e përmbajtjeve mediale të cilët i kontribuojnë avancimit të nivelit të kualitetit në informimin e pjesëtarëve të pakicës nacionale shqiptare do duhet të shndërrohet në një praktikë të rregullt të KKSH-së.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
-------------	---------------	-----------------	-------------	----------

<sup>62</sup><http://www.kultura.gov.rs/docs/dokumenti/propisi-iz-oblasti-medija/pravilnik-o-sufinansiranju-projekata-za-ostvarivanje-javnog-interesa--u-oblasti-javnog-informisanja-.doc>.



<p>Të definohen rregullat, prioritetet dhe kushtet e konkursit për ndarjen e mjeteve për prodhuesit e përmbajtjeve mediale</p>	<p>Komisioni për informim</p>	<p>Një muaj</p>	<p>Rregullat e definuara qartazi në konkursin për ndarjen e mjeteve për prodhuesit e përmbajtjeve mediale</p> <p>Është definuar i gjithë dokumentacioni përcjellës për plotësimin e propozim - projektit</p> <p>Të gjitha dokumentet në lidhje me konkursin janë publikuar në ueb faqen e KKS-së.</p>	<p>Është shumë me rëndësi që KKS të promovoj dhe publikoj konkursin, në radhë të parë nëpërmjet ueb faqes së vet.</p>
<p>Ofrimi i mbështetjes financiare për prodhimin e përmbajtjeve mediale me qëllim të realizimit të interes publik në sferën e informimit në gjuhën shqipe</p>	<p>Komisioni për informim Komisioni</p>	<p>Shpallja e konkursit një herë në vit</p>	<p>Është mbështetur financiarisht 1 projekt që ka të bëjë me informimin e të rinjëve</p> <p>Është mbështetur financiarisht 1 projekt i rëndësishëm për gratë/femrat</p>	<p>KKS duhet patjetër të publikoj listën e propozim – projekteve të cilët janë mbështetur financiarisht me një qasje transparent për ankesat dhe zgjidhjen/përgjigjen ndaj aplikuesve që nuk janë mbështetur. Përveç kësaj, është me rëndësi që KKS të analizoj dhe konstatoj suksesin e projekteve të realizuara dhe të mbajë evidencë për suksesin e arritur me realizimin e atyre projekteve.</p>

#### - Profesionalizimi i punonjësve në media

Nevojën për aftësim profesional për gazetarët dhe punonjësit e tjerë që punojnë në media me qëllim të avancimit të raportimit media mbi çështjet që janë të rëndësishme për pakicat nacionale dhe me qëllim të raportimit objektiv, e përmend edhe Plani akcional (aktiviteti 3.12).

Këshilli nacional mund të ndërmarrë hapa të caktuara në mënyrë që të mundësoj dhe siguroj avancimin e dijës dhe rritjen e përvojave gazetarëve dhe punonjësve tjerë që punojnë në media. Kjo mund të bëhet në

bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, mediave dhe shoqatave të mediave të nivelit nacional ose lokal, me ekspertë të caktuar dhe donatorë. Mbështetja për realizim e aktiviteteve të këtij lloji mund të sigurohet nga vetëqeverisjet lokale ose nga donatorët, që nënkupton që KKSH duhet të ndërmarrë iniciativë dhe të shkruaj projekt – propozimin.

Duke e patur parasysh që trajnimi për punonjësit e mediave duhet të planifikohet si aktivitet strategjik afatgjatë i KKSH-së, është e domosdoshme që në fillim të çdo viti të përcaktohen kapacitetet e të punësuarve në media, nevojat e tyre për avancim të mëtutjeshëm në mënyrë që të punësuarit në media të bashke rrugëtojnë me të reja dhe aktualitetet në sferën e medias në Republikën e Serbisë. Kjo bazë e të dhënave do të shërbejë për krijimin e aktiviteteve të reja por edhe për avancimin e politikave kur bëhet fjalë për raportimin dhe prodhimin e përmbajtjeve mediale në gjuhën shqipe.

Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kapaciteteve të punëtorëve të medias mund të bëhet në mënyrë të thjeshtë, p.sh., duke i përcjellë pyetësin të gjitha mediave, shoqatave të mediave, produksioneve dhe të tjerëve që merren me prodhimin e përmbajtjeve mediale, reportazheve, raportimeve, etj. Është shumë me rëndësi që KKSH në këtë hap të vlerësimi si bazë të shfrytëzojë edhe bazën e të dhënave të përpiluar ma herët në të cilën ndodhen të gjitha të dhënat për punëtorët e mediave, organizatave, ekspertëve medial etj. (si qëllim specifik të shihet bashkëpunimi me televizionet publike).

Në bazë të nevojave të konstatuara, në bashkëpunim me shtëpitë mediale dhe shoqatat e mediave, KKSH duhet të propozoj trajnime për të punësuarit. Pas mbarimit të trajnimeve, në bashkëpunim me mediat punëtorët e të cilave kanë ndjekur trajnimet, KKSH do duhej të plotësojë evidencat e saja me të dhënat mbi numrin e gazetarëve që kanë ndjekur trajnimet, me përshkrimin e dijes dhe përvojave të reja të arritura në trajnim.

Nevoja për profesionalizimin dhe avancimin e dijes tek të punësuarit në media plotësohet edhe me nevojën për krijimin e bashkëpunimit me shoqatat e gazetarëve (UGS dhe UPGS). Vendosja e bashkëpunimit me kësi lloj unionesh është edhe e rëndësishme edhe e nevojshme. Ky bashkëpunim siguron bartjen më të lehtë të dijes në mes të punësuarve në media, krijon lidhje më të mirë mes tyre, mundësi për ndikim më të madh dhe mundëson mbrojtjen profesionale të të drejtave dhe interesave të gazetarëve profesional.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Përcaktimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe nevojave të punësuarve në media me qëllim të trajnimit të mëtutjeshëm dhe profesionalizimit të punës	Komisioni për informim Mediat lokale OJQ	Dy muaj në fillim të çdo viti	Janë vlerësuar nevojat, njohurit, aftësitë dhe kapacitetet e të punësuarve në media  Janë përcaktuar prioritetet në lidhje me temat për trajnime  Është përcaktuar numri i punëtorëve në	Është shumë me rëndësi që Komisioni për informim në mënyrë të rregullt të plotësojë bazën e të dhënave mbi punëtorët e mediave dhe kapaciteteve të bashkësisë shqiptare për produksionin

			media të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në trajnime	mediatik me të dhënat mbi pjesëmarrësit e trajnimeve, temat dhe njohuritë e arritura.
Realizimi i trajnimeve me qëllim të profesionalizimit dhe avancimit të njohurive të punëtorëve të mediave	Komisioni për informim Mediat lokale	Në mënyrë të vazhdueshme në nivel vjetorë, varësisht prej kursit të cilin e ndjekin	Pjesëmarrësit e trajnimit krijojnë së paku nga një përmbajtje në muaj me tema të reja me anë të së cilave u drejtohet grupeve të ndryshme të interes, e në veçanti të rinjëve	Këtë aktivitet KKSH duhet ta organizoj në bashkëpunim me mediat punëtorët e të cilave do të ndjekin trajnimin SHGPS, UGS, OJQ të cilat merren me prodhimin e përmbajtjeve mediale ose me mediat në përgjithësi (p.sh. fondacioni SHARE) mund të jenë partnerët kryesor, ndërsa KKSH urë lidhëse me mediat lokale dhe të punësuarit e tyre.  Mjetet për trajnime mund të kërkohen nga donatorët ose nga pushtetet lokale.

- **Avancimi i vëllimit, përmbajtjes, kualiteti dhe disponueshmërisë së përmbajtjeve mediale në bashkësinë shqiptare**

Ligji mbi Këshillat nacionalë të pakicave nacionale i mundëson këshillave nacionale që të themelojnë institucione, shoqata, fondacione, kompani në sferën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, edhe atë:

- Të themelojnë institucione dhe kompani shoqërore me qëllim të realizimit të drejtës për informim publik në gjuhën e pakicës nacionale, respektivisht
- Fondacione, me qëllim të realizimit të qëllimit gjithëpërfshirës të informimit në gjuhën e pakicës nacionale

Në bazë të kësaj mundësie, KKSH në vitin 2015 ka themeluar Fondacionin *Lugina*, e cila asnjëherë nuk ka funksionuar. Qëllimet e këtij organi, të përshkruara në aktin themelues, në mes të tjerash janë: promovimi, mbrojtja dhe avancimi i kulturës dhe informimit publik, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, drejtave qytetare dhe atyre të pakicave dhe aktivitete tjera nëpërmjet të cilave fondacioni realizon qëllimet për të mirën e përgjithshme, rrespektivisht interesin e përgjithshëm. Si veprimtari bazë e fondacionit janë përcaktuar prodhimi dhe emetimi i programeve televizive.

Në mënyrë që të ngritët kualiteti dhe disponueshmëria e informacioneve relevant në bashkësinë shqiptare në gjuhën amtare, KKSH duhet të investoj përpjekje shtesë që të siguroj realizimin e këtij qëllimi, që të fuqizoj rolin dhe arsyen e fondacionit të themeluar. Në këtë aspekt, është me rëndësi që, në përputhshmëri me kornizën ligjore që rregullon çështjen e fondacioneve, KKSH të ndërmarrë këto hapa:

- 1) Të kryej ndryshimin, plotësimin dhe përshtatmërinë e aktit themelues paraprak, rrespektivisht statutit, e në përputhshmëri me strukturën e fondacionit dhe me qëllimet e parapara;
- 2) Në bazë të kriteriumeve të përcaktuara në mënyrë të qartë, të emëroj persona të cilët do të përbënin këshillin drejtues të fondacionit dhe do të udhëhiqnin me fondacionin;
- 3) Të përshtatë, ndryshoj dhe definoj në mënyrë precize veprimtarinë e fondacionit;
- 4) Të krijojnë dokumentacione tjera me rëndësi për punën dhe funksionimin e fondacionit, sikur qysh janë planet strategjike ose/edhe planet e aktiviteteve, sigurimit dhe menaxhimit të mjeteve, strategji të komunikimit, monitorimit, etj. Këtu është me rëndësi të zhvillohen mekanizma të mirë për përcjelljen e punës së fondacionit.

Funksionimi dhe puna e fondacionit nënkupton edhe angazhimin e anëtarëve të sajë në:

- 1) Përcjelljen e konkurseve publike për aplikimin me projekte në kuptimin më të gjerë të fjalës – nga organet shtetërore, ambasadat, donatorëve nacional, rajonal e ndërkombëtar, bizneseve dhe akterëve të tjerë;
- 2) Përgatitjen rrespektivisht shkruatren e projekt – propozimeve;
- 3) Realizimin e projekteve të aprovuar.

Për t'u zhvilluar këto procese duke mos hasë në pengesa, është e domosdoshme që të përcaktohen mekanizmat për avancimin e punës në mënyrë të vazhdueshme të anëtarëve të fondacionit dhe profesionalizimin e tyre nëpërmjet trajnimeve, ndarjes së njohurive dhe eksperiencave me këshillat tjera nacionale. Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet:

- 1) Përcjelljes së konkurseve për financimin e projekteve
- 2) Shkrimit të projekt – propozimeve për çka nevojitet ekip i profesionistëve
- 3) Realizimit të projekteve, që po ashtu kërkon profesionalizëm në punën e anëtarëve të fondacionit.

Duke u bazuar në të drejtën e dhënë me ligj që fondacioni i cili është krijuar nga këshilli nacional mund të jetë edhe **botues medial**, në përputhje me ligjet nëpërmjet të cilëve rregullohet sfera e informimit publik dhe mediave, KKSH mund të shqyrtoj edhe këtë mundësi. Pasur parasysh numrin e madhe të mediave elektronike

të cilat merren me informimin në gjuhën shqipe, është shumë me rëndësi që në mënyrë të kujdesshme dhe me një planifikimi afatgjatë të hyhet në këtë proces, edhe atë për këto arsye:

- 1) Themelimi i një medium të ri lokal kërkon resurse të mjaftueshme – si teknike, njerëzore, kohore, po ashtu edhe financiare;
- 2) Përcaktimi joadekuat i grupeve të synuara (shikuesve/lexuesve potencial) të mediumit të ri, në aspektin afatgjatë do të nënkupton paqëndrueshmëri dhe nuk do të ishte profitabil;
- 3) Përcaktimi joadekuat i nevojave të qytetarëve për këto tri sfera, po ashtu në aspektin afatgjatë do të çonte deri tek mbyllja e këtij medium;

Në bazë të pjesëve të lartpërmendura, është me rëndësi që të zhvillohen dhe definojnë metodologji të sakta në bazë të të cilave do të kryhej përcaktimi dhe definimi i nevojave të qytetarëve shqiptar në sferën e përmbajtjeve mediale dhe formatit të tyre. Ky identifikim i nevojave do të mundësonte edhe marrjen e përgjigjes në lidhje me nevojën e hapjes apo krijimit të një medium të ri në gjuhën shqipe, e nëse tregohet se është e nevojshme – atëherë në çfarë forme (Radio televizioni i ri, portal, media e shkruar). Vëmendje e veçantë në këtë situatë duhet t'i kushtohet popullsisë së re në tri komunat, duke patur parasysh moshën mesatare të shqiptarëve në këto tri komuna. Përveç strukturës së gjeneratave është me rëndësi që KKSH të përcaktoj edhe dallimet gjinore të cilave duhet të i kushtohet vëmendje dhe krijohet hapësire në përmbajtjet mediale. Dallimi në mes qytetarëve që jetojnë në zonat rurale dhe atyre që jetojnë në zonat urbane është i theksuar prandaj edhe instrumentet për grumbullimin e të dhënave të nevojshme duhet të përshtaten edhe në këtë aspekt.

Konstatimi i nevojave do të përcaktonte edhe perceptimin e qytetarëve ndaj mediave ekzistuese dhe përmbajtjes së tyre, prandaj edhe do të kontribuonin në grumbullimin e të dhënave mbi mundësinë e avancimit të përmbajtjeve mediale ekzistuese (në bashkëpunim me mediat në fjalë). Dhe krejt pasi që të përcaktohen nevojat, KKSH duhet të filloj me hapat e mëtutjeshëm për themelimin e mediumit të ri lokal nëpërmjet fondacionit që tanimë ekziston. Kjo nënkupton vendosjen e themeleve të qarta dhe precize mbi përmbajtjen e programit, llojin e mediumit, partnerëve potencial (donatorët) dhe personelit i cili do të inkuadrohet në udhëheqjen e mediumit dhe prodhimin e plasimin e përmbajtjeve mediale. Procedura e regjistrimit të mediumit, në përputhshmëri me ligjin, niset dhe udhëhiqet në përputhje me Ligjin e procedurës së regjistrimit në Agjensionin për regjistrimin e biznesit, duke e dorëzuar paraqitjen për regjistrim në Agjension e lartpërmendur.

Në këtë kontekst, nëse të dhënat e grumbulluara nga hulumtimi i realizuar tregojnë si nevojë importimin e shtypit nga shteti amë, KKSH mund të krijoj bashkëpunim dhe të mundësojë ardhjen e shtypit nga shteti amë, në bazë të mundësive të parapara me Ligj.

Aktivitetet	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Konstatimi i nevojave të qytetarëve të tri	Komisioni për informim	6 muaj	Janë identifikuar nevojat e domosdoshme të	KKSH nëpërmjet Komisionit për informim duhet të

<p>komunave në sferën e përbajtjeve mediale</p>			<p>qytetarëve në sferën e informimit në gjuhën amtare</p> <p>Është identifikuar lloji dhe formati i përbajtjeve të cilat për momentin i mungojnë në hapësirën publike mediale</p> <p>Janë identifikuar potencialet për themelimin e mediumit të ri lokal për informim në gjuhën shqipe</p>	<p>përcaktoj nevojat e qytetarëve (varësisht nga gjinia, mosha dhe vendi ku jetojnë). Në bashkëpunim me ekspertët nga sfera e hulumtimit të mbledhjen të dhëna të cilat do të shërbejnë punës së mëtutjeshme të ngjalljes së fondacionit.</p> <p>Të kushtohet vëmendje e veçantë në intervistimin e qëndrimeve të qytetarëve ndaj televizioneve publike, sa përcillen dhe sa qytetarët informohen nga TV publike, si edhe për mediumet tjera, në mënyrë që, përveç tjerash, të konstatohet se a ekziston nevoja e arsyeshme për:</p> <p>1) krijimin e bashkëpunimit më të mirë me RTS-in për ndikim më të madhe në formatin dhe përbajtjen e programeve të RTS.</p> <p>2) themelimin e mediumit të ri lokal dhe</p> <p>3) importimin e shtypit nga shteti amë.</p>
<p>Të filloj puna e fondacionit</p>	<p>Komisioni për informim Shërbimi juridik i KKSH</p>	<p>6 muaj</p>	<p>Është aprovuar statusi i ri definuar, duke i precizuar sferat</p>	<p>Përveç planit të aktiviteteve dhe financimit, KKSH</p>

			<p>në të cilat do të veprojë fondacioni</p> <p>Janë emëruar personat në organet e fondacionit, në përputhshmes me kriteriumet dhe ligjin</p> <p>Janë aprovuar dokumentet strategjike – plani i aktiviteteve dhe plani i financimit.</p>	<p>duhet të definojë edhe dokumentacione tjera strategjike, sikur qysh është plani i monitorimit dhe vlerësimit punës së fondacionit.</p>
<p>Angazhimi për profesionalizimin e punës së anëtarëve të fondacionit</p>	<p>Komisioni për informim i KKSH-së</p> <p>Anëtarët e fondacionit</p> <p>Organizatrat e shoqërisë civile</p> <p>Këshillat e tjera të pakicave nacionale me përvoja të njëjta</p>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme</p>	<p>Janë ngritur kapacitetet e më së paku 5 anëtarëve të fondacionit për shkruarën e projekteve dhe përcjelljen e fondeve relevante për përmbajtjet mediale</p>	<p>Që fondacioni të plotësojë qëllimin e ekzistimit të vet dhe që të funksionoj me kapacitete të plota, ajo duhet të posedojë edhe segmentin e organit të pavarur, veçanërisht pavarësinë financiare.</p> <p>Në këtë aspekt është me rëndësi që anëtarët e fondacionit të kenë njohuri, aftësi dhe kompetencat e nevojshme për të punuar në këtë organ.</p> <p>Prandaj edhe është me rëndësi të zgjidhen anëtarët të cilët do të din ku dhe në çfarë mënyre të kërkojnë mjete të nevojshme për punën e fondacionit dhe mediumit, të shkruajnë dhe realizojnë projekte.</p>

				Partnerë në këtë rrugëtim mund të jenë organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të anëtareve të fondacionit.
Themelimi i mediumit lokal, në përputhje me nevojat e identifikuara të qytetarëve në sferën e informimit	Fondacioni Agjensioni për regjistrimin e bizneseve	Një vit	Është themeluar medium i ri lokal	

## 6. Rekomandime për Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi në sferën e informimit

- 1) Me prioritet t'i përkushtohet krijimit të ueb faqes së re të Këshillit nacional në dy gjuhë dhe në mënyrë të vazhdueshme të përditësohet (azhurohet) dhe plotësohet me të dhënat aktuale.
- 2) Të inkuadrohen të rinjtë në procesin e prodhimit të përmbajtjeve për ueb faqen e KKSH.
- 3) Të ndërtohet bashkëpunim më i afërt dhe më produktiv me mediat, në mënyrë që në periudhë afatgjate të ndikohet në ngritjen e nivelit të informacioneve që ndodhen në dispozicion në gjuhën shqipe në televizionet publike, nëpërmjet 1) plotësimit të emisioneve ekzistuese dhe reportazheve nga niveli lokal; 2) rritjen e minutazhit në emisionet ekzistuese; 3) inkuadrimit e njohësve burimor të gjuhës shqipe në krijimin e përmbajtjeve mediale.
- 4) Të iniciohet bashkëpunimi ndërmjet shoqatave të ndryshme dhe medimeve lokale me qëllim të avancimit të kapaciteteve të punëtorëve të medias dhe avancimit të prodhimit të përmbajtjeve mediale. KKSH duhet të mbështesë inkuadrimit e gazetarëve në ndonjërin prej shoqatave profesionale ekzistuese.
- 5) Të shndërrohet në praktikë mbështetja financiare për prodhimin e përmbajtjeve mediale në sferën e informimit në gjuhën shqipe, duke mbuluar përmbajtje të ndryshme, nëpërmjet bashkëfinancimit të projekteve. Prioritet i veçantë përgjatë mbështetjes financiare t'i jepet përmbajtjeve që kanë të bëjnë me autorët e rinjë, respektivisht përmbajtjeve që u dedikohen të rejave dhe të rinjëve shqiptar.
- 6) Financimi i projekteve që kanë të bëjnë me përmbajtjet mediale të mbështetet në kriteriumet dhe kushtet e definuara mirë, të jenë kushte transparent dhe profesionale.
- 7) Të krijohet baza e të dhënave mbi mediat (të shkruara, elektronike, online), gazetarët dhe redaktorët që punojnë në media në gjuhën shqipe në Serbi. Të përditësohet (azhurohet) rregullisht baza e të dhënave me informacione mbi kapacitetet teknike dhe kadrovike për prodhuesin medial në nivelin



lokal, por edhe me të dhënat mbi trajnimet e ndjekura dhe përfunduara nga ana e të punësuarve në media.

- 8) Të krijohet baza e të dhënave mbi përgatitjet teknike të mediumit të caktuar, kuadrove që i ka në dispozicion, dhe mbi të gjitha elementet tjera të punës së një medium e të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar dhe konstatuar gjendjen e mediave në nivelin lokal
- 9) Në bashkëpunim me mediat lokale të përcaktohen nevojat e të punësuarve në media, me qëllim të profesionalizimit dhe avancimit të punës së tyre dhe, në përputhje me të, të organizohen trajnime adekuate dhe profesionale.
- 10) Të vendoset bashkëpunim dhe partneritet me organizatat e shoqërisë civile me qëllim të përcaktimit të përbashkët të nevojave të shoqërisë, e në veçanti anëtarëve të rinjë, femrave/grave dhe atyre që jetojnë në zonat rurale në tri komunat, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes profesionale, bartjes së aftësive dhe ofrimit të ndihmës përgjatë përpunimit të metodologjisë për hulumtimin dhe intervistimin e nevojave të shoqërisë.
- 11) Rregullisht të hulumtohen nevojat e qytetarëve, pjesëtarëve të pakicës nacionale shqiptare, mbi nivelin aktual të knaqëshmërisë me informimin dhe ofertën mediale në gjuhën shqipe. Theks i veçantë përgjatë intervistimit të qytetarëve të vendoset tek të rinjët, gratë dhe banorët e zonave rurale.
- 12) Të përcaktohet qartësisht a ekziston nevoja dhe potenciali për formimin e mediumit të ri lokal dhe të reagohet sipas rezultateve që merren nga hulumtimi mbi këtë çështje.
- 13) Në bazë të dhënave nga tereni mbi nevojat për formimin e një medium të ri, pasi që të funksionalizohet fondacioni dhe emërohen anëtarët e saj, të trajnohen anëtarët e fondacionit për shkrimin e projekt – propozimeve dhe për realizimin e tyre, e po ashtu të trajnohen edhe për shkathtësitë e grumbullimit të mjeteve financiare.
- 14) Të përcillet aprovimi i Strategjisë për mediat dhe në kuadër të përmbajtjes së kësaj strategjie të përshtatet edhe strategjia për informim e KKSH-së dhe të krijohet praktika dhe politika në sferën e informimit në gjuhën shqipe.
- 15) Nëse vihet deri tek komplikimet dhe problemet e ndryshme që kanë të bëjnë me rregullat e përcaktuara mediale, të shfrytëzohen përvojat e trupave të pavarura, organizatave të shoqërisë civile, por edhe këshillave tjera të cilat kanë realizuar dhe arritur rezultate të theksuara në këtë sferë.
- 16) Të vazhdohet bashkëpunimi dhe të organizohen aktivitete me këshillat nacionale të pakicave tjera nacionale, në veçanti në sferën e shkëmbimit të përvojave me mediat e pakicave tjera nacionale, të përpilohen dhe realizohen projekte të përbashkëta dhe të krijohet rrjeti i bashkëpunimit.

# PËRDORIMI ZYRTAR I GJUHËS DHE SHKRIMIT

---

## 1. Hyrje

E drejta për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit është njëra prej të drejtave më të rëndësishme që u garantohet pakicave nacionale, e e cila mbështetet me një numër të madhë të akteve ligjore dhe rregulloreve vendore dhe ndërkombëtare. Në territorin e Republikës së Serbisë, gjuha serbe dhe shkrimi cirilik janë në përdorim zyrtar. Në të njëjtën kohë, Kushtetuta e Republikës së Serbisë mundëson edhe aplikimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicave në përdorimin e tyre zyrtar, në njësitë e vetëqeverisjeve lokale (tash e tutje NJVL), e që rregullohet me ligje tjera të cilët rregullojnë këtë të drejtë dhe përcaktojnë mënyrat e realizimit të kësaj të drejte të garantuar. D.m.th., kur e shikojmë nga aspekti i kornizës së zhvilluar ligjore, rregullat ligjore të Republikës së Serbisë të cilat e parashohin këtë të drejtë janë në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare.

Siç e definojnë Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, në Nenin 2, si përdorim zyrtar i gjuhës dhe shkrimit konsiderohet përdorimi i tyre në:

- 1) Organet shtetërore
- 2) Organet krahinore, në qytete dhe komuna
- 3) Institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat e tjera të cilat kryejnë autorizime publike
- 4) Ndërmarrje publike dhe shërbime publike, si dhe në punën e organizatave tjera

Përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale është një term i gjerë dhe përfshin disa segmente të cilat i përkasin të drejtave individuale dhe kolektive. Neni 3 i ligjit të lartpërmendur definojnë aplikimin praktik të gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale dhe sqaron çfarë konsiderohet përdorim zyrtar i gjuhës dhe shkrimit.<sup>63</sup>

Mbishkrimet e vendeve/vendbanimeve dhe mbishkrimet tjera gjeografike, emërtimi i shesheve dhe rrugëve, emrat e organeve, organizatave dhe ndërmarrjeve, shpallja e thirrjeve publike, lajmërimet dhe paralajmërimet për opinion, si dhe mbishkrimet e tjera publike, përfshihen në kategorinë e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit.

Sfera e re e cila hapet në këtë kapitull, por që nuk është strikt e lidhur me përdorimin e gjuhës dhe shkrimit, është edhe e drejta e emrit dhe e drejta që në dokumentet zyrtare i njëjti të shënohet në gjuhën amtare dhe në shkrimin që gjuha në fjalë e përdorë, paralelisht me gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

---

<sup>63</sup> 1) komunikim me shkrim ose me gojë me institucionet dhe organizatat në mes veti, si dhe me palët, rrespektivisht qytetarët; 2) zhvillimi i procedurës për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave, përgjegjësi dhe obligimeve ndaj qytetarëve; 3) mbajtja e evidencave nga organet komunale dhe organizatat të cilat kryejnë autorizime publike në territorin e komunës; 4) dhënia e dokumentacioneve publike, si dhe dokumentacioneve tjera të cilat kanë për interes realizimin e të drejtave të qytetarëve të garantuara me ligj; 5) realizimi i të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësi të punëtorëve ose në bazë të punës.

## 2. Përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit shqip – pasqyrimi i gjendjes

Duke e patur parasysh faktin që përfaqësuesit shqiptar ndër vite kanë potencuar dallimin në mes të kornizës ligjore dhe aplikimit të ligjeve në praktikë, Misioni i OSBE-së në vitin 2017 ka mbështetur Institucionin e Avokatit të popullit për të konstatuar nga tereni përdorimin e gjuhës dhe shkrimit shqip. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi, përveç mbikëqyrjes së aplikimit të ligjit, ballafaqimit me mungesë të aplikimit të të njëjtit dhe me probleme konkrete, ka qenë edhe shqiptimi i masave dhe dhënia e rekomandimeve për avancimin e gjendjes së konstatuar. Prandaj, në bazë të gjendjes së konstatuar gjatë punës në teren dhe bashkëbisedimit me zyrtarët komunal, ofiqarët, të punësuarit në institucione shëndetësore dhe me përfaqësuesit e Këshillit kombëtar shqiptar në Serbi(KKSH) janë definuar rekomandimet për eliminimin e vështirësive të konstatuara në teren e që kanë të bëjnë me të drejtën e përdorimit zyrtar në gjuhës dhe shkrimit shqip. Një pjesë e rekomandimeve është definuar edhe për avancimin e punës së deritanishme të KKSH, rekomandime këto që përbëjnë bazën e këtij dokumenti strategjik.

Gjuha dhe shkrimi shqip, të rregulluara në bazë të Statutit të komunave, janë në përdorim zyrtar në territorin e komunave Preshevë, Bujanoc, Medvegje.

Përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit shqip në këto komuna është i dukshëm në përshkrimin e vendeve gjeografike edhe në gjuhën shqipe, por, kur është fjala për përdorimin e tabelave me emrat e rrugëve në dy gjuhë, vërehen praktika të ndryshme. Në shumicën e rasteve këto tabela janë të shkruara në vetëm njërin gjuhë.<sup>64</sup>

Tabelat me mbishkrimet e organeve shtetërore janë të shkruara kryesisht në gjuhën serbe dhe në shkrimin cirilik, që nuk është në përputhje me dispozitat ligjore.<sup>65</sup>

Në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi çështjet që janë të rëndësishme për jetën e tyre të përditshme, duhet të merret parasysh fakti që për dhënien e të dhënave adekuate dhe për ofrimin e shërbimit adekuat nevojitet patjetër edhe njohja e gjuhës shqipe. Numri i përkthyesve profesional në komuna është i pamjaftueshëm, thuhet në hulumtimin e Avokatit të popullit.<sup>66</sup> Kjo në masë të madhe ndikon edhe në përpilimin e akteve zyrtare pasi që është e rëndësishme të sigurohen dokumente në dy gjuhë, të cilat duhet të publikohen në ueb faqet e komunave në mënyrë që qytetarët të njohohen me punën e komunës dhe me vendimet që ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve.

Formë e rëndësishme e të drejtave të pakicave nacionale, e cila tejkalon kornizat ligjore dhe përfaqëson të drejtën universale të çdo njeriu, është e drejta mbi emrin personal. Emri i çdo qytetari të pakicës nacionale mundet të shkruhet edhe në gjuhën amtare dhe shkrimin që përdorë çdo pakicë, paralelisht me shkrimin e

<sup>64</sup> Komuna e Bujanocit është më e përkushtuara kur bëhet fjalë për ndërrimin e tabelave me emrat e rrugëve dhe ato janë në dy gjuhë.

<sup>65</sup> Kështu p.sh. në raportin e Avokatit të popullit përmendet që tabela me emrin Qendra për patundshmëri katastrale Vranjë, Shërbimi kadastral në Bujanoc është e shkruar vetëm në shkrimin cirilik. Pas reagimit të Avokatit të popullit, tabela me emërtimin e Ministrisë së financave, Shërbimi tatimor, filial në Bujanoc, ka siguruar tabelën në dy gjuhë. E njëjta është bërë edhe në komunën e Preshevës.

<sup>66</sup>

<https://www.ombudsman.rs/attachments/article/5690/2%20Poseban%20izvestaj%20zastitnika%20gradjana%20o%20sluzbenoj%20Upotrebi%20albanskog%20jezi...%20ALB.pdf>

detyrueshëm të emrit në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Situata në komunat e Jugut të Serbisë dhe mënyra e punës së shërbimeve të ofiqarisë janë po ashtu të pa harmonizuara kur bëhet fjalë për shkrimin e emrave dhe mbiemrave në librin e amzës.

Kështu në teren mund të vërehen formularë nga shërbimet e ofiqarisë me të dhëna të cilat janë të shkruara ekskluzivisht në gjuhën dhe shkrimin shqip rrespektivisht në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Duhet të përmendet që të dhënat nga librat e amzës paraqesin bazën për vazhdimin e mëtutjeshëm të realizimit të drejtës për t'u regjistruar (shënuar emrin) në të gjithë dokumentacionet tjera përcjellëse në gjuhën amë dhe në shkrimin që gjuha amë e përdorë. Prandaj edhe një pjesë e strategjisë i dedikohet kësaj çështje dhe mënyrave për zgjidhjen e tyre.

Për fund vlen të përmendet që është vërejtur se qytetarët nuk janë të njoftuar më të drejtat të cilat u takojnë e që janë të lidhura me përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, e as me mënyrat e realizimit të të drejtës që parasheh që në dokumentacionin personal emri dhe mbiemri i tyre të shkruhen në gjuhën amtare dhe në shkrimin që gjuha amtare e përdorë. Kjo çështje shfaqet në situata të ndryshme siç janë listat zgjedhore (shumë shpesh vie deri të konfuziteti ku personi nuk të realizoj të drejtën e vet për të votuar), çështja e trashëgimisë dhe shumë çështje tjera.

Ueb faqet e komunave janë burim i rëndësishëm i të dhënave të qytetarëve dhe mënyrë e mirë e komunikimit me qytetarët. Këtë rëndësi e kanë vërejtur përfaqësuesit e komunës së Bujanocit dhe në bazë të saj kanë krijuar ueb sajt në dy gjuhë i cili përmbajnë edhe përkthimin e të gjithë dokumentacioneve të rëndësishëm në dy gjuhë. Situata në dy komunat tjera është ndryshe. Në shikim të parë të dy komunat tjera kanë ueb faqet e tyre në dy gjuhë, por përderisa në komunën e Preshevës ueb sajt i përditësohet vetëm në gjuhën shqipe, lajmi i fundit në gjuhën shqipe në komunën e Medvegjës është i publikuar në vitin 2015.

Edhe pse ekziston kornizë ligjore e zhvilluar mirë, dallimi në mes të ekzistimit të ligjit dhe praktikimit të të njëjtit vërehet mjaftueshëm. Arsyet për një gjendje të tillë mund të jenë prej më të ndryshmeve:

- 1) Mungesa e kapaciteteve në shërbimet e komunave (mungesë e përkthyesve profesional);
- 2) Mungesa e njohjes së rregullave për të punësuarit nëpër shërbimet e komunave;
- 3) Mungesa e njohjes së rregullave për të punësuarit në shërbimet e ofiqarisë ose/edhe në maternitet;
- 4) Mungesa e informacioneve të plota të njerëzve kompetent nëpër komuna mbi faktin që të dhënat në ueb faqet e komunave duhet të jenë në dy gjuhë, duke e pasur parasysh që komuna është në shërbim të të gjithë qytetarëve, pa marr parasysh përkatësinë e tyre etnike ose karakteristikat e tyre gjuhësore;
- 5) Publikimi dhe vendosja e dobët e informacioneve të rëndësishme në ndërtesat e komunës, të cilat për qëllim do të kishin informimin e qytetarëve në dy gjuhë dhe dy shkrime;
- 6) Mjete financiare të pamjaftueshme për ndërrimin e tabelave me emrat e rrugëve, shesheve, dhe vendeve tjera të banuara;
- 7) Angazhimi i pamjaftueshëm i organeve përgjegjëse dhe KKSH në informimin e qytetarëve rreth të drejtave të tyre në përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip dhe ndërrimin e të dhënave të tyre

në certifikatat e lindjes në mënyrë që të realizojnë të drejtën mbi shkruarjen e emrit personal në gjuhën amtare;

- 8) Mungesë e dygjuhësisë tek të punësuarit në komuna, ndërmarrje publike dhe organe tjera publike.

### **3. Korniza normative për realizimin e të drejtës mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip**

#### **3.1. Korniza ligjore**

Korniza normative me anë të së cilës rregullohet e drejta e pjesëtarëve të pakicës nacionale mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit mund të vlerësohet si mjaft e zhvilluar. Megjithatë ja dy çështje shumë të rëndësishme për aplikimin dhe realizimin e kësaj të drejte: 1) aplikimi i i kornizës ligjore e cila me vete bartë një numër të madh të çështjeve tjera të rëndësishme, siç janë mjetet financiare ose kapacitetet e kuadrove profesional; 2) niveli i njohurisë mbi të drejtat të cilët i gëzojnë tek vet qytetarët të cilëve u dedikohen këto të drejta.

Kushtetuta e Republikës së Serbisë, si akti më i lartë ligjor, i dedikon një pjesë të sajë të drejtave të pakicave nacionale dhe ruajtjes së veçorive të tyre: “pjesëtarët e pakicave nacionale kanë të drejtë që (...) të përdorin gjuhën dhe shkrimin e tyre; që në vendet ku përbëjnë shumicën e popullsisë, organet shtetërore, organizatat të cilave u janë besuar autorizime publike, organet krahinore dhe njësitë e vetëqeverisjeve lokale të udhëheqin procedura edhe në gjuhën e pakicave; që në gjuhën e tyre të përdorin emrin dhe mbiemrin e tyre; që në vendet ku përbëjnë shumicë dërmuese, emërtimet tradicionale lokale, emrat e rrugëve, lagjeve dhe shenjat topografike të jenë të shkruara edhe në gjuhën e asaj pakice (...).”<sup>67</sup>

Legjislacioni vendor i cili rregullon kornizën ligjore në të cilën përfshihet edhe përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit të pjesëtarëve të pakicave nacionale, në këtë rast i gjuhës dhe shkrimit shqip, lidhet ngushtë me një mori ligjesh vendore dhe akte ndërkombëtare. Në legjislacionin vendor e drejta për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit rregullohet me Ligjin mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale. Për çështjen e shkruarjes së emrit dhe mbiemrit në librat amzë edhe në gjuhën shqipe, është i rëndësishëm edhe Ligji për librat amzë. Prej akteve ndërkombëtare të cilat Republika e Serbisë i ka ratifikuar dhe në këtë mënyrë i ka përfshirë në sistemin e saj ligjor, përveç dokumenteve të shumta, më së shumti përmendet Karta evropiane mbi gjuhët rajonale ose të pakicave (tash e tutje: Karta) dhe Konventa kornizë mbi mbrojtjen e të drejtave të pakicave nacionale (tash e tutje: Konventa).

#### **E drejta mbi emrin personal**

E drejta mbi emrin personal tejkalon rregulloret e parapara në kuadër të kornizës ligjore, duke e patur parasysh se ajo është e drejtë e garantuar me Nenin 79 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë. Në fakt, në pjesën *E drejta për ruajtjen e veçorive* Kushtetuta parasheh të drejta të numërta për qytetarët e bashkësive

<sup>67</sup> Neni 79 Kushtetuta e RS.

pakicë me qëllim të ruajtjes së veçorive të tyre kulturore, në mes tjerash duke potencuar edhe të drejtën që në gjuhën e tyre amtare të përdorin emrin dhe mbiemrin e tyre.

E drejta për emër personal, rrespektivisht e drejta që emri dhe mbiemri i pjesëtarëve të pakicave nacionale të shkruhet jo vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik por edhe në gjuhën e tyre amtare dhe shkrimin që ajo gjuhë përdorë, tejkalon kornizat e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit dhe nuk është me faktin nëse një gjuhë dhe shkrim i një pakice nacionale (s) është në përdorim zyrtar në territorin e NJVL-së së caktuar. Kjo e drejtë aplikohet në të gjithë territorin e Republikës së Serbisë.

Ligji mbi ruajtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale dhe Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit ruan dhe forcon kornizën sistematike e cila garanton aplikimin dhe realizimin e kësaj të drejte. Në lidhje me këtë, Ligji thotë që “pjesëtarët e pakicave nacionale kanë të drejtë për përzgjedhje të lirë dhe përdorim të emrit të tyre dhe emrave të fëmijëve të tyre, si dhe të drejtë që në të gjitha dokumentacionet personale, evidentimet zyrtare, grumbullimin e të dhënave mbi personalitetet, t'i shkruajnë dhe të përdorin gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale të cilës edhe i përkasin.”<sup>68</sup>

Konventa Kornizë po ashtu jep garancitë rëndësishme për mbrojtjen e të drejtës mbi përdorimin e emrit dhe mbiemrit në gjuhën e pakicës nacionale. Kjo pjesë tregon edhe faktin që është shumë me rëndësi që kjo e drejtë të njihet edhe ligjërisht në kuadër të sistemit juridik dhe të jetë e mbrojtur dhe e garantuar me legjislacionin vendor të vendeve që janë nënshkruese të Konventës Kornizë. Ky dokument po ashtu ofron mundësinë dhe modelin se si kjo e drejtë mund të aplikohet në praktikë – regjistrim paralel i emrit dhe mbiemrit në gjuhën dhe shkrimin zyrtar (d.m.th. në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik) dhe në të njëjtën kohë në gjuhën dhe shkrimin e pakicës (d.m.th. në gjuhën dhe shkrimin shqip në këtë rast).

Në Raportin e Avokatit të popullit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, i cili merret edhe me temën e shkruarjes në mënyrë të drejtë të emrit dhe mbiemrit në gjuhën shqipe, vërehen praktika të ndryshme. Janë konstatuar probleme, vërejtur parregullsi dhe janë dhënë rekomandime për zgjidhjen e tyre. Njëra prej zgjidhjeve të ofruara është edhe përpilimi i katalogut me emrat më të shpeshtë në gjuhën shqipe si mjetë i cili do të ndihmojë punëtorët e ofiqarisë dhe ata të maternitetit dhe spitaleve.

### **Hyrja (aplikimi) i gjuhës në përdorim zyrtar**

Në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale (në vazhdim: NJVL) ku tradicionalisht jetojnë pjesëtarët e pakicave nacionale, gjuha dhe shkrimi i tyre mund të jetë në përdorim të barabartë zyrtar.

Ligji mbi vetëqeverisjen lokale me nenin 11 përcakton në cilën mënyrë në një NJVL hyn në përdorim zyrtarë një gjuhë e re. Patur parasysh që statuti është akti më i lartë ligjorë në NJVL, i cili rregullon një numër të çështjeve të rëndësishme për punën në NJVL dhe jetën e qytetarëve të saj, ai rregullon edhe çështjen e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave. Që gjuha e një pakice nacionale të bëhet gjuhë zyrtare

---

<sup>68</sup> Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, Neni 69, një pjesë *Zgjedhja dhe përdorimi i emrit personal* dhe Neni 18 a Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit. Duhet të përmendet që e drejta për të shkruar emrin në gjuhën amtare dhe në shkrimin e gjuhës amtare në asnjë mënyrë nuk e përjashton shkrimin e emrit në gjuhën dhe shkrimin zyrtar.

duhet që përqindja e pakicës nacionale në territorin e NJVL për të cilën bëhet fjalë të jetë minimum 15% në bazë të rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë.

Është kompetencë e komunës, rrespektivisht NJVL-së, që nëpërmjet organeve të veta e në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, të aprovoj statutin e vet me të cilin, përveç sferave të ndryshme, duhet të përkujdeset edhe për “realizimin, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave (...)”<sup>69</sup>.

Përdorimi dhe aplikimi i gjuhës së pakicës është i rëndësishëm për qytetarët pasi që në forma të ndryshme e lehtëson jetën e përditshme, duke nënkuptuar:

- 1) Përdorimin e gjuhës së pakicës nacionale në procesin administrative e gjyqësor në zhvillimin e procesit administrative e gjyqësor në gjuhën e pakicës nacionale;
- 2) Përdorimin e gjuhës së pakicës në komunikim e organeve që kanë autorizime publike dhe qytetarëve;
- 3) Dhënien e dokumenteve personale publike, udhëheqjen e evidencës zyrtare dhe grumbullimin e të dhënave personale në gjuhën e pakicave nacionale – pranimin e këtyre dokumenteve në gjuhën e pakicave si ligjërish të vlefshme;
- 4) Përdorimin e gjuhës së pakicave në fletat e votimit dhe materialin zgjedhor;
- 5) Përdorimin e gjuhës së pakicave në punën e organeve përfaqësuese.

### **Emrat e vendbanimeve në gjuhën e pakicës nacionale**

Në vendbanimet e vetëqeverisjeve lokale, në të cilat përqindja e pjesëtarëve të pakicës nacionale në kuadër të numrit të përgjithshëm të banorëve në atë territor arrin 15%<sup>70</sup>, emrat e organeve të cilat kryejnë autorizime publike, emrat e organeve lokale, vendeve të banuara, shesheve dhe rrugëve dhe toponimet tjera shkruhen edhe në gjuhën e pakicës nacionale përkatëse, në bazë të traditës dhe shkrimit të tyre.<sup>71</sup> Kuvendi komunal nëpërmjet statudit të vet përcakton emërtimin e lagjeve të banuara dhe paraprkisht merr mendimin e KKSH-së.

Duke pasur parasysh që përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit nënkupton edhe procesin e ndërrimit të emrave të rrugëve, shesheve, rretheve të qytetit dhe fshatrave në gjuhën dhe shkrimin e pakicave nacionale që përdoret si gjuhë zyrtare, kjo pjesë e punës kryhet vetëm pasi të jetë marr mendimi i KKSH-së dhe i Këshillit për marrëdhënie ndëretnike.<sup>72</sup>

Këtë të drejtë e parasheh edhe Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit (neni 11) ku thuhet që “ emrat e organeve që kryejnë autorizime publike, emrat e njësive të vetëqeverisjes lokale, vendeve të banuara,

---

<sup>69</sup> Neni 20, paragrafi 10.

<sup>70</sup> Në bazë të rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë.

<sup>71</sup> Fjala traditë në këtë kuptim i dedikohet mundësisë që një vend ka emërtime të ndryshme në gjuhë të ndryshme.

<sup>72</sup> Këshillat për marrëdhënie ndëretnike janë trupa, formimi dhe mënyra e punës e të cilëve është e definuar me Nenin 98, Ligji mbi vetëqeverisjen lokale.

shesheve dhe rrugëve dhe toponimet tjera shkruhen edhe në gjuhën e pakicës nacionale përkatëse, në bazë të traditës dhe drejtshkrimit të saj.”

Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, thekson që në rajonin në të cilën në përdorim zyrtar aplikohet gjuha dhe shkrimi i pakicës nacionale, emrat e vendeve dhe emërtimet tjera gjeografike, emrat e rrugëve dhe shesheve, emrat e organeve dhe organizatave, shenjat e komunikacionit, lajmërimet dhe paralajmërimet për publikun dhe shkrimet tjera shkruhen edhe në gjuhën e pakicës nacionale.

Konventa Kornizë po ashtu definon të drejtën e pjesëtarëve të pakicave nacionale që në gjuhën e tyre të kenë të shkruara toponimet, emrat tradicionale të vendbanimeve, rrugëve dhe shenjat e tjera topografike që i shërbejnë informimit publik të qytetarëve. Shenjat e këtij lloji mund të jenë të shkruara edhe në shkrimin e pakicës nacionale në vendet ku numër i madhë i pakicës nacionale jeton për një kohë të gjatë dhe nëse ekziston një numër i konsiderueshëm i kërkesave që shenja të këtij lloji të vendosen.

### **Përdorimi i gjuhës së pakicës nacionale në proceset gjyqësore**

Që secili ka të drejtë që në proceset para organeve, rrespektivisht organizatave që përgjatë kryerjes së autorizimeve publike vendosin mbi të drejtën e palëve, të shfrytëzoj gjuhën e vet amtare dhe nëpërmjet gjuhës së vet të njoftohet me rrjedhën e procesit, e përcakton Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit.

Edhe pse i njëjti Ligj parasheh që procedurat administrative, penale, civile dhe procedurat tjera në të cilat vendoset për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve të udhëhiqen në gjuhën serbe, me ligjin e njëjte përcaktohet edhe mundësia që procedura mund të udhëhiqet edhe me në gjuhën e pakicave nacionale të cilat janë në përdorim zyrtar në atë organ, rrespektivisht organizatë e cila udhëheq me procedurën. Personi zyrtar që udhëheq me procedurën është i obliguar të njoftoj palën se cilat gjuhë janë në përdorim zyrtar në atë rajon, rrespektivisht organ pranë të cilit udhëhiqet procedura dhe të kërkoj nga pala të deklarohej se në cilën gjuhë do të udhëhiqet procedura. Përderisa nuk përcaktohet gjuha në të cilën do të udhëhiqet procedura, personi zyrtar procedurën e udhëheq në gjuhën serbe.

Megjithatë, pala përgjatë procedurës duhet të informohet mbi të drejtat të cilat i takojnë dhe mbi mundësitë që ka në lidhje me gjuhën, e po ashtu mundet të kërkoj që procedura të udhëhiqet në gjuhën e tyre amtare.

Në vendet ku gjuhët e pakicave nacionale nuk janë në përdorim zyrtar, organet, rrespektivisht organizatat që udhëheqin me procedurën janë të obliguar që pjesëtarëve të pakicave nacionale t'i sigurojnë:

- 1) Që në procedurën e cila udhëhiqet në këto organe dhe organizata të shfrytëzojë gjuhën dhe shkrimin e vet amtare;
- 2) Që në gjuhën e vet amtare të dorëzojnë ankesë, lutje, padi, propozime dhe mundësi tjera;



- 3) Që me kërkesë të palëve, atyre t'i dorëzohet, në gjuhën e tyre, vendimi, aktvendimi dhe aktet e tjera me anë të të cilëve vendoset mbi të drejtat dhe obligimet e qytetarëve. Në gjuhën e tyre t'i jepen edhe dëftesat, vërtetimet, etj.<sup>73</sup>.

Përdorimi i gjuhës së pakicave nacionale në proceset gjyqësore është po ashtu i rregulluar në kuadër të Kartës. Me ratifikimin e sajë, Republika e Serbisë është obliguar:

- 1) Që në procedurat penale të akuzuarit t'i garantohet e drejta mbi përdorimin e gjuhës amtare dhe që dëshmitë e siguruar në gjuhën e vet amtare, qofshin ato të shkruara apo jo, të pranohen si valide;
- 2) Që në procedurat kontestimore dhe gjëra tjera administrative secili mundet të shfrytëzoj gjuhën e vet (qoftë rajonale apo gjuhë e pakicës) pa e ngarkuar atë me mbulimin e shpenzimeve të përkthimit;
- 3) Nëse përdorimi i gjuhës rajonale ose të pakicës nënkupton angazhimin e përkthyesit, shpenzimet nuk guxon t'i bartë personi i cili është në procedurë port ë njëjtat i mbulon organ i gjyqësorit;
- 4) Dokumentet juridike të shkruara në gjuhët rajonale ose gjuhët e pakicave kanë fuqi juridike.

Kur është fjala mbi përdorimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale, është me rëndësi të merret parasysh se edhe legjislacioni vendor, por edhe aktet ndërkombëtare, theksojnë që të gjitha procedurat duhet të organizohen në gjuhën të cilën pala tjetër e kupton, që nuk nënkupton me automatizëm edhe gjuhën e pakicës nacionale.

### **Këshilli për marrëdhënie ndëretnike**

Mekanizëm shtesë për realizimin e të drejtave të pakicave nacionale në nivelin lokal prezantojnë edhe Këshillat për marrëdhënie ndëretnike (në vazhdim si: KMN). Këto trupa formohen në vendet me popullsi të përziera nacionale, si trupa të pavarura, të përbëra nga anëtarët e bashkësisë serbe dhe pjesëtarët e pakicave nacionale.<sup>74</sup> Por, siç tregojnë të dhënat nga terreni<sup>75</sup>, shumë shpesh këshillat nacionale të pakicave nacionale këto trupe i konsiderojnë si pjesë përbërëse të tyre.

Sikur qysh tregon edhe emërtimi, këta trupa në nivelin lokal janë krijuar si mekanizma me qëllim të avancimit , përmirësimit dhe trashëgimit të marrëdhënieve të mira në mes të qytetarëve të një NJVL e të cilët kanë përkatësi të ndryshme nacionale. Të përsërisim, këshillat për marrëdhënie ndëretnike në radhë të parë shërbejnë për avancimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Është fjala për mekanizma që duhet të marrin hapa parandaluese e jo të jenë trupa të cilët reagojnë pasi që ka ndodhur një situatë e cila nuk është dashur të ndodhë, e që ka qenë e bazuar në baza etnike.

---

<sup>73</sup> Neni 16 Ligji mbi përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit

<sup>74</sup> "Vetqeverisjet lokale në të cilat struktura e popullsisë është e përbërë prej etniteteve të ndryshme, në kuptimin e këtij ligji, konsiderohen si NJVL në të cilët pjesëtarët e një pakicë nacionale përbëjnë më shumë se 5% nga numri i përgjithshëm i popullsisë ose nëse të gjitha pakicat nacionale përbëjnë më shumë se 10% nga numri i përgjithshëm i popullsisë i bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë në Republikën e Serbisë", Ligji mbi vetqeverisjen lokale, Neni 98.

<sup>75</sup> Raport i veçantë i Avokatit të popullit mbi punën e Këshillave për marrëdhënie ndëretnike, me mbështetjen e Misionit të OSBE në Serbi është punuar në vitin 2017. Nodhet në dispozicion në: <https://www.pravamanjina.rs/images/stories/Poseban-izvestaj-o-savetima-za-medjunacionalne-odnose.pdf>

Pasi që KKSH emëron anëtarë nëpër këto trupa, kjo është mundësi e mirë që të ketë rrol aktiv, të emëroj anëtarë në KMN në komunat që i kanë formuar ato dhe në atë mënyrë të:

- 1) Ndikoj në ruajtjen kolektive të të drejtave qytetare të bashkësisë shqiptare dhe të
- 2) Punoj në avancimin e marrëdhënieve në mes të qytetarëve shqiptarë dhe pjesëtarëve të popujve tjera që jetojnë së bashku në territorin e komunës në fjalë

### 3.2. Korniza institucionale

Kornizën institucionale të rëndësishme për të aplikuar përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës nacionale dhe për të kultivuar përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit në fjalë e përbëjnë:

1) **Njësia e vetëqeverisjes lokale** me anë të statutit të vet, sjell vendim mbi aplikimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicës nacionale pasi që të plotësohen normat ligjore, rrespektivisht pasi që të konstatohet që përqindja e popullsisë në fjalë në numrin e përgjithshëm të popullsisë në territorin e asaj NJVL është 15 ose më shumë për qind. Me buxhetin e vet NJVL planifikon mjete të nevojshme për ndërrimin e tabelave të vendbanimeve, rrugëve, shesheve, dhe të njëjtat i vendosë edhe në gjuhën e pakicave nacionale. Në këto raste, NJVL kërkon mendimin e KKSH-së dhe KMN-së. Vetëqeverisja lokale është përgjegjëse për sigurimin e jo vetëm numrit të mjaftueshëm të përkthyesve, por është e obliguar të sigurojë edhe kualitetin e duhur në punën e tyre duke zgjedhur kështu kandidatët më të mirë të cilëve ju besohet kryerja e asaj pune. Po ashtu, për informimin me kohë të qytetarëve, NJVL dhe organet e saja janë të obliguara që njoftimet e rëndësishme t'i publikojnë edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale dhe të kenë ueb faqe aktive të cilën e përditësojnë rregullisht në të dy gjuhët.

2) **Organet shtetërore** të cilat kanë ekspoziturat, degët dhe zyrat e veta në komunat dhe qytetet në të cilat jetojnë përfaqësuesit e pakicave nacionale duhet të vendosin tabelat me emrat e institucioneve të këtyre organeve edhe në gjuhën e pakicave nacionale nga momenti kur gjuha e pakicës nacionale hynë në përdorim zyrtarë.

3) **Gjykatat dhe prokuroritë** sigurojnë që procedurat të udhëhiqen në gjuhët e pakicave nacionale nëse konstatohet që personi ndaj të cilit udhëhiqet procedura nuk e kupton gjuhën serbe. Të gjitha procedurat jo patjetër organizohen në gjuhën e pakicave nacionale, por në gjuhën të cilën personi në fjalë e kupton. Në rast se personi deklarohet që nuk e kupton gjuhën serbe dhe tregon në cilën gjuhë dëshiron që të udhëhiqet procedura, shpenzimet e angazhimit të përkthyesit i mbulojnë institucionet.

4) **Shërbimet e ofiqarisë dhe maternitetet** në të cilat kryhet regjistrimi i të dhënave të fëmijëve të sapolindur duhet të informojnë të gjithë qytetarët mbi të drejtën që emri dhe mbiemri i fëmijëve mund të shkruhet edhe në gjuhën dhe shkrimin shqip. Shërbimet e ofiqarisë dhe komunat janë të obliguara që të sigurojnë formularë në dy gjuhë në mënyrë që regjistrimi i të dhënave të kryhet në përputhje me ligjin. Shërbimet e ofiqarisë duhet të i informojnë qytetarët mbi mundësinë e përmirësimit të të dhënave për emrin dhe mbiemrin në librat e amzës rrespektivisht për mundësinë që emri dhe mbiemri të shkruhen në gjuhën shqipe duke respektuar dhe përcjellë drejtshkrimin e gjuhës shqipe.

#### **4. Roli dhe autorizimet e KKSH në sferën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip**

Me qëllim të realizimit dhe avancimit të të drejtave të qytetarëve të bashkësisë shqiptare mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, KKSH-së iu janë besuar autorizime publike të cilat janë të definuara me Ligjin mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale. Në përputhje me Ligjin e lartpërmendur dhe statutin e KKSH, nëpërmjet organeve të saja ose në mënyrë të pavarur Këshilli

- 1) Formon institucione, shoqata, fondacione, kompani në sferën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit;
- 2) Propozon anëtarin e pakicës nacionale në Këshillin për marrëdhënie ndëretnike në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Përgjatë realizimit të të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, në bazë të ligjit dhe mundësive të ofruara, KKSH mundet organeve përgjegjëse t'i propozoj që në gjuhën shqipe të shënohen emrat e NJVL, vendbanimeve dhe emërtime tjera gjeografike por edhe te propozojë ndryshimin e emrave të rrugëve, shesheve dhe pjesëve tjera të banuara e edhe institucioneve për të cilat është konstatuar se i takojnë një rëndësie të veçantë kur janë në pyetje pakicat nacionale;

KKSH duhet të shfrytëzojë mundësinë dhe të përcaktoj emërtimet tradicionale të NJVL, vendbanimeve dhe emërtimeve tjera gjeografike në gjuhën shqipe, duke e patur parasysh që në tri komunat në të cilat është e koncentruar popullata shqiptare, gjuha dhe shkrimi shqip janë në përdorim zyrtarë. Pasi që KKSH të përcaktojë emërtimet tradicionale të vendeve, ato shfrytëzohen paralelisht me gjuhën serbe dhe me shkrimin cirilik, dhe të njëjtat bëhen zyrtare vetëm pasi që të publikohen në Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë.

Në vet procedurën e përcaktimit të emrit të rrugëve, shesheve, pjesëve të qytetit, fshatrave dhe pjesëve tjera të banuara, nëse në territorin e asaj vetëqeverisje lokale gjuha e pakicës nacionale është gjuhë zyrtare, atëherë KKSH duhet të shfrytëzojë mundësinë e dhënies së mendimit për propozimet që janë në dispozicion.

Përdorimi i gjuhës dhe shkrimit i pakicave nacionale është një sferë mjaftë komplekse dhe shumë çështje e tejkalojnë edhe vet angazhimin e KKSH. Por, atë që KKSH e ka si mundësi të cilën patjetër duhet ta shfrytëzojë është propozimi që i drejtohet organeve përkatëse që të bëjnë monitorimin e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave nacionale. Çka nënkupton kjo në praktikë? D.m.th. gjithkund ku secili Ligj, në secilin moment, parasheh të drejtën e qytetarëve të pakicave nacionale për shfrytëzimin e gjuhës dhe shkrimit të tyre, KKSH duhet të ketë qasje dhe të konstatojë në çfarë mase po realizohet e drejta e garantuar e qytetarëve mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të tyre. Ky proces duhet të përcillet rregullisht në mënyrë që të dhënat e siguruar të jenë të plota ndërsa propozimet e KKSH të jenë konkrete, efikase dhe të pranueshme.

Që grumbullimi i të dhënave nga tereni dhe kontakti i vazhdueshëm me qytetarët është i një rëndësie të veçantë, së pari për përcaktimin e politikave të KKSH si përgjigje ndaj kërkesave të qytetarëve që i përfaqëson, tregon edhe paragrafi 8 neni 22 i Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale ku thuhet që këshilli duhet të ndërmarr masat dhe aktivitetet e nevojshme për avancimin e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës nacionale, në këtë rast të gjuhës dhe shkrimit shqip. Kontaktet e vazhdueshme me

qytetarët e përkatësisë etnike pakicë tregojnë vështirësitë konkrete me të cilat qytetarët përballen përgjatë realizimit të të drejtave individuale. KKSH duhet të jetë në kontakte të vazhdueshme edhe me institucionet përgjegjëse për të cilat supozohet se nuk respektojnë të drejtat e garantuara me ligj dhe të konstatojë cilat janë vështirësitë e realizimit të të drejtave të garantuara me ligjet e aprovuara.

Në mënyrë shtesë, neni 10 i ligjit thotë që KKSH po ashtu “inicion marrjen, rrespektivisht ndryshimin dhe plotësimin e rregullave dhe masave të përkohshme në fushën në të cilën realizohet e drejta në vetëqeverisje, për të arritur barabarësinë e plotë në mes të pjesëtarëve të pakicës dhe pjesëtarëve të shumicës që jetojnë në atë vend. Kjo pjesë e punës së këshillit është e lidhur me këshillin për marrëdhënie ndëretnike si element shtesë i cili mund të shfrytëzohet jo vetëm për avancimin e pozitës së qytetarëve të pakicës nacionale shqiptare por për avancimin e përgjithshëm të marrëdhënieve në mes të të gjithë qytetarëve në nivelin lokal.

Është me rëndësi që të shtohet fakti që KKSH ka mundësi të inicioj publikimin e ligjeve më të rëndësishme të Republikës së Serbisë në gjuhën e pakicës nacionale e cila ndodhet në përdorim zyrtar dhe të ofrojë ndihmë profesionale dhe ndihma tjera, në përputhje me mundësitë e veta, në procesin e përkthimit të ligjeve. Me qëllim të përzgjedhjes së ligjeve më të rëndësishme është me rëndësi që këshilli të jetë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, sepse nuk do të ishte e drejtë që të supozohet cilat janë ligjet më të rëndësishëm që merren me pakicat nacionale, prandaj edhe duhet që të përkthehen ligjet të cilat janë të rëndësishëm për të gjithë qytetarët dhe për jetën e tyre të përditshme.<sup>76</sup>

Në mënyrë që të avancohet aplikimi i të drejtës mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip, KKSH duhet të fillojë nga të drejtat dhe obligimet e veta ligjore dhe:

- 1) Në mënyrë të vazhdueshme t'i informojë qytetarët me të drejtat e veta dhe mënyrat e realizimit të tyre.
- 2) Të ndërtoj bashkëpunim me NJVL me qëllim të identifikimit të vështirësive në teren dhe të propozoj mënyra për tejkalimin e të njëjtëve, krejt kjo me qëllim të plotësimit të obligimit ligjorë dhe dhënjen e informacioneve dhe shërbimeve me kohë në gjuhën shqipe dhe shkrimin shqip.
- 3) Në bashkëpunim me ekspertet e historisë shqiptare dhe njohësit e kulturës shqiptare, të zgjedh personalitete të rëndësishme historike dhe ndodhi të veçanta nga kultura shqiptare në bazë të të cilëve do të mund të bëhet emërimi i rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike. Këtu duhet t'i kushtohet vëmendje edhe ndjenjave të qytetarëve nga bashkësitë tjera etnike, prandaj edhe është e domosdoshme që këto vendime të merren në bashkëpunim me Këshillin për marrëdhënie ndëretnike.
- 4) Të propozojë anëtarët e KMN lokale dhe të mbajë kontakte të vazhdueshme me ta.
- 5) Në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale të propozoj mënyrat e informimit të qytetarëve në gjuhën shqipe dhe në shkrimin shqip.

---

<sup>76</sup>P.sh. Ligjet të cilat i dedikohen dhe lidhen me realizimin e të drejtave sociale (shtesat e fëmijëve, ndihmën sociale) punësim, shëndetësi, mund të jenë në disa raste më të rëndësishëm se ato ligje të cilët rregullojnë çështjen e autonomisë në sferën e kulturës.

- 6) Të ndërtojë bashkëpunim me NJVL, të përkthejë ose të kërkojë ndihmë në përkthimin e rregullave juridike në gjuhën shqipe dhe në shkrimin shqip. Qytetarëve nga bashkësia shqiptare këshilli duhet t'i mundësojë edhe interpretimin e rregullave të parapara, sepse shpeshherë përkthimi nuk është i mjaftueshëm për kuptimin e plotë të dokumentacioneve juridike.
- 7) Të vendosë dhe forcoj bashkëpunimin me shërbimet e ofiqarisë me qëllim të sigurimit të shkrimit në dy gjuhë të emrave dhe mbiemrave personal.
- 8) Të vendosë bashkëpunim me maternitetet në mënyrë që të sigurojë shkrimin e drejtë të emrave dhe mbiemrave në gjuhën dhe shkrimin shqip.
- 9) Të mbajë kontakte të vazhdueshme me qytetarët në mënyrë që të vërtetohet nëse dhe në çfarë mënyre e në çmasë po realizohen të drejtat e qytetarëve, dhe të njëjtën kohë të përcaktoj mekanizma që në mënyrë sa më të shpejtë të eliminojë vështirësitë e konstatuara.

## 5. Qëllimet strategjike në sferën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit shqip

**Qëllimi i përgjithshëm:** Promovimi dhe realizimi i të drejtës mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit dhe e drejta mbi emrin personal

**Qëllimet e veçanta:**

**- Informimi i qytetarëve mbi të drejtat e gjuhës dhe të drejtat personale**

Realizimi i plotë i të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës shqipe dhe të shkrimit shqip si dhe realizimi i të drejtës mbi emrin personal në masë të mjaftueshme varen edhe prej informimit të qytetarëve. Nëse qytetarët nuk janë të informuar me korpusin e të drejtave të cilat i takojnë dhe u ndodhen në dispozicion, vështirë se mund t'i shfrytëzojnë dhe të bëjnë përpjekje për realizimin e tyre.

Në anën tjetër, KKSH duhet të përdorë kompetencat që ju kanë besuar me kornizën ligjore në mënyrë që e drejta mbi përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe të shkrimit shqip të aplikohet dhe realizohet. Në mes tjerash, është e rëndësishme që të ndërtohet edhe bashkëpunim me KMN në komunat ku ato janë të formuara dhe ku këshilli e emëron një anëtarë të bashkësisë nacionale shqiptare.

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Të organizohet kampanjë me qëllim të informimit të qytetarëve rreth përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit. Kampanja të formohet në atë	KKSH Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit	Në vazhdimësi	Të organizohet nëçdo komuna së paku një herë në vit një kampanjë	Kampanja duhet të realizohet në dy mënyra: online – e drejtuar ka popullata më e re e cila në mënyre masive shfrytëzon internetin e që nuk është e njoftuar me

<p>mënyrë sa që t'i drejtohet kategorive të ndryshme të popullsisë, me theks tek të rinjët, gratë dhe tek lehonitë.</p>				<p>të drejtat e e veta dhe “fytyrë me fytyrë” (tribuna etj.) duke ndarë material promovuese informative sidomos në vendet rurale.</p> <p>Njëra prej shembujve mund të përdoret kampanja e Këshillit nacional të pakicës nacionale sllovaeke i cili ka përpiluar një poster me të dhënat e thjeshta në lidhje me përdorimin zyrtar të gjuhës sllovaeke dhe të shkrimit sllovak. Posterët janë vendosur në institucionet publike dhe ndërmarrjet publike dhe të njëjtat shërbejnë për t'i informuar qytetarët.</p>
<p>Të konstatohet nëse në ndërtesat e komunave, stacionet policore, spitale, maternitete, shtëpi të shëndetit, ndërmarrje publike dhe tjera qëndrojnë lajmërimet të cilat iu dedikohen</p>	<p>KKSH Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit</p>	<p>9 muaj</p>	<p>Është krijuara baza e të dhënave mbi përdorimin e dygjuhësisë në lajmërimet e vendosura nëpër institucionet publike në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.</p>	<p>Të krijohet baza me të dhënat relevante të grumbulluara në teren në mënyrë që të vërtetohet se cilat institucione (lokale, republikane), ndërmarrjet publike, kanë të</p>

qytetarëve dhe janë në dy gjuhë.				siguruara tabela në dy gjuhë.
Në bazë të të dhënave të shkruhen rekomandimet për ndërmarrjet publike dhe institucionet në mënyrë që të eliminojnë problemet e vërejtura dhe konstatuara më herët	Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit	9 muaj	<p>Lista e rekomandimeve është përpiluar</p> <p>Rekomandimet u janë dorëzuar organeve kompetente</p> <p>Në bazë të afatit të caktuar me ligj, të vërtetohet nëse organet kompetente iu janë përgjigjur rekomandimeve të dërguara.</p>	<p>Në përputhje me problemet e vërejtura, edhe përgjigjet e institucioneve, KKSH ka mekanizma shtesë për aplikimin e plotë të rregullave ligjore.</p> <p>Së pari duhet të tentohet të komunikohet drejtpërdrejtë me institucionet dhe ndërmarrjet publike të cilat nuk kanë siguruar tabela në të dy gjuhët.</p> <p>Që rekomandimi të merret parasysh dhe të realizohet duhet ndërmarrja publike ose institucioni publik, në buxhetin e vet, të ketë paraparë punimin e një tabele në dy gjuhë.</p>

### - E drejta mbi emrin dhe mbiemrin personal

Çështja e identitetit personal, e cila është e lidhur me të drejtën mbi emrin personal, i takon një rëndësie të veçantë për ruajtjen e identitetit të çdo njeriu. E drejta mbi emrin personal është e mbrojtur me Kushtetutë dhe ligje. Kushtetuta e Republikës së Serbisë garanton zgjedhje të lirë dhe përdorim të emrit personal dhe emrit të fëmijëve, dhe kjo e drejtë i takon të gjithë qytetarëve, pa marr parasysh orientimin e tyre nacional.<sup>77</sup>

<sup>77</sup>Neni 37. paragrafi 3. dhe Neni 79. paragrafi 1. Kushtetuta e Republikës së Serbisë.

Që një pjesëtarë i pakicës nacionale të realizoj të drejtën për të shkruar emrin në formën burimore në letërnjoftim, duhet të dorëzojë certifikatën e lindjes dhe certifikatën e nënshtetësisë në të cilat emri i tij/saj është i shkruar në formën burimore dhe të kërkojë ekskluzivisht që në formularin për letërnjoftim të shkruhet emir personal në formën burimore. Shkruarja e emrit personal në formën burimore në librat amzë, para së gjithash në librat e lindjes, paraqet bazën për realizimin e të drejtës mbi shkrimin e emrit personal në letërnjoftim, si dhe dokumentacione tjera dhe evidencime publike.

Në anën tjetër, mungesa e informacioneve dhe lajmërimeve për qytetarët paraqet pengesë për realizimin e kësaj të drejte, e në veçanti të drejtës mbi shkrimin e emrit në letërnjoftim dhe dokumentacione tjera publike në gjuhën dhe shkrimin shqip.

Është shumë me rëndësi që punëtorët e ofiqarisë dhe të punësuarit nëpër spitale dhe maternitetet të jenë të njoftuar me procedurat por edhe me obligimin që qytetari i bashkësisë shqiptare të informohen për të drejtat e tyre, para së gjithash me të drejtën që në dokumentet personale të shkruajnë emrin në gjuhën dhe shkrimin shqip.

Me qëllim të zgjidhjes së një pjese të këtij problemi ka filluar punimi dhe krijimi i një katalogu me emrat më të shpeshtë në gjuhën shqipe i cili do të shërbejë si mjet që do të ofrojë ndihmë për ofiqarët dhe punëtorët e shëndetësisë për shkrimin e të dhënave personale në librat e evidencimit.

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
<p>Përpilimi i katalogut me emrat dhe mbiemrat më të shpeshtë në gjuhën shqipe i cili duhet të përmbajë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Formë të drejtë të të shkruarit në gjuhën shqipe</li> <li>- standardizimin e shkrimit në gjuhën serbe dhe në shkrimin cirilik</li> </ul>	<p>KKSH</p> <p>Ministria e administratës shtetërore dhe pushtetit lokal</p> <p>Shërbimi i trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë</p> <p>Misioni i OSBE-së</p>	<p>Deri në fund të vitit 2019</p>	<p>Është përfunduar katalogu</p>	<p>KKSH duhet të verifikojë listën me emrat dhe mbiemrat e grumbulluar nga librat amzë.</p> <p>Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit duhet të vërtetojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- a është përdorur forma e drejtë e shkrimit të emrave dhe mbiemrave në gjuhën shqipe</li> <li>- a është propozuar standardizimi i përshtatshëm i emrave dhe mbiemrave në gjuhën shqipe</li> </ul>



				Duke e patur parasysh që Këshilli nacional i pakicës nacionale sllovaqe ka përpiluar një katalog si ky në vitin 2011, KKSH do duhet të jetë në kontakte të vazhdueshme me këtë këshill nacional në mënyrë që të qartësojë të gjitha paqartësit që mund të paraqiten ndërkohë.
Publikimi i katalogut në formatin online	<p>KKSH</p> <p>Ministria e administratës shtetërore dhe pushtetit lokal</p> <p>Shërbimi i trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë</p> <p>Ministria e shëndetësisë</p> <p>Vetëqeverisjet lokale</p>	Deri në fundin e vitit 2019	Katalogu online është publikuar në ueb faqen e KKSH, Shërbimit të TK-së, Ministrisë së shëndetësisë, Ministrisë së pushtetit lokal dhe në ueb faqet e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë	
Mirëmbajtja dhe plotësimi i rregullt i katalogut të emrave në versionin online	Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit	Sipas nevojës	Katalogu i emrave i përditësuar dhe i publikuar	<p>Ekskluzivisht me propozimin dhe iniciativën e KKSH, katalogu i cili është në dispozicion në formatin online dhe është i publikuar në ueb faqet e KKSH, komunave, ministrive, mund të plotësohet me emra të rinjë.</p> <p>Për secilin emër rrespektivisht</p>

				mbiemër të ri nevojitet pëlqimi i Ministrisë së administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale e cila do të angazhojë ekspertë për standardizimin e shkrimit të emrave dhe mbierave në gjuhën serbë dhe shkrimin cirilik.
Kampanja me qëllim të informimit të qytetarëve për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, e drejtuar kryesisht për gratë e reja dhe lehonitë. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet atyre që jetojnë nëpër vendet rurale.	Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit	Në mënyrë të rregullt	<p>Numri i kërkesave për ndryshimin e të dhënave personale/shkrimit të emrit dhe mbierit në gjuhën shqipe dhe në shkrimin shqip (të dhënat mbi numrin e kërkesave merren nga NJVL).</p> <p>Numri i kërkesave mbi dhënjen e formularëve në dy gjuhë për certifikatat e lindjes, në të cilat emri dhe mbierri në gjuhën shqipe janë të shkruara në formën e drejtë dhe me standardin e aprovuar të shkrimit cirilik (të dhëna që mirën nga spitalet dhe maternitetet).</p>	<p>Të gjitha të dhënat të përcillen nëpërmjet sistemit të ndërtuar për grumbullimin e të dhënave.</p> <p>Është shumë me rëndësi që të informohen qytetarët se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë të drejtë që pa pagesë të kërkojnë ndryshimin e të dhënave të cilat nuk janë shkruar në formë të drejtë në gjuhën shqipe në librat amzë (për ndryshimin e të dhënave që kanë të bëjnë me emrin dhe mbierin janë të angazhuara shërbimet e ofiqarisë së NJVL).</li> <li>- grave të reja, para së gjithash nënave të reja, duhet ti</li> </ul>

				<p>tregohet për të drejtën që në maternitet t'ju jepen formularë në dy gjuhë, rrespektivisht formularë në të cilat emri dhe mbiemri i fëmijëve të tyre do të shkruhet edhe në gjuhën shqipe.</p> <p>Atyre duhet ti tregohet edhe për ekzistimin e katalogut i cili do duhet të jetë në dispozicion për të gjithë personat që në maternitet punojnë me grumbullimin dhe evidentimin e të dhënave të cilat më vonë i dërgohen shërbimeve të ofiqarisë.</p> <p>- t'i shpjegohet qytetarëve që certifikata e lindjes është baza për shkruarjen e emrit dhe mbiemrit në gjuhën shqipe. Prandaj është e rëndësishme të punohet me qytetarët dhe të njëjtit të informohen mbi nevojën për ndryshimin e shkrimit të emrit në librat amzë, në mënyrë që të drejtat e tjera t'i realizohen.</p>
--	--	--	--	---

**- Shkruarja e emrave të vendbanimeve, rrugëve, shesheve dhe institucioneve publike në dy gjuhë, në gjuhën serbe dhe gjuhën shqipe**

Në vendet në të cilat gjuha shqipe është gjuhë zyrtare dhe në të cilat jeton numër i madhë i kësaj bashkësie, emrat e vendeve, rrugëve dhe shesheve duhet të jenë të shkruara edhe në gjuhën shqipe. Përveç kësaj KKSH dhe KMN kanë mundësi të inicioj në ndërrimin e emrave të rrugëve të caktuara.

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Të vërtetohet nëse emrat e vendbanimeve, lagjeve dhe fshatrave janë të shkruara edhe në gjuhën shqipe	Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit	3 muaj	Lista e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve për të cilat nuk janë siguruar tabelat në dy gjuhë	KKSH duhet të përpiloj bazën e të dhënave me listën e të gjitha vendbanimeve, fshatrave dhe lagjeve dhe të mbajë evidencë nëse janë siguruar tabelat në dy gjuhë.
Në bazë të të dhënave të grumbulluara të punohet në sigurimin e tabelave me emrin e vendbanimeve në gjuhën shqipe e të cilat mungojnë	KKSH Komunat Preshevë, Bujanoc e Medvegjë	Në mënyrë të vazhdueshme	Lista e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve për të cilat në ndërkohë janë siguruar tabelat në dy gjuhë	Në mënyrë të vazhdueshme të përditësohet baza e të dhënave e krijuar nga KKSH me të dhënat e reja. Që procesi të jetë më efikas, KKSH mund të ndërtojë bashkëpunim të ngushtë me KMN. Në fakt, NJVL është e obliguar të planifikoj mjete në buxhetin e vet për tabelat në dy gjuhë. KMN do duhet të ketë qasje në shikimin e

				<p>buxhetit dhe të përkujtoj NJVL për planifikimin e mjeteve për këto nevoja nëse një gjëtetillë nuk e ka bërë deri më tani dhe të sigurojnë tabela në dy gjuhë.</p> <p>Të dhënat që mbledh KKSH duhet t'ia jep të gjithë anëtarëve të KMN-së.</p>
<p>Të vërtetohet nëse emrat e rrugëve janë të shkruara edhe në gjuhën shqipe</p>	<p>Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit</p>	<p>6 muaj</p>	<p>Lista e rrugëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë për të cilat nuk janë siguruar tabelat në dy gjuhë</p>	<p>KKSH duhet të përpiloj bazën e të dhënave me listën e rrugëve në secilën komunë dhe të mbajë evidencë nëse janë të siguruar tabela në dy gjuhë</p>
<p>Të përpilohet lista me personalitete të njohura dhe me ngjarje të rëndësishme me qëllim të ndryshimit të emrave të rrugëve dhe shesheve</p>	<p>KKSH – Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit</p> <p>KKSH – Komisioni për kulturë</p> <p>Historianët</p>	<p>6 muaj</p>	<p>Është përpiluar lista me personalitete të njohura në bazë të të cilëve do të mund të emërohen rrugët dhe sheshet</p>	<p>Kjo listë mundë të shfrytëzohet edhe për punën dhe funksionimin e Komisionit për kulturë, krijimit dhe planifikimit të manifestimeve të reja, shënimin e ngjarjeve të rëndësishme të lidhura me kulturën shqiptare.</p>

				Njëkohësisht, Komisioni për arsim mundet po ashtu të ketë dobi nga kjo listë, sidomos për përpilimin e shtojcave të teksteve shkollore, por edhe për aktivitete tjera në kuadër të arsimimit formal dhe joformal.
Ndryshimi i emërtimeve të rrugëve dhe shesheve	KKSH Vetëqeverisjet lokale	12 muaj	Nga një rrugë ose sheshi në secilën komunë iu ka ndryshuar emërtimi	

#### **- Përkthimi i ligjeve dhe rregullave më të rëndësishme në gjuhën shqipe**

Në bazë të Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, rregullat e NJVL duhet të publikohen edhe në gjuhën e pakicës nacionale, në përputhje me statutin dhe aktet e NJVL dhe në përputhje me ligjin.

Ministria e administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale, si ministri përgjegjëse për realizimin e të drejtave të pakicave nacionale, siguron përkthimin dhe publikon përmbledhjen e teksteve të konsoliduara të ligjeve më të rëndësishëm të Republikës së Serbisë të cilët në masë të madhe ose në tërësi merren me realizimin e të drejtave të pakicave nacionale.

Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi mund t'i propozoj ministrisë, duke e arsyetuar propozimin që është i rëndësishëm së veçantë për realizimin e të drejtave dhe lirive të pakicës nacionale, që ministritë përkatëse të sigurojnë përkthimin dhe publikimin e përmbledhjeve të teksteve të konsoliduara të ligjeve të caktuara nga pjesët e ligjit të cilat përmbajnë rregulla që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale, respektivisht rregullojnë mardhëniet shoqërore që janë të rëndësishëm së veçantë për pakicat nacionale.

Po ashtu, KKSH duhet që të tregoj edhe vetë iniciativë dhe të përcaktoj cilat janë ligjet që janë të rëndësishme për realizimin e, para së gjithash, të drejtave të tyre qytetare, dhe jo vetëm ato që janë të lidhura me korpusin e të drejtave të pakicave, dhe ato ligje, rregullore, akte nën ligjore t'i bëjë të jenë në dispozicion edhe në gjuhën shqipe.

Aktiviteti	Pjesëmarrësit	Periudha kohore	Indikatorët	Komentet
Identifikimi i grupit të ligjeve të cilat nevojitet të përkthehen në gjuhën shqipe	Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit Ekspertë në sferën e juridikut	2 muaj	Është përpiluar lista me ligjet të cilat kanë prioritet për t'u përkthyer	Në këtë fazë është me rëndësi që të ndërtohet bashkëpunim me kolegë të Këshillave tjera nacionale të cilët kanë filluar më herët të kryejnë këto aktivitete, e posaçërisht me përfaqësuesit e këshillit nacional hungarez dhe sllovak. Në këtë mënyrë mund të vërtetohet se cilat janë ligjet, përveç ligjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave, të trajtohen si ligje të rëndësishme për qytetarët e pakicave nacionale.
Përkthimi i ligjeve	Përkthyesit Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit	Në mënyrë të vazhdueshme	Janë përkthyer 2 ligje në nivel vjetor	KKSH mund të kërkojë ndihmë dhe përkrahje si nga NJVL-të poashtu edhe nga organet shtetërore (Shërbimi i TK-së, Ministria e pushtetit lokal) ose të shkruaj projekte me qëllim të sigurimit të mjeteve të nevojshme për

				përkthimin e ligjeve.
Publikimi i ligjeve të përkthyer në ueb faqen e KKSH	Shërbimi i IT Komisioni për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit	Një javë nga momenti i përkthimit	Përkthimet e ligjit janë të publikuara dhe në dispozicion	
Qytetarëve nga bashkësia shqiptare t'i ofrohet mundësia e interpretimit dhe kuptimit të akteve ligjore	Shërbimi juridik i KKSH	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri i qytetarëve të cilët kanë kërkuar asistencë juridike me qëllim të kuptimit të ligjeve dhe akteve nën ligjore	Të mbahet evidencë mbi numrin e qytetarëve shqiptar të cilët kanë kërkuar këtë lloj të asistencës.  Për KKSH do të ishte mirë të vërtetohet për cilat ligje qytetarët më së shpeshti kanë kërkuar interpretim dhe mundësi për të kuptuar ligjin.

## 6. Rekomandime për Këshillin kombëtar shqiptar në Serbi në sferën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit

- 1) Të organizohen kampanja që kanë për qëllim njoftimin e qytetarëve shqiptar mbi të drejtat e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit. Vëmendje të veçantë përgjat kampanjës t'i kushtohet strukturën e moshës (të rinjëve) dhe strukturës gjinore (gjinisë femërore) por edhe qytetarëve të cilët jetojnë në zonat urbane, respektivisht në zonat rurale.
- 2) Të informohen qytetarët mbi të drejtën e shkruarjes së emrit dhe mbiemrit personal dhe emrit të fëmijës së tyre në gjuhën dhe shkrimin e gjuhës amtare. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet grave të reja, para së gjithash nënave të sapo lindura.
- 3) Të informohen qytetarët që mund të kryejn përmirësimin pa pagesë të emrit dhe mbiemrit të tyre në librat amzë. Për këtë punë janë të angazhuara shërbimet e ofiqarisë në NJVL.
- 4) Katalogu me emrat dhe mbiemrat më të shpeshtë në gjuhën shqipe të jetë në dispozicion të bashkësisë dhe qytetarëve.
- 5) Të grumbullohen të dhëna mbi emrat të cilat shfrytëzohen në gjuhën shqipe me qëllim të përditësimit dhe azhurimit të katalogut.



- 6) Të punohet me NJVL dhe me KMN në sigurimin e tabelave në dy gjuhë (emrat e vendeve të banuara, fshatrave, pjesëve të lagjeve, rrugëve, shesheve). KKSH në përputhje me të dhënat e grumbulluara dhe me prezencën në teren mund të kërkojë nga NJVL nëpërmjet KMN të sigurohen tabela në dy gjuhë dhe mjetet për sigurimin e të njejtëve të parashihen në buxhetin e vitit të ardhshëm.
- 7) Të përpilohet lista me personalitetet e famshme nëse dëshirohet që të propozohet ndryshimi i emërtimeve të ndonjë rruge ose sheshi. Të konsultohen historianët dhe njohësit e historisë ose të kulturës shqiptare. Të bashkëpunohet me KMN në mënyrë që të kushtohet kujdesë edhe rreth bashkësive tjera etnike të cilat jetojnë në territorin e NJVL në fjalë.
- 8) Të punohet jo vetëm në përkthimin e ligjeve por t'i mundësohet qytetarëve nga bashkësia shqiptare që të kuptojnë aktet ligjore duke organizuar asistencë juridike në hapësirat e KKSH.
- 9) Të vërtetohet dhe të përzgjidhen praktikat e mira të këshillave tjera nacionale (përkthimi i ligjeve, sigurimi i tabeleve në më shumë gjuhë nëpër vendbanime, rrugë dhe sheshe, të organizohen kampanja për qytetarët rreth përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit) dhe të merren modelet ekzistues të cilët kanë dhënë rezultate në praktikë.

## REKOMANDIME PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË PAKICËS KOMBËTARE SHQIPTARE

---

- 1) Për transparencën në punë, është shumë e rëndësishme të krijoni një **faqe dygjuhëshe në internet të KKPSHK** dhe ajo të azhurnohet rregullisht me informacione nga secila prej fushave të mbuluara nga Këshilli. Të gjitha dokumentet e rëndësishme (statusi, vendimet e këshillit, ligjet) dhe buxheti i Këshillit të jenë në dispozicion të publikut përmes kësaj faqe interneti.
- 2) Vendosni bashkëpunim me këshillat e tjerë përmes **Koordinimit të Këshillave kombëtare të pakicave kombëtare** . Përdorni bashkërendimin si një mekanizëm për të rënë dakord mbi fushat e veprimit në katër fusha dhe për të ushtruar të drejtat e pakicës kombëtare shqiptare. Përdorni bashkëpunimin me këshillat individuale për të forcuar kapacitetet, të mësoni dhe të merrni praktikat më të mira dhe të përcaktoni aktivitete që do të orientoheshin në drejtim të komunitetit shqiptar.
- 3) Vazhdimisht punoni në **profesionalizimin dhe zhvillimin profesional të stafit** , veçanërisht të atyre që drejtojnë këshillat e KKSH dhe që merren me çështje juridike. Një mënyrë e profesionalizimit të punës mund të arrihet përmes bashkëpunimit me këshillat e tjerë, takimet me ta, dërgimin e stafit të KKSH në selinë e këshillave të tjerë, të cilat mund të përcjellin njohuritë dhe përvojën e tyre në fusha të ndryshme të punës.
- 4) Të trajnohet një pjesë e anëtarëve të Këshillit për të **shkruar propozimet e projektit, zbatimin e tyre dhe monitorimin e** rezultateve të arritura.
- 5) **Prania e** përhershme **në terren** ka një rëndësi të madhe për informimin e qytetarëve për autorizimet publike të KKSH, mundësitë për të ushtruar të drejtat e tyre, instrumentet në dispozicion.
- 6) Gjatë hartimit të aktiviteteve, me qëllim të qëndrueshmërisë së tyre, por edhe të përgjegjësisë ndaj komunitetit, identifikoni **nevojat e qytetarëve të komunitetit shqiptar** dhe problemet ose vështirësitë e tyre në ushtrimin e të drejtave të tyre, për secilën fushë në të cilën Këshilli ka autoritet. Prandaj, një prani e vazhdueshme në terren (në formën e bisedimeve ose aktiviteteve publike) është thelbësore për përparimin e punës së Këshillit dhe për ushtrimin e të drejtave të pakicës kombëtare shqiptare.
- 7) **Bashkëpunimi ndërmjet komiteteve të ndryshme dhe transferimi i informacionit** është i rëndësishëm për punën e Këshillit, për arritjen e sukseseve dhe për konsolidimin e aktiviteteve (shiko shembullin numër 1 në fushën e kulturës).
- 8) Zhvillimi i **instrumenteve për mbledhjen e të dhënave** (biseda, takime, grupe të fokusit, pyetësorë). Gjatë mbledhjes së të dhënave bashkëpunoni me shkollat, shoqatat e qytetarëve, mediat dhe të gjithë faktorët e identifikuar si të rëndësishëm në fushën për të cilën grumbullohen të dhënat.
- 9) Gjatë mbledhjes së të dhënave të keni kujdes për strukturën **gjimore dhe strukturën e gjeneratave**. Kur është e mundur dhe kur është e nevojshme, identifikoni ndryshimin midis **zonave rurale dhe urbane**.

- 10) Krijoni **bazat e të dhënave** (të azhurohet baza e të dhënave nga prania e vazhdueshme në terren dhe përmes të dhënave të disponueshme) si bazë për krijimin e aktiviteteve ose politikave të reja. Baza e të dhënave duhet të modelohet sipas strukturës gjinore dhe sipas gjeneratave. Kur është e mundur dhe kur është e nevojshme, identifikoni ndryshimin midis zonave rurale dhe urbane.
- 11) Përdorni bazat e të dhënave për të **formuar aktivitete të reja**. Aktivitetet duhet të jenë të ndjeshme ndaj ndryshimeve në moshë, gjini dhe ndryshime në pozicionin gjeografik të qytetarëve nga komuniteti shqiptar - të jeni të vëmendshëm për qytetarët, jo vetëm nga këto tri komuna, por edhe nga pjesët e tjera të Republikës së Serbisë; gjithashtu t'i keni parasysh edhe dallimet mes nevojave të atyre që jetojnë në zonat urbane dhe nga ata që jetojnë në zonat rurale.
- 12) Themelimi i një **Fondacioni** që do të jetë baza për ushtrimin e të drejtave në fushat në të cilat KKSH është aktiv, veçanërisht në fushën e informacionit.
- 13) Të punohet në **kapacitetet e anëtarëve të fondacionit të nevojshme për funksionimin e tij të papenguar**. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet anëtarëve të fondacionit, të ngarkuar me shkrimin e projekteve, në mënyrë që të arrihet pavarësia financiare dhe të sigurohen fonde të mjaftueshme, të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të dëshiruara që janë në shërbim të qytetarëve.

## Rekomandime specifike në fushën e arsimit

### 1) Krijoni një bazë të dhënash për fushën e arsimit:

- Baza e të dhënave duke paraqitur **tekstet shkollore që mungojnë dhe ato që janë lejuar**, të cilat do të përcaktojnë drejtimin e punës së mëtejshme në sigurimin e teksteve shkollore për nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme dhe në kontekstin më të gjerë të reformës arsimore në Republikën e Serbisë dhe dinamikën e tij.
- Në bashkëpunim me bibliotekat e shkollave, krijoni një bazë të dhënash mbi **fondin e bibliotekave shkollore**, si bazë për blerjen e librave të rinjë. Kur përpiloni një listë të librave të rinj (ribotim, etj.), këshillohuni me mësuesit dhe përcaktoni preferencat e nxënësve.
- Në bashkëpunim me shkollat, krijoni **një bazë të dhënash për kapacitetet dhe kompetencat e stafit mësimdhënës për secilën lëndë**, në mënyrë që të siguroni një trajnim shtesë, d.m.th. të punoni në sigurimin e kushteve për arsim cilësor në gjuhën shqipe. Mbi këtë bazë, propozoni mënyrat për të ngritur cilësinë e stafit mësimor brenda dhe jashtë vendit.
- Bazuar në të dhënat e mbledhura, ndihmoni mësuesit dhe shkollat në përcaktimin e përparësive për rinovimin e fondeve të bibliotekës shkollore. Konsultohuni gjithashtu me nxënësit në këtë proces. Mbi këtë bazë, punoni për sigurimin e librave të rinj për nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme.
- Krijoni një bazë të dhënash me një **listë të kërkesave të paraqitura për njohjen e dokumenteve të huaja të arsimit të lartë** në mënyrë që të monitoroni situatën dhe të ofroni

mbështetje(juridike dhe profesionale, sigurimin e informacionit përkatës, etj.) për aplikantët dhe të ndihmoni në përfundimin e këtyre procedurave brenda afatit të duhur.

- Identifikoni **nevojat dhe dëshirat e të rinjve në fushën e arsimit joformal** . Të dhënat e mbledhura duhet të ndihmojnë KKSJH në hartimin e aktiviteteve për të rinjtë në fushën e arsimit joformal.
- 2) Komiteti për arsim duhet të këshillohet me **mësuesit për çdo lëndë** që do të propozonte libra shkollorë për mësimdhënie në gjuhën shqipe.
  - 3) Bazuar në listën e figurave të shquara të rëndësishme për zhvillimin e kulturës shqiptare, punoni në hartimin dhe **shkrimin e shtesave të librave shkollorë**.
  - 4) Në bashkëpunim me shkollat me mësim në gjuhën shqipe dhe qeveritë lokale (të cilat sigurojnë fonde nga buxheti i NJVAL), të ofrohet **ndihmë për mësuesit në vijimin e seminareve të akredituara** përmes bazës relevante rreth kompetencave të mësuesve.
  - 5) Për të mbështetur arritjen e cilësisë së mësimdhënies, hartoni **çmime vjetore për nxënësit** që kanë demonstruar arritje të lakmueshme në fusha të ndryshme.
  - 6) Përcaktoni **fondet për punën e shoqatave të qytetarëve që janë aktive në fushën e arsimit joformal**.
  - 7) Të vendoset bashkëpunimi me **Zyrën për të rinjë** në mënyrë që të kryejnë aktivitete në edukimin joformal në terren, të cilat mund të ketë, ndër të tjera, karakteri ndërkulturor.

### Rekomandime specifike në fushën e kulturës

- 1) Bëni një **listë me figura të shquara në kulturën shqiptare**. Kjo listë mund të jetë e rëndësishme për punën e komiteteve të ndryshme: (1) për kulturë - në bazë të listës, sugjeroni aktivitete dhe manifestime me qëllim të promovimit dhe përkujtimit të atyre personaliteteve; (2) arsim - për shkrimin e shtesave të librave shkollorë; (3) përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit - për të sugjeruar emrat e rrugëve; (4) për informim - të japë kontribute në mënyrë që të informojë qytetarët për persona të rëndësishëm nga kultura shqiptare dhe kontributin e tyre; gjithashtu, kontributet dhe filmat mund të jenë të destinuara edhe për popullatën joshqiptare dhe me qëllim të promovimit të autenticitetit kulturor, si dhe të tregoj kontributin e kulturës shqiptare në zhvillimin e vendit.
- 2) Mbi bazën e të dhënave të disponueshme në bibliotekat publike, **analizoni fondet e bibliotekave** në gjuhën shqipe. Identifikoni praninë e letërsisë bashkëkohore fillimisht të shkruar në gjuhën shqipe ose të përkthyer në shqip nga ndonjë gjuhë tjetër. Mbi këtë bazë, punoni për sigurimin e librave për bibliotekat publike duke paraqitur propozime në Ministrinë e Kulturës dhe Informacionit. Në këtë mënyrë KKSJH punon për modernizimin e fondit librar.
- 3) Bëni një **listë të ngjarjeve të rëndësishme** në historinë kulturore shqiptare me ekspertë në fushat e kulturës, historiografisë dhe shkencave të tjera shoqërore . Kjo listë mund të përdoret gjithashtu nga komitetet e tjera të Këshillit.

- 4) Bëni një **kalendar të të gjitha ngjarjeve ekzistuese** që promovojnë dhe ruajnë specifikën e kulturës bashkëkohore dhe tradicionale shqiptare.
- 5) Identifikoni **mënyrat për vijimësinë e mbajtjes së manifestimeve** (të cilat përfshihen në kalendar).
- 6) Krijoni një **bazë të dhënash të shoqatave të qytetarëve që janë aktive në fushën e zhvillimit dhe ruajtjes së kulturës shqiptare** . Shoqatat e qytetarëve mund të jenë partnere të KKSH në fushën e kulturës dhe të mbështesin zbatimin e aktiviteteve të KKSH.
- 7) Hartoni **konkurse për punën e shoqatave të qytetarëve që merren me kulturë**. Në rast të mungesës së fondeve për një vit, konkursi mund të orientohet drejt ruajtjes dhe promovimit të kulturës tradicionale, ndërsa në vitin e ardhshëm konkursi mund të orientohet në krijimtarinë bashkëkohore. Vëmendje e veçantë në aktivitetet e mbështetura duhet t'i kushtohet grave dhe të rinjve. Qëllimi i aktiviteteve që KKSH do të mbështeste është ta përkrahë krijimtarinë bashkëkohore, të ruajë traditën, por edhe t'i njoftojë qytetarët joshqiptar me elemente të kulturës shqiptare.
- 8) Krijoni një **bazë të dhënash të artistëve nga jugu i Serbisë** (ndarja në krijimtarinë tradicionale dhe bashkëkohore, ndarja në llojin e arteve me të cilat merren, etj.). Mbështetni punën e këtyre artistëve në komunitet dhe për komunitetin. Sidomos të mbështeten artistë që janë të gatshëm të hartojnë dhe të bëjnë aktivitete me të rinjtë dhe për të rinjtë, veçanërisht ata në zonat rurale.
- 9) Të mbështet **bashkëpunimi i artistëve nga komuniteti shqiptar me artistë nga vendi dhe në nivel ndërkombëtar** .
- 10) Bëni një listë të **të mirave kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme** , vendoseni në faqen e internetit dhe përdoreni materialin e mbledhur, ndër të tjera, si përmbajtje për muzeun digjital.
- 11) **Digjitalizoni trashëgiminë kulturore**, si atë tradicionale po ashtu edhe atë bashkëkohore dhe ndërtoni një muze digjital.
- 12) **Vendosni një çmim për kontribut në ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare** (bashkëkohore dhe tradicionale).
- 13) **Të themelohet Enti për kulturë** që do të prezantojë një qasje sistematike ndaj kulturës dhe do të ndërpresë hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve në baza *ad hoc* . Do të ishte institucioni i parë kulturor profesional për të ruajtur, promovuar dhe zhvilluar kulturën e komunitetit shqiptar. Fondet për punën e Institutit sigurohen nga NJVAL dhe KKSH përmes projekteve.

#### **Rekomandime specifike për fushën e informimit**

- 1) Të krijojë një **bazë të dhënash për mediat në dispozicion në gjuhën shqipe**, llojin e mediave të pranishme (portalet në internet, TV, radiostacione dhe të ngjashme), llojin e veprimtarisë që ato ushtrojnë, kapacitetet e tyre teknike dhe pajisjet si dhe potencialin e personelit. Bazuar në të dhënat e mbledhura, mund të sugjerohen përmbajtje të ndryshme mediatike të rëndësishme për popullatën shqiptare, si dhe përmbajtje drejtuar komuniteteve të tjera me qëllim të promovimit të kulturës dhe

specifikës shqiptare. Në të njëjtën kohë, përdorni bazën e të dhënave për të rritur aftësinë e personelit të punonjësve të mediave .

- 2) Hartoni **konkurset për të mbështetur punën e mediave në gjuhën shqipe** .
- 3) Përdorni një bazë të dhënash me personalitete dhe ngjarje të rëndësishme nga kultura dhe historiografia shqiptare dhe, mbi këtë bazë, të hartohen **tema për konkurset për shoqatat e qytetarëve që merren me hartimin e përmbajtjes së mediave, veçanërisht në fushën e kulturës**. Këto projekte mund të synojnë të promovojnë kulturën shqiptare brenda komunitetit, por edhe të informojnë qytetarët për kulturën shqiptare, duke kontribuar kështu në dukshmërinë e komunitetit në shoqërinë më të gjerë dhe të kuptuarit dhe pranimin e specifikave kulturore.
- 4) **Revista NACIONAL (buletin i KKSH) të modernizohet me përmbajtje të re**. Të krijojë bashkëpunim me të rinjtë në mënyrë që të pasurohet përmbajtja për Nacional. Konsultohuni me kolegë të këshillave të tjerë për të hartuar përmbajtjen e buletinit të KKSH. Bëjeni atë që të jetë i disponueshëm edhe në internet.

#### **Rekomandime specifike në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit**

- 1) Një **katalog i emrave më të përdorur shqiptar** duhet të vihet në dispozicion të publikut dhe gjithashtu duhet të vihet në dispozicion në faqen e internetit të Këshillit.
- 2) Vazhdimisht **informoni qytetarët për të drejtat e tyre gjuhësore** (duke organizuar forume ose aktivitete të tjera me qytetarë të moshave dhe gjinive të ndryshme, dhe për secilin grup të hartoni një temë dhe një mënyrë për t'i informuar ata për të drejtat e tyre).
- 3) Bëni **informacione të shkurtra në lidhje me të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit** dhe të jetë në dispozicion të enteve dhe ndërmarrjeve publike, bashkësive lokale dhe të ngjashme. Këshillohuni me këshillat e tjerë kombëtar me përvojat e tyre në këtë fushë.
- 4) Vendosja e **bashkëpunimit me Këshillin për marrëdhënie mes komuniteteve për të avancuar marrëdhëniet midis komuniteteve të ndryshme në këto komuna**, për të hartuar aktivitete në nivelin lokal që synojnë bashkëjetesën, mirëkuptimin, tolerancën dhe pranimin e ndërsjellë.
- 5) Bazuar në listën e shqiptarëve të shquar dhe ngjarjeve në historiografinë shqiptare, në bashkëpunim me **Këshillin për marrëdhënie mes komuniteteve, propozoni emrat e rrugëve dhe shesheve**, krahas respektit dhe konsideratës së plotë për të gjitha komunitetet e tjera që jetojnë në territorin e këtyre tri komunave.
- 6) Përcaktoni se cilat **ligje janë të rëndësishme për qytetarët shqiptarë** (përveç ligjeve që ofrojnë të drejta shtesë si pjesëtarë të pakicave kombëtare).
- 7) **Përkthejeni ligjet nga serbishtja në shqip** dhe publikojeni ato në faqen e internetit të KKSH.
- 8) **Mbështetni qytetarët nga komuniteti shqiptar në mënyrë që ta kuptojnë kornizën legjislative**.

## LISTA E LIGJEVE

---

### Lista e rregullave dhe dokumenteve strategjike të rëndësishëm për veprimin e përgjithshëm të KKSH-së

- **Kushtetuta e Republikës së Serbisë** (në veçanti: pjesa (seksioni) 3, Të drejtat e pakicave nacionale):[https://www.paragraf.rs/propisi/ustav\\_republike\\_srbije.html](https://www.paragraf.rs/propisi/ustav_republike_srbije.html)
- **Konventa kornizë për ruajtjen e pakicave nacionale:**  
<https://www.ljudskaprava.gov.rs/sh/node/19816>
- **Ligji mbi këshillat nacionale**, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 72/2009, 20/2014 - Vendimi i Gjykatës kushtetuese, 55/2014, 47/2018:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_nacionalnim\\_savetima\\_nacionalnih\\_manjina.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_nacionalnim_savetima_nacionalnih_manjina.html)
- **Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave**, G. Zyrtare SRJ, nr. 11/2002, G. Zyrtare SCG, nr. 1/2003 – Karta Kushtetuese dhe Gazeta Zyrtare e Serbisë, nr.72/2009 –Ligji tjetër, 97/2013 - Vendimi i Gjykatës kushtetuese dhe 47/2018:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_zastiti\\_prava\\_i\\_sloboda\\_nacionalnih\\_manjina.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_zastiti_prava_i_sloboda_nacionalnih_manjina.html)
- **Ligji mbi vetëqeverisjen lokale** Gazeta Zyrtare e Serbisë, nr. 129/2007, 83/2014 – Ligji tjetër, 101/2016 – Ligji tjetër dhe 47/2018:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_lokalnoj\\_samoupravi.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_lokalnoj_samoupravi.html)
- **Plani akcional për realizimin e të drejtave të pakicave nacionale:**  
[https://ljudskaprava.gov.rs/sites/default/files/prilog\\_fajl/akcioni\\_plan\\_za\\_sprovodjenje\\_prava\\_nacionalnih\\_manjina\\_-\\_sa\\_semaforom.pdf](https://ljudskaprava.gov.rs/sites/default/files/prilog_fajl/akcioni_plan_za_sprovodjenje_prava_nacionalnih_manjina_-_sa_semaforom.pdf)
- **Raporti për realizimin e Planit akcional:**  
[https://www.ljudskaprava.gov.rs/sites/default/files/dokument\\_file/izveshtaj\\_1-2019.pdf](https://www.ljudskaprava.gov.rs/sites/default/files/dokument_file/izveshtaj_1-2019.pdf)

### Lista e rregullave dhe dokumenteve strategjike të rëndësishme për realizimin e autorizimeve publike në fushën e arsimit

- **Ligji mbi bazat e sistemit të arsimimit dhe edukimit**, Gazeta Zyrtare e Serbisë, nr.88/2017, 27/2018 – Ligji tjetër dhe 10/2019:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_osnovama\\_sistema\\_obrazovanja\\_i\\_vaspitanja.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_osnovama_sistema_obrazovanja_i_vaspitanja.html)
- **Ligji mbi arsimin dhe edukimin fillor**, Gazeta Zyrtare e Serbisë, nr.55/2013, 101/2017, 27/2018 – Ligji tjetër dhe 10/2019:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_osnovnom\\_obrazovanju\\_i\\_vaspitanju.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_osnovnom_obrazovanju_i_vaspitanju.html)
- **Ligji mbi arsimin dhe edukimin e mesëm**, Gazeta Zyrtare e Serbisë, nr.55/2013, 101/2017 dhe 27/2018 – Ligji tjetër:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_srednjem\\_obrazovanju\\_i\\_vaspitanju.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_srednjem_obrazovanju_i_vaspitanju.html)

- **Ligji mbi arsimin e lartë**, Gazeta Zyrtare e Serbisë,nr.88/2017, 27/2018 – Ligji tjetër dhe 73/2018:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_visokom\\_obrazovanju.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_visokom_obrazovanju.html)
- **Ligji mbi tekstet mësimore**, Gazeta Zyrtare e Serbisë,nr.27/2018:  
<https://www.paragraf.rs/propisi/zakon-o-udzbenicima.html>
- **Rregullorja mbi botimin e teksteve me tirazh të ulët**, <http://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SlGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/ministarstva/pravilnik/2018/69/2>
- **Rregullorja mbi standardet e përgjithshme të të arriturave për lëndën gjuhë serbe si gjuhë jo amtare për përfundimin e ciklit të pare dhe të dytë të shkollimit obligativ, shkollimit të përgjithshëm dhe shkollimit fillor të të rriturve**, Gazeta Zyrtare e Serbisë,nr.55/17:  
<http://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SlGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/ministarstva/pravilnik/2017/55/6/reg>
- **Standardet e përgjithshme për të arriturat për lëndën Gjuha serbe si gjuhë jo amtare për fundin e ciklit të parë të arsimit obligativ**, <http://www.mpn.gov.rs/wp-content/uploads/2015/09/Prilog-Standardi-za-srpski-kaonematerniji-jezik.pdf>

#### **Lista e rregullave dhe dokumenteve strategjike të rëndësishme për realizimin e autorizimeve publike në fushën e kulturës**

- **Ligji mbi kulturën**, Gazeta Zyrtare e Serbisë,nr.72/2009, 13/2016 dhe 30/2016:[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_kulturi.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_kulturi.html)
- **Ligji mbi veprimtarinë e bibliotekave dhe informacioneve**, Gazeta Zyrtare e Serbisë,nr.52/2011:  
<http://demo.paragraf.rs/WebParagrafDemo/ZAKON-O-BIBLIOTECKOJ-DELATNOSTI-Sl.-glasnik-RS,-br.-34-94.htm>
- **Ligji mbi të mirat kulturore**, Gazeta Zyrtare e Serbisë,nr.71/94, 52/2011 – Ligji tjetër dhe 99/2011 - Ligji tjetër: [https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_kulturnim\\_dobrima.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_kulturnim_dobrima.html)
- **Udhëzimet për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore në Serbi**:  
<http://www.kultura.gov.rs/lat/dokumenti/propisi-iz-oblasti-kulture/smernice-za-digitalizaciju-kulturnog-nasledja-u-republici-srbiji>
- **Dokumentet e tjera të rëndësishme vendore nga fusha e kulturës**:  
<http://www.kultura.gov.rs/lat/dokumenti/propisi-iz-oblasti-kulture/strana/1>
- **Konventa mbi ruajtjen dhe promovimin e shumëllojshmërisë së shprehjes së kulturave**:  
[http://www.kultura.gov.rs/docs/stranice/82128418889499865927/13.%20Konvencija%20o%20zastiti%20i%20unapredjenju%20raznolikosti%20kulturnih%20izraza%20\(Pariz,%202005\).pdf](http://www.kultura.gov.rs/docs/stranice/82128418889499865927/13.%20Konvencija%20o%20zastiti%20i%20unapredjenju%20raznolikosti%20kulturnih%20izraza%20(Pariz,%202005).pdf)
- **Konventat tjera ndërkombëtare të rëndësishme nga fusha e kulturës**:<http://www.kultura.gov.rs/lat/medjunarodna-saradnja/medjunarodna-dokumenta>



### **Lista e rregullave dhe dokumenteve strategjike të rëndësishme për realizimin e autorizimeve publike në fushën e informimit**

- **Ligji për informimin publik dhe mediat**, Gazeta Zyrtare e Serbisë, nr.83/2014, 58/2015 dhe 12/2016 – interpretim autentik  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_javnom\\_informisanju\\_i\\_medijima.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_javnom_informisanju_i_medijima.html)
- **Ligji për mediat elektronike**, Gazeta Zyrtare e Serbisë, nr.83/2014 i 6/2016 – Ligjitjetër: [https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_elektronskim\\_medijima.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_elektronskim_medijima.html)
- **Strategjia e zhvillimit të sistemit të informimit publik në Republikën e Serbisë**, drafti: <https://www.srbija.gov.rs/specijal/362240>
- **Rregulloret ekzistuese mbi bashkëfinancimin e projekteve për realizimin e interesit publik në sferën e informimit publik që përdoret nga organet shtetërore**:  
<http://www.kultura.gov.rs/docs/dokumenti/propisi-iz-oblasti-medija/pravilnik-o-sufinansiranju-projekata-za-ostvarivanje-javnog-interesa--u-oblasti-javnog-informisanja-.doc>.

### **Lista e rregullave dhe dokumenteve strategjike të rëndësishme për realizimin e autorizimeve publike në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit**

- **Karta evropiane për gjuhët regjionale ose të pakicave**:  
<https://ljudskaprava.gov.rs/sh/node/19820>
- **Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit**, Gazeta Zyrtare e Serbisë, nr.45/91, 53/93, 67/93, 48/94, 101/2005 -Ligji tjetër, 30/2010, 47/2018 dhe 48/2018.  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_sluzbenoj\\_upotrebi\\_jezika\\_i\\_pisama.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_sluzbenoj_upotrebi_jezika_i_pisama.html)
- **Ligji për librat amzë**, Gazeta Zyrtare e Serbisë, nr.20/2009, 145/2014 dhe 47/2018:  
[https://www.paragraf.rs/propisi/zakon\\_o\\_maticnim\\_knjigama.html](https://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_maticnim_knjigama.html)